

Qershor 2021  
Numri: 159  
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.progresibotime.com](http://www.progresibotime.com)

# ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë  
Kosovë: 1.5 Euro  
Maqedoni: 90 Den  
Evropë: 7 Euro

**MOS E KËRKO  
GABIMIN  
TEK TJETRI!**




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër  
qëndrimi indiferent,  
pandjenja dhe injorant përballë  
mrekullive të pafundme  
madhështore, që prej  
grimcës më të vogël, e deri tek  
trupi më i madh, prej botës  
mikro, e deri në atë makro,  
të cilat ndriçojnë më së miri  
mendjen dhe zemrën,  
përveçse një çoroditje  
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob  
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap  
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën  
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e  
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar  
pasurinë e tij dhe se ku e ka  
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e  
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që  
është drejtuar kah e mira dhe ka  
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e  
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Vëllezërit tanë janë pasqyra me të cilat ne shikojmë veten. Qartësia e pasqyrës varet nga qartësia e zemrës. Ajo që shohim tek vëllai ynë, në të vërtetë është ajo që përjetojmë në veten tonë. Nëse nuk është kështu, problemi është më i madh, sepse atëherë kjo do të thotë se nuk është arritur kuptimi i së vërtetës së përmendur në ajetin ku thuhet se «**Besimtarët janë vëllezër**» (Huxhurat, 10). Ai që kërkon një vëlla, duhet së pari të jetë vet një vëlla. E ai që nuk mund të gjejë një vëlla, do të thotë se as vet nuk është bërë vëlla. Cilësia jonë është po aq sa cilësia e vëllait tonë. Kush ka hall se sa larg dhe me kë mund të ecë, duhet të mendojë se sa larg mund ta shoqërojë ai dikë. Kush pyet kë mund të besoj, duhet të pyesë veten se sa besim i jep ai njerëzve. Të mendosh mirë për vëllezërit është kushti i parë i ligjit të vëllazërisë. Ndërsa mbrojtja e jetës private të vëllait është qëllimi përfundimtar i këtij ligji.

Ai që me anë të përgjimit/spiunimit thyen privatësinë e vëllait të tij dhe, në këtë mënyrë e nxjerr zbuluar atë, në të vërtetë vëllait të tij i ka bërë një të keqe edhe më të madhe. Kjo e keqe është shkatërrimi i besueshmërisë së tij. Dikush të cilit i ka dalë në shesh e meta, mund të humbasë besueshmërinë për atë që mund të bëjë dhe me të cilën punon, pasi tashmë kufijtë e tij janë shkatërruar. Zoti ynë dëshiron që ne ta njohim Atë me kufijtë e Tij. Kufijtë e Tij janë pikat e koordinatave të kontaktit të Tij me ne. Kush i kush-ton vëmendje kufijve të tij nuk guxon të hetojë gabimin e askujt, sepse një përpjekje e tillë është një nga gabimet më të mëdha. Së pari, ai duhet të kërkojë gabimin e vet, pastaj të përpiqet të bëhet shembull, dhe nëse ka ndonjë gabim apo të metë që ai e sheh, nuk e zbulon, por përkundrazi, përpiqet ta mbulojë atë. Ai e di që robërit e Allahut kalojnë në çdo moment nga një gjendje në tjetrën në punët e tyre. Atë që për një moment e shohim në gjynah, pas një çasti mund të pendohet nga gabimi i tij. Zemrat janë në duart e Zotit. Për më tepër, çdo moment i jetuar në përputhje me Islamin është një mjet pastrimi, rinovimi dhe ripërtëritje që u jep njerëzve shpresë. Abdesti ynë, lutjet tona, xhamitë tona, bamirësia jonë dhe vëllezërit tanë besimtarë, janë të gjithë mjete për pastrim.

# Përmbajtja



11

Marrëdhënia me prindërit  
Dr. Adem Ergyl



Islami, ujë i rrjedhshëm,  
i pastër dhe i qetë  
Soner Duman

16



18



34

Abdulkadir Gejlani  
Osman Nuri Topbash

- 5 Mos e kërkë gabimin tek tjetri!  
Mehmet Lutfi Arslan
- 8 Fanatizmi burim  
i polarizimit shoqëror  
Ali Riza Temel
- 18 Thirrja për vetëdijësim  
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 23 Besnikëria ndaj Allahut  
dhe respektimi i ligjeve  
Idris Arpat
- 26 Moda e fundit  
Fërat Erdogan
- 28 Feja është sinqeritet!  
Hadi Enall
- 30 "Mëshira Ime përfshin çdo gjë"  
Nuredin Jëlldëz
- 32 Një Ajet



45

- Rëndësia e rinisë 45  
dhe çështja e identitetit  
Dr. Kerim Bulladë
- Universalizmi i Islamit 51  
dhe çështja e aktualizimit  
Mustafa Karabaxhak
- Modeli i Aishes dhe Ummu Sherik 54  
në predikimin e Islamit  
Shefika Kaja Meriç
- Komunikoje mesazhin e Zotit 56  
Ferid Piku



42

Disa gabime që bëhen  
në komentimin e Kuranit  
Dr. Murat Kaja

Dallimet në lumturi në mesin e njerëzve  
Shah Velijullah Dehlevi

48



# Mos e kërko gabimin tek tjetri!

— Mehmet Lutfi Arslan —

Një natë, ndërsa shëtisnin rrugëve të Medinës me Abdullah bin Mesudin (r.a.) kalifi Omer (r.a.) dëgjoi thirrjet e një të dehuri nga një shtëpi. U ngjit në çatinë e shtëpisë dhe kur shikoi brenda, pa një plak me një shishe verë përpara që po dëgjonte këngë prej skllaves së tij. Ai u fut me furi në shtëpi dhe iu hakërrua të moshuarit:

- Sonte nuk kam parë asgjë më të shëmtuar sesa ky plak! A mendon se nuk do të ndëshkohesh për këtë gjynah?

Plaku iu përgjigj qetësisht:

- Ajo që bëri Prijësi i besimtarëve është tre herë më keqe se e imja.

Omeri (r.a.), u habit dhe pyeti: «Si?» Plaku foli qetë qetë:

- Allahu thotë: «**Hyni nëpër shtëpi përmes portave të tyre**», ju keni hyrë nga çatia. Allahu thotë: «**Kur të hyni në shtëpinë e të tjerëve, kërkonit leje dhe përshëndetuni**», ju as nuk kërkuat leje dhe as nuk dhatë selam. Po ashtu, Ai thotë, «**Mos spiunoni (hetoni të metat e të tjerëve)!**» Por ju hetuat në privatësinë time.

Kalifi i Madh mbeti si i ngrirë:

- Plak, ke thënë të drejtën! Nëse Allahu nuk e fal Omerin, atëherë mjerë për të!..

Kur e la plakun në hall të vet dhe u largua, Kalifi filluan t'i rridhnin lot nga sytë. Por halli i tij ishte i ndryshe nga ai që supozohej të ishte: Po sikur ky njeri, i cili deri atëherë i fshihnte veprimet e veta nga të gjithë, bëhej edhe më i keq pas kësaj ngjarjeje që përjetoi me Kalifin? Si do të vente halli?

Plaku nuk iu shfaq Kalifit për një kohë të gjatë. Ditë më vonë, ndërsa Omeri (r.a.) ishte ulur në xhami me miqtë e tij, pa plakun që u struk në heshtje në një cep në fund. Ai i bëri menjëherë shenjë me dorë dhe e thirri pranë. Plaku iu afrua paksa i tensionuar për shkak të frikës së atyre që kishte bërë. Por Omeri (r.a.) e komplimentoi dhe e uli në të djathtë të tij. Në një moment, ai u përkul ngadalë në veshin e tij dhe i tha:

- Beto hem në Allah se nuk e kam ndarë me askënd atë që pashë atë natë. Po ashtu edhe Abdullahu që ishte me mua atë natë...

Atëherë, edhe i moshuari u përkul tek veshi i Kalifit dhe i tha:

- Po ashtu edhe unë betohem në Allahun, i cili dërgoi Muhamedin salallahu alejhi ue selem si Profet të vërtetë, se unë nuk e bëra më atë punë pas asaj dite.

I emocionuar prej atyre që dëgjoi, Kalifi thirri me zë të lartë "Allahu Ekber". Njerëzit përreth u habitën. Mirëpo, habia e tyre nuk gjeti përgjigje në fytyrat e kalifit dhe të plakut, që nuk thoshin asgjë. E as që do të gjenin deri në kiamet.

Në fjalor, fjala arabe "texhessus" do të thotë, "përpjekje e fshehtë për të mësuar gjëra që nuk duhet t'i mësosh". Ky koncept, i cili përdoret në një kuptim pozitiv kur merret si kurioziteti i tep-

ruar, është ndaluar nga Kur'ani në Suren Huxhurat në kuadrin marrëdhëniesve midis besimtarëve. Me shprehjen «ue la texhessesu», është ndaluar hetimi i gabimeve, fajeve dhe mangësive të njerëzve dhe shpenzimi i një kohe të veçantë për këtë veprim. Krahas kësaj, besimtarëve u kërkohet të mbulojnë atë që mbulon Allahu. Lidhur me këtë Profeti ynë (a.s.), ka thënë: "...

*Mos i përgojoni myslimanët dhe mos hetoni të metat dhe gabimet e tyre! Kush heton të metat dhe gabimet e myslimanëve, edhe Allahu do t'i hetojë të metat dhe gabimet e tyre. Kujt ia heton*



Allahu të metat dhe gabimet, e poshtëron atë qoftë edhe brenda shtëpisë së tij.” (Ebu Daud, Edeb, 35/4880; Tirmidhi, Birr, 85/2932; Ibn-i Kethir, Tefsir, IV, 229.)

Ndërsa në një hadith tjetër, është thënë: “Kush e turpëron vëllain besimtar për shkak të një të mete, nuk ka për të vdekur pa e përjetuar vetë atë të metë!” (Tirmidhi, Kijame, 53.)

Ndërsa ai që nuk e turpëron vëllain e vet, por përkundrazi ia mbulon të metat dhe gabimet, është përgëzuar në këtë mënyrë: “Kush e mbulon të metën e një myslimani dhe ia fal gabimin atij, Allahu do t’ia falë gabimet ditën e gjykimit.” (Buhari, Medhalim, 3; Muslim, Dhikr, 38.)

Ndalimi i sëmundjes së spiunimit apo përgjimit, është për mbrojtjen e privatësisë ose jetës private. Gjëja e parë që duhet të mbrohet është jeta jonë ose privatësia. Harmonia e botës së brendshme të një personi është e mundur vetëm nëse ai arrin të menaxhojë disa mendime dhe ndjenja. Duket sikur ne nuk e kemi në dorë se çfarë të dëgjojmë dhe çfarë jo, çfarë të shohim dhe çfarë jo, madje edhe më e vështira, çfarë të ndjejmë e çfarë jo. Në fakt, kjo është pikërisht ajo që kërkohet nga ne. Kushti i parë për vetë-kontrollim, është që njeriu të mbajë nën kontroll sytë, veshët dhe zemrën. Arritja e këtij niveli nuk është e lehtë. Hapi i parë hidhet me qëllim dhe përparimi bëhet me përpjekje.

Njeriu duhet të mos e humbë qëllimin e tij, as nga sytë, e as nga zemra, gjë e cila përfshin pesë shqisat dhe botën tonë të zemrës. Si e tillë, ajo që shihet, dëgjohet dhe ndihet, me kalimin e kohës arrin një pjekuri të caktuar. Ajo që duhet pasur kujdes gjatë përparimit në këtë rrugë, është domosdoshmëria e mos ndjekjes së asaj për të cilën nuk kemi informacion të saktë. (Isra, 36) sepse veshët, sytë dhe zemrat tona janë përgjegjëse për këtë. Pra, edhe shikimi është një përgjegjësi, edhe dëgjimi... Për më tepër, është e nevojshme t’i kushtohet vëmendje ndjenjës që ato shkaktojnë në zemër.

Një fushë tjetër e privatësisë që duhet të mbrohet

është privatësia e vëllezërve tanë për të cilët kujdesemi për njëri-tjetrin. Vëllezërit tanë janë pasqyra me të cilat ne shikojmë veten. Qartësia e pasqyrës varet nga qartësia e zemrës. Ajo që shohim tek vëllai ynë, në të vërtetë është ajo që përjetojmë në veten tonë. Nëse nuk është kështu, problemi është më i madh, sepse atëherë kjo do të thotë se nuk është arritur kuptimi i së vërtetës së përmendur në ajetin ku thuhet se «**Besimtarët janë vëllezër**» (Huxhurat, 10). Ai që kërkon një vëlla, duhet së pari të jetë vet një vëlla. E ai që nuk mund të gjejë një vëlla, do të thotë se as vet nuk është bërë vëlla. Cilësia jonë është po aq sa cilësia e vëllait tonë. Kush ka hall se sa larg dhe me kë mund të ecë, duhet të mendojë se sa larg mund ta shoqërojë ai dikë. Kush pyet kë mund të besoj, duhet të pyesë veten se sa besim i jep ai njerëzve. Të mendosh mirë për vëllezërit është kushti i parë i ligjit të vëllazërisë. Ndërsa mbrojtja e jetës private të vëllait është qëllimi përfundimtar i këtij ligji.



Ai që me anë të përgjimit/spiunimit thyen privatësinë e vëllait të tij dhe, në këtë mënyrë e nxjerr zbuluar atë, në të vërtetë vëllait të tij i ka bërë një të keqe edhe më të madhe. Kjo e keqe është shkatërrimi i besueshmërisë së tij. Dikush të cilit i ka dalë në shesh e meta, mund të humbasë besueshmërinë për atë që mund të bëjë dhe me të cilën punon, pasi tashmë kufijtë e tij janë shkatërruar. E në fakt, edhe

frika e Kalifit Omer në lidhje me plakun, përtej shkeljes së privatësisë së tij, ka të bëjë më tepër me dëmtimin e besueshmërisë së tij. Ai që e di se është zbuluar, nuk e ka më problem se mos zbulohet. Ai që e di se është parë, tashmë e ka tejkalar kufirin psikologjik që e mban atë në një vend. Nëse ai limit tejkalohe, do të thotë se nuk ka asnjë limit që nuk mund të tejkalohe. Prandaj, mbrojtja e privatësisë ose kufijve të vetes dhe vëllait tonë, në të vërtetë do të thotë të kontrollojmë kalimin e kufijve, moskokëçarjen dhe guximin tonë të tepruar.

Një fushë tjetër që sëmundja e përgjimit e shkatërron plotësisht, është privatësia që i përket publikut. Zbulimi i një gjynahu në publik, do të thotë të bësh një krim publik. Gjynahu që bëhet publik, është

si një cofëtinë e përhapur, e shpërndarë që shqetëson mjedisin ashtu si aroma e një jashtëqitjeje në vend të hapur. Ai që zbulon dhe përhap gjynahet e veta turbullon edhe mendjet dhe zemrat e të tjerëve, por shpërfill edhe rrethin e tij privat me Allahun. Ai që nxjerr në shesh privatësinë e vet, ka vendosur dinamit në themelin e së mirës, së bukurës dhe së vërtetës së përbashkët, sepse kjo sjellje egoiste shkakton zbrazjen e konceptit të privatësisë. Me zbulimin e privatësisë së vet, nuk mbetet më jetë private.

Ai që përcakton se çfarë është e drejtë dhe e gabuar, e për rrjedhojë çfarë është mëkat apo jo, është Allahu i Madhëruar. Haram dhe hallall janë klasifikime që rezultojnë nga ky përcaktim. Në një hadith, harami krahasohet me një koriye (pyll ku është e ndaluar të hyhet). Kështu, çdo sundimtar ka një koriye, dhe koriya e Zotit është harami. Në këtë kuptim, të bësh gjynah është mungesë respekti ndaj Allahut, i cili është i dijshtëm për gjithçka. Por, të zbulosh një gjendje të keqe që mund t'u fshihet njerëzve të tjerë, është një mos respekt edhe më i madh. Mbulimi i gjynahut vetjak dhe mos zbulimi i tij është edukatë. Kurse mbulimi i gjynahut të dikujt tjetër është tregues i një edukate edhe më të lartë, sepse virtyti dhe dhuntia njerëzore kërkon të njihet jo me gjynahun, të keqen dhe shëmtinë, por me sevapet, mirësitë dhe bukuritë. Prandaj, të preferosh të jesh i njohur për gjynahet tregon arrogancë të tepruar.

Zoti ynë dëshiron që ne ta njohim Atë me kufijtë e Tij. Kufijtë e Tij janë pikat e koordinatave të kontaktit të Tij me ne. Kush i kushton vëmendje kufijve të tij nuk guxon të hetojë gabimin e askujt, sepse një përpjekje e tillë është një nga gabimet më të mëdha. Së pari, ai duhet të kërkojë gabimin e vet, pastaj të përpiqet të bëhet shembull, dhe nëse ka ndonjë gabim apo të metë që ai e sheh, nuk e zbulon, por përkundrazi, përpiqet ta mbulojë atë. Ai e di që robërit e Allahut kalojnë në çdo moment nga një gjendje në tjetrën në punët e tyre. Atë që për një moment e shohim në gjynah, pas një çasti mund të pendohet nga gabimi i tij. Zemrat janë në duart e Zotit. Për më tepër, çdo moment i jetuar në përputhje me Islamit është një mjet pastrimi, rinovimi dhe ripërtëritje që u jep njerëzve shpresë. Abdesti ynë, lutjet tona, xhamitë tona, bamirësia jonë dhe vëllezërit tanë besimtarë, janë të gjithë mjete për pastrim. Kjo ndodhi që ka ngjarë në Epokën e Lumturisë, është shembulli më i mirë i kësaj:

“Një burrë erdhi tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha:

«O i Dërguari i Allahut! Unë kam kryer një vepër që duhet të ndëshkohet, prandaj më dëno!»

Atë moment ishte koha e namazit. Burri fali namazin bashkë me të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe pas namazit tha:

«O i Dërguari i Allahut! Unë kam kryer një vepër që duhet të ndëshkohet, prandaj më dëno!»

Profeti (a.s.), tha:

«A fale namaz bashkë me ne?» Burri tha:

«Po!» Ndërsa profeti (a.s.), tha:

«Atëherë je i falur!» (Buhari, Hudud 27; Muslim, Teube 44, 45. Shih. Ebu Daud, Hudud 10.)

*Ai që kërkon një vëlla,  
duhet së pari të jetë vet  
një vëlla. E ai që nuk  
mund të gjejë një vëlla,  
do të thotë se as vet nuk  
është bërë vëlla. Cilësia  
jonë është po aq sa cilësia  
e vëllait tonë. Kush ka  
hall se sa larg dhe me  
kë mund të ecë, duhet të  
mendojë se sa larg mund  
ta shoqërojë ai dikë. Kush  
pyet kë mund të besoj,  
duhet të pyesë veten se sa  
besim i jep ai njerëzve.*



# FANATIZMI BURIM I POLARIZIMIT SHOQËROR

— Ali Riza Temel —

Termi fanatizëm, përkufizohet si: Mbrojtje e një mendimi apo shkolle, pavarësisht nga e vërteta ose e pavërteta e tij. Kjo do të thotë të mbështesësh fenë, sektin ose partinë së cilës i përket, të mos respektosh mendimin e kundërt ndërkohë që nuk heton as për të vërtetën, të jesh tepër i lidhur me një besim dhe të mos mendosh për asnjë tjetër. Krahas këtyre, t'i japësh mbështetje absolute simpatizantëve, qofshin të drejtë apo të gabuar, dhe të mbash anën e tyre.

Fanatikë janë ata persona me attribute të tilla si kokëfortësia, përdorimi i dhunës, mbrojtja e verbër e diçkaje pavarësisht nga e drejta dhe e gabuara e saj, dominimi mbi ata që nuk mendojnë si ai, intoleranca dhe injoranca. Kur çështja shikohet nga kjo perspektivë, është e pamendueshme që një mysliman i vërtetë të jetë fanatik, sepse myslimani është i hapur ndaj të gjitha mendimeve dhe pikëpamjeve. Në Kuranin Fisnik urdhërohet: **“Le të gëzohen ata që shmangen nga adhurimi i idhujve e kthehen nga Allahu! Pra, jepu lajme të gëzueshme robërve**

**të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët (që u thuhën), ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Këta janë ata që Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; këta janë mendarët.”** (Zumer, 17-18.)

Fanatizmi shfaqet më tepër në çështjet fisnore, fetare, sektare dhe ideologjike. Gjithashtu ai shfaqet edhe në formën e adhurimit të individit. Por, imitimi verbërisht i së kaluarës dhe të qenit i mbyllur ndaj risive është e dënuar në Islam. Në Kuran urdhërohet:

**“Kush dëshiron shpërblimin e kësaj bote, (le ta dijë se) tek Allahu janë shpërblimi i kësaj dhe i botës tjetër. Allahu dëgjon dhe vështron çdo gjë.”** (Nisa, 135.)

Arsyet që e shtojnë njeriun drejt fanatizmit, janë të shumta. Për shembull, prej tyre mund të numërohet arroganca dhe vetëpëlqimi, kokëfortësia, smira dhe armiqësia, krenaria për të kaluarën, kthimi i traditës në tabu, injoranca dhe mungesa e mendimit, qëllimi i keq dhe hipokrizia, dashuria dhe urrejtja





e tepruar, ruajtja e status quo-së, interesi i ngushtë personal, frika nga opinioni, verbëria e masës, llastimi i shkaktuar nga rehatia, rezistenca ndaj ndryshimeve, etj.

Mendja, dija dhe udhëzimi i besimit është thelbësor për një jetë të qetë dhe të lumtur si për individin ashtu edhe për shoqërinë. Sidoqoftë, njerëzit më tepër drejtohen nga emocionet sesa nga mendja. Shpesh, dashuria, urrejtja dhe ndjenja e interesit janë mbizotëruese. Prandaj, është e vështirë të kesh mendje dhe zemër të shëndoshë.

Gazaliu përmend një dobësi të rëndësishme të njerëzve, që është mos shikimi i të metave të dikujt kur e dashuron dhe mos shikimi i meritave të tij kur e urren. Mirëpo, Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

*“Mikun duaje me masë, sepse një ditë mund të bëhet armiku yt. Edhe armikun urreje me masë, sepse një ditë mund të bëhet miku yt.”* (Tirmidhi, Birr, 60/1997.) Gjithashtu ai na tërheq vëmendjen edhe në faktin se: «*Dashuria e tepërt ndaj një gjëje, të verbon dhe të shurdhon*». (Ebu Daud, Edeb, 125)

E tillë është urrejtja! Sepse, dashuria dhe urrejtja e tepruar janë perde për mendjen dhe sytë. Në këtë situatë, njerëzit nuk mund të jenë objektivë dhe të paanshëm. Një fjalë e urtë thotë, «Syri i dashurisë është i verbër». Kështu është edhe ndjenja ndaj interesave dhe fafesisit. Prandaj, i afërmi i ngushtë nuk pranohet si dëshmitar dhe asnjë gjykatës nuk pyetet për të marrë një vendim për veten e tij.

Arsyeja e polarizimit brenda një shoqërie është fanatizmi. Ata, sytë, zemrat dhe mendjet e të cilëve janë të mbuluar me fanatizëm, shohin vetëm atë që duan të shohin, ata dëgjojnë atë që duan të dëgjojnë dhe vendosin perde të hekurta me të tjerët. Ky qëndrim është i zakonshëm brenda dhe jashtë fesë, në fushën politike dhe ideologjike. Ashtu siç ka fanatikë të pagdhundur dhe ithtarë të verbër e vulgarë, ka edhe fanatik revolucionarë, shekullarist të dhunshëm dhe ateistë agresivë. Fanatizmi nuk ka një fe, sekt, racë apo ideologji të caktuar. Kushdo që mbyll sytë dhe veshët ndaj së vërtetës është një fanatik.

Fakti që kur bëhet fjalë për fanatizëm të vijnë menjëherë në mendje myslimanët, është rezultat i një perceptimi të krijuar në mënyrë të qëllimshme.

Myslimani është konservator, por nuk bëhet fanatik. Ndërsa mbrojtja e vlerave morale dhe njerëzore dhe respektimi i të shkuarës janë virtyte. Jo gjithçka e vjetër është e keqe dhe jo gjithçka e re është e mirë. Kryesore është të jesh me të vërtetën, të mirën dhe të bukurën.



Partitë dhe individët nuk janë tabu. Çdo gjë mund të diskutohet, përveç profetëve dhe rregullave të caktuara fetare. Kthimi në tabu i individëve, partive dhe ideologjive dhe konsiderimi i tyre të padiskutueshëm pengon përparimin dhe bashkëjetesën. E në fakt, kushti i përparimit është diskutimi, hulumtimi dhe përpjekja për të gjetur më të mirën dhe më të dobishmen. Individët dhe shoqëritë që nuk mund të kapërcejnë individët dhe ideologjitë, qëndrojnë gjithmonë në vend. Kafshët nuk mund të përparojnë, sepse ato gjithmonë bëjnë të njëjtat gjëra, me të njëjtën formë dhe mënyrë. Kjo sepse ato veprojnë jo me arsye, por me instinktet e tyre.

Ne i peshojmë njerëzit në peshoren e së vërtetës, jo të vërtetën në peshoren e njerëzve. Ne shohim atë që është thënë, jo kush e tha. E drejta është e drejtë pavarësisht se kush e thotë atë dhe e padrejta është e padrejtë pavarësisht se kush e thotë atë. Ata që vendosin syze fanatizmi nuk shohin se çfarë thuhet, por kush e thotë.

Një fjalë e urtë thotë se «arsyeja ka vetëm një rrugë». Po, kjo është e vërtetë për mendjen e shëndoshë, pra për mendjen që nuk është robëreshë e dashurisë dhe urrejtjes, apo peng i interesit dhe fanatizmit.

Islamofobia, operacioni i qëllimshëm i perceptimit i krijuar pikërisht kundër Islamit, i cili në fakt synon të çlirojë njerëzit nga skllavëria materiale dhe shpirtërore, buron tërësisht nga fanatizmi, xhelozia

dhe interesi i ngushtë. Lidhur me çmimin që ka kushtuar ky fanatizëm dhe verbëri, gjenden shumë tablo të dhimbshme si përgjatë historisë, ashtu edhe në ditët tona. Rregulli themelor i fesë së vërtetë është; dëshirimi për të tjerët atë që dëshiron për veten; dashuria ndaj krijesave për shkak të Krijuesit; kapërcimi nga egoizmi në altruizëm; shikimi i gjërave dhe ngjarjeve me syrin e dashurisë, jo me syrin e armiqësisë. E të gjitha këto mund të arrihen vetëm duke shpëtuar nga fanatizmi.

Thamë se pengesa më e madhe për pranimin e së vërtetës është fanatizmi. Por, le të shohim këtu një shembull goditës në lidhje me këtë:


Abdullah bin Salam ishte një dijetar hebre nga Beni Kajnuka, një nga tre fiset hebreje që ishin vendosur në afërsi të Medinës. Kur mori vesh për Profetin (a.s.), e kuptoi se ai ishte profeti, ardhja e të cilit ishte njoftuar në Teurat. Prandaj, ai pranoi Islamit dhe u bë mysliman. Para se të bëhej mysliman, ai gëzonte reputacion të madh në fisin e tij. Prandaj, ashtu si ai, edhe anëtarët e familjes së tij zgjodhën Islamit. Abdullahu e fshehu Islamit e tij për njëfarë kohe. Pastaj shkoi te Profeti dhe i tha: O i Dërguar i Allahut! Hebrenjtë janë një popull shpifës. Nëse ata mësojnë se unë jam bërë mysliman pa i pyetur më parë rreth meje, ata do të shpifin për mua. Prandaj më fshih në një dhomë dhe pyeti ata për mua. I Dërguari i Allahut e fshehu atë në një dhomë, dhe kur erdhën hebrenjtë i pyeti: Kush është Abdullah bin Selami për ju? Ata thanë: Ai është më i miri prej nesh, fëmija i më të mirës sonë, zotëria ynë dhe djali i zotërisë sonë. Resulullahu tha: Po sikur Abdullah bin Selami të bëhej mysliman!? Hebrenjtë thanë: Zoti na ruajt! Një gjë e tillë s'është e mundur. Abdullahu doli nga dhoma dhe deklaroi Islamit e tij duke thënë shehadetin. Pastaj tha: O bashkësi e hebrenjve! Respektoni Zotin! Pranoni ata që ka dërguar Ai! Edhe ju e dini se Muhamedi (a.s.), është profeti i Tij. Ai është profeti, emri dhe atributet e

të cilit përmenden në Teurat. Unë besoj se ai është i Dërguari i Allahut dhe i pranoi ato që ka sjellë ai. Kur dëgjuan këto, hebrenjtë e fyen atë, duke i thënë: Ti je një gënjeshtar, ti je më i keqi ynë dhe biri i më të keqit prej nesh. Pas kësaj, Abdullah bin Selami tha: O Profet! Ndodhi ajo që i druhesha. Ju thashë se ata janë një popull shpifës, i padrejtë, mashtrues dhe i keq!..

Si përfundim, ai deklaroi hapur Islamit e tij dhe të anëtarëve të familjes së tij. Po ashtu, edhe halla e tij, vajza e Harithit Halidja, u bë myslimane dhe jetoi si një myslimane e mirë. Abdullahu (r.a.) ishte një sahab i devotshëm që mori pjesë në Betejën e Uhudit, në çlirimin e Kudsit, luftën e Nihavendit dhe u përpoq shumë për shpëtimin e Osmanit (r.a.). Thuhet se lidhur me të është zbritur ajeti: **“Ata që u kemi dhënë Librin, e njohin atë (Profetin a.s.), ashtu siç i njohin bijtë e tyre, por disa prej tyre e fshehin të vërtetën, duke e ditur mirë.”** (Bekare, 146.)

Fanatizmi, të cilin u përpoqëm të shpjegojmë këtu, me të vërtetë i bën individët dhe shoqëritë të verbra dhe të shurdhra. Hebrenjtë që vetëm pak momente më parë e ngritën në qiell Abdullah bin Selamin, pak momente më vonë, kur mësuan se ai ishte mysliman, u përpoqën ta fundosin në tokë pa hezituar aspak. Siç mund të shihet, fanatizmi është verbëria dhe shurdhëria më e madhe. Ajo është një sëmundje jashtëzakonisht e vështirë për t'u kuruar, sepse ata që i ka kapur kjo sëmundje nuk pranojnë që janë të sëmurë, dhe për më tepër, ata i konsiderojnë të tjerët të sëmurë.

Prandaj, është e domosdoshme që kundër fanatizmit, të pajisemi me dituri, butësi, durim dhe tolerancë; të qëndrojmë sa më larg qëndrimeve të fanatikëve; dhe të mobilizohemi për të krijuar mjedisin që nxit mendimin e lirë, tolerancën dhe kulturën e bashkëjetesës.



# MARRËDHËNIA ME PRINDERIT

— Dr. Adem Ergyl —

Imam Gazaliu shprehet si më poshtë në veprën e tij me titull “el-Munkidhu mine’ d-Dalal”, vepër në të cilën ka shpjeguar udhëtimin për arritjen e e vërteta:

“Falë studimeve, përvojave dhe gjërave që kam dëshmuar mund të them se: Ata që janë më përpara në rrugën që shkon te Allahun janë të urtët. Ata kanë ecurinë më të bukur dhe rruga e tyre përsëri është rruga më e drejtë. Edhe morali i tyre është morali më i lartë. Madje mund të thuhet se për t’i ndryshuar mënyrën e jetesës dhe moralin e tyre dhe për të sjellë diçka më të mirë, edhe nëse bëhen bashkë të mençurit e të mençurve, të urtët e të urtëve dhe dija e dijetarëve, prapë se prapë nuk do të arrihej niveli i atyre. Sepse të gjitha veprimet dhe qëndrimet e tyre të dukshme e të padukshme janë marrë nga nuri (drita) e kandilit profetik. Faktikisht në rruzullin tokësor nuk mund të ketë burim drite më të fuqishëm përtej dritës së profecisë.”

Po, mirësitë që shihen te miqtë e Zotit janë një shfaqje e afrimitetit të tyre ndaj Allahut Teala dhe reflektim i dritës që përhapet nga kandili i profecisë te ata. Bashkëshortja e të Dashurit të Allahut, Pejgamberit tonë të Nderuar, Aishja, radijall-llahu anha, tregon:

“Një ditë Pejgamberi ynë i Nderuar po bisedonte me sahabët. Pranë tij gjendeshin Ebu Bekri dhe Omeri, radijall-llahu anhumu. Ato momente erdhi edhe Abbasi (r.a.). Ebu Bekri (r.a.), i hapi vend Abbasit. Ai erdhi dhe u ul ndërmjet Ebu Bekrit dhe të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Nisur nga kjo, i Nderuari ynë tha:

*“Vlerën e njerëzve të virtytshëm e dinë vetëm njerëzit e virtytshëm.”*

Kur Pejgamberi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, po fliste me xhaxhain e tij, e uli aq shumë zërin sa që Ebu Bekri (r.a.), i tha Omerit (r.a.):

“Kam frikë se Resulullahut i ndodhi diçka.” Pasi Abbasi, radijall-llahu anh, e mbaroi punën e tij dhe u largua, Ebu Bekri e pyeti Pejgamberin:

“O i Dërguari i Allahut! A nuk ishit mirë pak më parë?” Resulullahu (s.a.s.), iu përgjigj:

*“Jo, (isha mirë).”* Ebu Bekri (r.a.), ia ktheu:

“Vura re se e ulët zërin shumë, andaj u shqetësova.” I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, i tha:

*“Xhebraili më urdhëroi që të flas me zë të ulët në praninë të xhaxhait siç ju ka urdhëruar ju të flisni ngadalë në praninë time.”<sup>1</sup>*

Një ditë Zejd ibn Thabiti (r.a.), do t’i hipte kafshës së tij. Ibn Abbasi (r.a.), kapi yzengjinë. Zejdi (r.a.), i tha:



“O biri i xhaxhait të Resulullahut! Të lutem mos bëj kështu! Lëre atë!” Ibn Abbasi (r.a.), i tha:

“Ne jemi urdhëruar që të sillemi kështu ndaj dijetarëve dhe të mëdhenjve tanë!” Zejdi i tha:

“A mund të ta shoh dorën?” Kur Ibn Abbasi (r.a.), e nxori dorën, Zejdi ia puthi menjëherë dhe i tha:

“Edhe ne jemi urdhëruar që të sillemi kështu ndaj Ehli Bejtit të Pejgamberit!”<sup>2</sup>

Kur në qendër të marrëdhënieve të gjenden sinqeriteti, dashuria, respekti, mirësjellja, mirësia dhe fisnikëria, sigurisht se përreth përhapen aroma dhe begati të xhenetit. Sikundër kësaj, ambientet në të cilat gjenden fytyra të varura, fjalë që të ngulen si gjemba dhe shfaqje e mimikave që i përcmojnë robërit e Allahut, shndërrohen në një lloj xhehenemi në të cilin lartësohet tymi që nxjerrin flakët e ngurtësisë, urrejtjes dhe armiqësisë.

Kornizën e përmbajtjes së marrëdhënieve të miqve të Zotit me prindërit mund ta përmbledhim me këto dy fjalë: “Mirësjellje dhe respekt.” Që të dyja këto fjalë përdoren si një koncept kyç në marrëdhëniet me prindërit në Kuranin Fisnik i cili është fjala sublimë e Zotit (xh.xh.):

**“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti.”** (Isra, 23)

Fjala “ihsan/mirësi-mirësjellje” nga aspekti i kuptimit i ngjan një peme me fruta që rrënjët i ka thellë në tokë, kurse degët e përhapura në qiell. Është një koncept që vjen nga rrënja “husn” që do të thotë mirësi. Ajo do të thotë që diçka të bëhet në formën më të njohur, më logjike dhe më të bukur. Në të njëjtën kohë do të thotë që mirësia të bëhet me vetëdijen se Allahu na shikon. Po ashtu do të thotë që t’ia shtojmë mirësinë njeriut apo qenies që i jemi drejtuar duke e kryer këtë me të gjitha aftësitë dhe gjymtyrët tona të dukshme dhe të padukshme. Allahu na ka njoftuar se i do robërit e Tij të tillë dhe në lidhje me marrëdhëniet me të tjerët ka vendosur si pikë qëllimi “shkallën e mirësisë”.

Shprehja “Kavlen kerima – fjalë respekti” që përmendet në ajetin fisnik është jashtëzakonisht shumë interesante. Kjo shprehje do të thotë: “Thuaj fjalë respekti.” Fjala e respektit para së gjithash është një fjalë që e nderon bashkëbiseduesin. Të vërtetën se “fjala e bukur është lëmoshë”, e mësojmë nga hadithet e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). “Kerem” do të thotë bujari. Kurse “Kerim” në arabisht do të thotë bujar. Atëherë fjalën që do të përdoret për respekt, duhet ta përdorim në mënyrë bujare. Një bujari e tillë del nga zemra të mëdha që kanë shpëtuar nga

koprracia dhe janë dëlirë nga smira, mëkati, urrejtja dhe armiqësia. Gjithashtu fjala “kerim” mbart edhe kuptimet nder dhe krenari. Nisur nga ky kontekst, “t’u thuash fjalë respekti” prindërve, do të thotë që t’u flasësh atyre me fjalë të këndshme të cilat do t’i bëjnë ata të ndjehen të nderuar dhe krenarë, madje që do t’i bëjnë ata të ndjehen sikur u është shtuar nderi dhe dinjiteti.

Ja pra, miqtë e Zotit për shkak se posedojnë një zemër që ka shpëtuar nga papjekuria dhe që është zgjeruar e është bërë sa një oqean, e kanë shndërruar në natyrë të tyre pa e pasur aspak të vështirë cilësinë e një marrëdhënieje që lë mbresa edhe në mirësjellje, edhe në respekt. Ata kënaqësinë e prindërve e kanë konsideruar edhe si derë të kënaqësisë hyjnore, edhe si një prej shkaqeve më të larta për të arritur mëshirën hyjnore. Shembujt e pafund të kësaj është e mundur t’i shikojmë te selefu’s-salihin (të parët e devotshëm).

Transmetohet se Bajezidi Bistami, kuddise sirruh, i cili ishte prej kryesorëve të degëve të zinxhirit të artë, ka thënë:

“Çdo gjë që e kam kërkuar në të gjitha përpjekjet, pëhrizet dhe vetmi, e kam gjetur te kënaqësia e nënës. Një natë nëna kërkoi ujë prej meje. As në enë, as në ibrik nuk kishte mbetur ujë. Andaj shkova te përroi dhe i solla ujë. Nënë e kishte zënë gjumi. Nata ishte e ftohtë. Ndërkohë që mbaja enën në dorë, ajo u zgjua dhe e kuptoi situatën. Kur e pa enën të mbushur plot me ujë, u lut për mua dhe më pyeti: ‘Përse nuk e vendos enën në vendin e saj?’ Unë i thashë: ‘Kam frikë se nuk mund të të gjendem pranë kur të zgjohesh.’ Një herë tjetër nëna më tha: ‘Hapja njëren fletë derës.’ Për të mos vepruar në kundërshtim me urdhrin e nënës, mendova deri në kohën e mëngjesit se cilën fletë të derës duhet të hapja, fletën e djathtë apo atë të majtën. Papritur gjëja që po kërkoja hyri brenda në kohën e seherit (pak para agimit)! Nëna po lutej për mua: U bëfsh sulltani i të urtëve, bir!”

Sigurisht se kjo lutje e nënës së tij ka luajtur një rol të rëndësishëm në faktin që Bajezidi Bistami përkujtohet si “Sulltanu’l-Arifin / Sulltani i të Urtëve”. Edhe i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, është shprehur: “Unë jam lutja e babait tim, Ibrahimit.” I Dashuri i Allahut, Pejgamberi ynë i Nderuar po ashtu ka thënë se lutja e babait për fëmijën e tij është si lutja e pejgamberit. Lutjet e prindërve dhe fëmijëve për njëri-tjetrin duke i kërkuar Zotit falje dhe mëshirë, duhet të shndërrohen në një tablo lutjesh të një marrëdhënieje të mrekullueshme. Edhe këto ajete le t’i shikojmë me këtë sy:

“(Ibrahimi lutej kështu:) **O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet! O Zoti ynë, më fal**

***mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditën, kur do të jepet llogari!***” (Ibrahim, 40-41)

***“Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: “O Zot! im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!”***” (Isra, 24)

Lutja e ndërsjellë është një shenjë që tregon cilësi në marrëdhëniet njerëzore. Sahibu’l-Vefa Musa Efendiu u shpreh si më poshtë duke iu përgjigjur një pyetjeje që iu bë përgjatë një reportazhi me të:

“Çdo lëmoshë që e kam dhënë, ua kam bërë dhuratë shpirtit të hoxhës, babait dhe nënës sime. Pas namazit të mëngjesit të çdo dite kam kënduar një Fatiha dhe tri herën suren Ihlas për shpirtin e babait dhe të nënës.”

Kjo lutje që ka bërë për pasardhësit e vet në testamentin e tij është shumë e veçantë:

“(O Zot!) Ndhimoi qoftë trashëgimtarët e mi, qoftë pasardhësit e tyre që do t’i pasojnë! Të gjithëve jepu një besim të fortë dhe mos i bëj prej atyre që bien në dembelizëm, në mënyrë që, ndërsa vazhdojnë me adhurimin në njërën anë, në anën tjetër t’u shërbejnë robërve të Tu dhe të bëhen prej atyre që të njësojnë në çdo moment!”

Ka edhe marrëdhënie të tilla që nuk i lënë fuqi njeriut për t’i ngritur duart e për të bërë lutje. Ne i kërkojmë mbrojtje Allahut (xh.sh.), prej gjendjeve të tilla.

Mesa Efendiu, rahmetullahi alejh, ishte një njeri që mahnitej ndaj babait të tij. Mëshirën dhe seriozitetin që kishte babai i tij, i mori si shembull për vete. Gjithmonë thoshte:

“Allahu e mëshiroftë, babai im ka qenë një njeri shumë serioz dhe me dinjitet. Të gjithë edhe e kishim frikë, edhe e donim. Në shtëpi bëhej fëmijë me fëmijët dhe i madh me të mëdhenjtë. Ne një jetë të tillë kemi bërë. Të frikësuarit e familjes me shumë frikë, nuk është diçka që sjell sukses. Askush nuk duhet të fshihet prej frikës, por jeta duhet të bëhet duke qenë të gjithë bashkë. Tashmë të gjithë i rrisin fëmijët sikur të jenë princa. Dikush thotë se fëmija im është luan, dikush tjetër thotë se fëmija e tij është tigër. Fëmijëve u japin para dhe nuk u kërkojnë llogari për to. Babai im një ditë mori prej meje pesë grosh. Këtë nuk e harroj asnjëherë. Atëherë çmimi i gazetës ishte pesë grosh. Pas një muaji më tha: “Musa merri. Këto pesë grosh i kam pas marrë prej teje.” Ja, kështu na kanë rritur me përpikëri elhamdulil-lah.”

Mirësjellja dhe respektimi i prindërve kërkohet edhe kur të jenë gjallë, edhe pasi të kenë vdekur. Kjo është një pjekuri tjetër e edukatës dhe marrëdhënieve. Lutja dhe të kërkuarit e faljes nga Zoti për ata pasi të kenë ndërruar jetë, përpjekja për t’ua mbajtur premtimet, vazhdimësia në mirësi e respekt

ndaj të afërmeve të tyre dhe respekti e interesimi i ngrohtë ndaj miqve të tyre janë prej këshillave profetike.<sup>3</sup>

Abdullah ibn Dinari tregon:

Një herë Abdullah ibn Omeri (r.a.), mori rrugën për të shkuar në Mekë. Me vete kishte një gomar mbi të cilin pushonte kur mërzitej nga qëndrimi mbi deve dhe një çallmë që e kishte vendosur në kokë. Një ditë kur Abdullah ibn Omeri po pushonte mbi gomar, rastisi në një beduin. Atë e pyeti:

“A nuk je ti filani i biri i filanit?”

Kur burri iu përgjigj:

“Po.”, gomarin ia dha atij dhe i tha:

“Hipi këtij.” Edhe çallmën që e kishte në kokë ia zgjati atij dhe i tha: “Edhe këtë vendose në kokë.”

Njëri prej shokëve e pyeti Ibn Omerin (r.a.):


“Allahu të faltë! Ia dhe kot këtij beduini gomarin mbi të cilin pushon dhe çallmën që e vendos në kokë.” Kurse Ibn Omeri (r.a.), ia ktheu:

“Unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), duke thënë: “*Mirësia më e madhe është që njeriu të interesohet për familjen mike të babait të tij pasi ky i fundit të ketë ndërruar jetë.*” Babai i këtij burri ka qenë miku i Omerit (babait tim), (r.a.)”<sup>4</sup>

Në këtë periudhë kur mungesa e respektit është përhapur në emër të besimit ndaj vetes dhe përgjegjshmëria në emër të lirisë, madje që po inkurajohet përhapja e tyre, nuk dihet se çfarë kuptimi mbarin këta shembuj për njeriun e kohës. Por sidoqoftë ky është paragykim për robërit e Zotit dhe mungesë edukate kundrejt Krijuesit. Atëherë asnjëherë nuk duhet ta humbim shpresën dhe duhet ta gjejmë një metodë për ta shndërruar mirësjelljen dhe respektin në natyrën tonë të vërtetë. Përgjatë këtij kërkimi nuk kam aspak dyshim se edhe miqtë e Zotit do të na ndihmojnë duke na treguar rrugën dhe duke na orientuar si të ishin pishtarë ndriçues.

## **MARRËDHËNIET ME FËMIJËT**

Dëshira për fëmijë është një dëshirë e natyrshe. Në njëfarë mënyre, njeriu dëshiron të ruajë ekzistencën e tij me anë të pasardhësve të tij. Ai s’mund ta pranojë zhdukjen e trashëgimisë së tij materiale dhe shpirtërore pasi të ketë emigruar nga kjo botë.



dëshiron trashëgimtarë të mirë nga gjaku i vet. Kjo dëshirë, në Kuranin Fisnik shprehet kështu në emër të profetit Zekerija (a.s.):

**“Kur ai e thirri Zotin e vet me lutje të fshehtë (duke thënë): «O Zoti im! Eshtrat tashmë më janë dobësuar, koka më ndriçon nga thinjat dhe asnjëherë nuk kam mbetur i zhgënjyer nga lutja ime për Ty, o Zoti im! Unë u frikësohem (sjelljeve të) të afërmve të mi pas meje, ndërsa bashkëshortja ime është beronjë; andaj, më dhuro nga ana Jote një pasardhës, që të më trashëgojë mua dhe familjen e Jakubit. O Zoti im, bëje atë të pëlqyeshëm (për Ty)!»”** (Merjem, 3-6.)

Siç mund të shihet në shembullin e profetëve, njerëzit e devotshëm janë shumë të kujdesshëm kur kërkojnë nga Zoti i tyre t'i bekojë me fëmijë. Ata nuk duan thjesht; jetë fëmijë, pa le të jetë si të jetë, por duan «breza të pastër, që të kënaqin zemrën, të ndriçojnë sytë dhe të ngjallin ndjenjën e falënderimit kur i shikon në fytyrë». Një brez i tillë është si një mirësi e madhe për prindërit e tij, mëshirë më e begatë që mund t'i dhurohet njerëzimit dhe një vepër e mirë që i është ofruar Zotit. Natyrisht se, të kesh breza të tillë, edhe pse është një dhoratë e Zotit, kërkon edhe një çmim.

Kujdesi dhe komunikimi me fëmijën është një marrëdhënie shumë dimensionale, e larmishme dhe afatgjate. Trupi i tij dëshiron të ushqehet, mendja e tij dëshiron të ndriçohet, zemra dhe ndjenjat e tij kërkojnë të jenë të ngopura. Njerëzit e devotshëm i kushtojnë kujdes të madh faktit që ushqimi i trupit të jetë hallall dhe i mirë, që mendja të ndriçohet me dituri të dobishme, mençuri dhe kulturë dhe që zemra të ngopet me njohjen e Allahut, dashurinë për Të, përmendjen e Tij dhe ndjenja pozitive. E ndërsa i bën të gjitha këto, synimet dhe qasjet e tij drejt këtyre mirësive të Allahut, metodat dhe mënyrat e komunikimit dhe së fundmi, përmbajtja e interesit të tij, janë në një nivel të lakmueshëm.

Në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, shohim se miqtë e Allahut marrin masat e duhura, si për të tashmen, ashtu edhe për të ardhmen e tyre, dhe më pas ia lënë gjithçka në dorë Allahu duke u mbështetur tek Ai. Ata i kryejnë detyrat e tyre ndaj tyre në mënyrën më të mirë, me urtësi dhe maturi, në përputhje me arsyen e shëndoshë dhe ligjet e Allahut, gjë që përbën aspektin e marrjes së masave në këtë çështje.

E megjithëkëtë, për shkak se besojnë në mënyrë të sigurt se, jo gjithçka është në duart e tyre, ata kurrë nuk harrojnë t'ia lënë Allahut fundin e fëmi-



jëve të tyre. Imam Sharani, një nga dijetarët tanë të mëdhenj, përshkruan një nga përvojat e tij mbi këtë çështje:

“Personalisht, përkundër dëshirës time të madhe, nuk munda t'ia bëj të dashur studimin djalit tim, Abdurrahmanit. Ndërkohë që isha duke menduar se çfarë të bëja, Allahu i Madhërishtëm e frymëzoi kështu zemrën time: «Kjo është diçka që mund të realizohet me ndihmën e Allahut. Unë nuk kam forcë të mjaftueshme për këtë; prandaj këtë punë duhet t'ia lë Allahut në dorë». Po, kështu më erdhi përbrenda dhe kështu veprova. Po ç'të shoh; në mëngjesin e asaj nate, Abdurrahmani kishte filluar të studionte vet. Që nga ajo ditë, ai filloi të shijojë kënaqësinë dhe ëmbëlsinë e dijes. Madje, të kuptuarit e tij u zhvillua aq shumë, sa që ai filloi të tregonte epërsi edhe ndaj atyre që kishin filluar të mësonin dije shumë vite para tij. Po ashtu, Allahu më shpëtoi nga mundimet për shkak se unë u mbështeta tek Ai. Zoti i Plotfuqishëm e bëftë atë nga dijetarët që punojnë me dijen e tyre. Amin!».

Alijju-Havvas -rahmetullahi alejhi- thotë :

*«Gjëja më e dobishme që dijetarët, të cilët punojnë me dijen e tyre, mund të bëjnë për fëmijët e tyre, është që çështjen e tyre t'ia dorëzojnë Allahut dhe të luten për ta.»*

Ndërsa Mufesiri i njohur, Elmallëllë Muhammed Hamdi Yazër, na paralajmëron kështu, që çështja e mbështetjes në Allahun të mos e keqkuptohet: “Allahu nuk duhet t'i lëmë detyrat dhe përgjegjësitë tona,



*por përfundimin dhe rezultatet e punës sonë.”*

Megjithëse kurrë nuk e neglizhuan këtë aspekt shpirtëror të kësaj çështjeje, njerëzit e devotshëm i kushtuan vëmendje edukimit të fëmijëve të tyre sikur gjithçka të ishte në duart e tyre. Parimi kryesor që përcakton cilësinë dhe përmbajtjen e marrëdhënieve njerëzore, është i fshehur në masën dhe vendin që njeriu i jep tjetrit në zemrën e tij. Këta njerëz të mëdhenj, tek të cilët shohim bukuritë e edukatës hyjnore dhe profetike, para së gjithash, fëmijët e tyre i konsideruan si amanet dhe dhuratë e Zotit për ta. Ata kurrë nuk e konsideruan veten si pronarët, mbizotëruesit dhe zotët e fëmijëve të tyre. Në këtë aspekt, për shkak se ishin robër të mirë të Zotit, në vend që të pretendonin pronësi mbi ta, ata vepruan si shërbyes, udhëzues dhe lutës për fëmijët e tyre, të ushqyer nga dashuria, mëshira dhe ndjenjat e përgjegjësisë dhe falënderimit ndaj Allahut. Dhe si rezultat i natyrshëm i këtij këndvështrimi:

- Ata nuk e paralizojnë vullnetin e fëmijëve të tyre. Nuk i trajtojnë ata si robër dhe robotë duke i bërë shërbëtorë dhe skllëvër personal. Ata preferojnë t'u mësojnë disiplinën e vullnetit duke u vënë në punë dhe zhvilluar mendjen, zemrën dhe aftësitë e tyre. Kjo gjendje reflekton në marrëdhëniet e tyre në një mënyrë shumëplanëshe. Para së gjithash, ata e shohin fëmijën si një person që mund të marrë përgjegjësi sipas moshës së tij, e jo me syrin se nuk

kupton asgjë, duke menduar se “ai është thjesht një fëmijë”. Ata e lejojnë atë të bëjë disa gabime bazuar në moshën e tij. Por nga ana tjetër, gabimet e tyre i përdorin si mjet për të marrë mësim dhe të zhvillohen, e jo që fëmijët të traumatizohen dhe të mbyllën në vetvete.

- Po ashtu, edhe në lidhje me lirinë e vullnetit, ata vendosin kufij legjitimë dhe të arsyeshëm. Për rrjedhojë, ata nuk i lejojnë fëmijët e tyre të shkojnë përtej kufijve dhe të bien pre e dëshirave të panevojshme të egos. Ata i kontrollojnë fëmijët e tyre në distancë, në mënyrë të kujdesshme dhe të informuar, pa i mërzhitur dhe pa ua cenuar personalitetin. Ky kontroll nganjëherë realizohet personalisht, e nganjëherë indirekt, përmes të tjerëve. Për shkak se presioni i disiplinës në një masë të atillë që fëmija mund të rebelohet kundër tij, do të thyehte lidhjen midis tyre, në këtë pikë, ata veprojnë me arsye, maturi dhe mençuri, e jo me ndjenja. Po ashtu, për shkak se gradualizmi në arsim është metodë hyjnore, ata synojnë zhvillimin dhe përparimin hap pas hapi duke e forcuar me kalimin e kohës, e jo të arrijnë rezultat të menjëhershëm. Nga metodat e komunikimit të miqve të Allahut, është edhe që fëmijëve të mos ua përplasësh gabimet në fytyrë; ndonjëherë ato injorohen dhe bëhet përpjekje që ato të eliminohen me shprehje dhe sjellje indirekte, më tepër sesa me metodën e këshillës dhe predikimit.

■ **REFERENCAT:** 1) Ali el-Muttaki, *Kenz*, XIII, 514/37321. 2) Ali el-Muttaki, *Kenz*, XIII, 396/37061. 3) Shik. Ebu Davud, *Edeb* 120. Veçanërisht shik. Ibn Maxhe, *Edeb* 2. 4) Muslim, *Birr* 11–13. Veçanërisht shik. Ebu Davud, *Edeb* 120; Tirmidhi, *Birr* 5.

# ISLAMI

## UJË I RRJEDHSHËM, I PASTËR DHE I QETË

— Soner Duman —

Burimi i jetës për të gjitha gjallesat është uji. Uji mund të pihet nga gjallesat vetëm atëherë kur është në gjendje të lëngshme. Ju nuk mund ta pini atë kur e avulloni me nxehtësi ose e ftohni dhe e ktheni në akull. Për ta ruajtur ujin në gjendje «të lëngshme», duhet ta mbani atë në një temperaturë ndërmjet zero dhe njëqind gradë.

Uji në gjendje të natyrshme nuk ka erë, shije dhe ngjyrë. Nëse shtoni në të ndonjë substancë me ngjyrë, siç është boja, uji merr ngjyrën e saj. Po ashtu, nëse në të shtoni ndonjë substancë të tillë si uthulla, uji do të fillojë të mbajë era uthull. Nëse shtoni sheqer ose kripë, shija e ujit do të ndryshojë sipas tyre. Që uji të mbetet në gjendjen e tij të natyrshme, ngjyra, shija dhe aroma e tij nuk duhet të ndryshohen.

Po kështu edhe Islami, feja e Allahu është njësoj si uji. Shpallja hyjnore është burimi i këtij uji, ndërsa Profeti është çezma nga ku ky burim u përcillet njerëzve. Kjo fe është burimi i jetës për njerëzimin. Këtë fakt, e tregon qartë edhe ky ajet fisnik:

**“O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë!..”** (Enfal, 24.)

Kur kjo fe mbetet në formën e saj natyrale, kur nuk ndotet nga ndërhyrjet e jashtme dhe nuk prishet, është plotësisht në përputhje me natyrën njerëzore. Për rrjedhojë, është e pamundur që njerëzit ta refuzojnë atë nëse ajo u shërbehet njerëzve në gjendjen e saj të natyrshme të paprekur. A mundet që njeriu me një natyrë të pastër të jetojë pa ujë? Kur atij i ofrohet ujë, a do ta refuzojë atë?





**“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”** (Rum, 30.)

Nëse një person refuzon ujin që i ofrohet, mund të ketë dy arsye për këtë: Natyra e atij personi është prishur, ose uji që ofrohet ka humbur gjendjen e tij natyrore dhe është ndryshuar.

Gjatë historisë, në ujin që buronte prej shpalljes hyjnore dhe iu është ofruar njerëzimit nga çezma e profetëve, janë bërë shumë ndërhyrje njerëzore. Ndonjëherë, ky ujë është kthyer në akull dhe ka ngrirë, e ndonjëherë ka avulluar e ka humbur. E herë të tjera, gjërat që përziheshin në të e kanë ndotur.

Mesazhet e profetëve të dërguar para Muhamedit (a.s.) u prishën në të njëjtën mënyrë nga ndërhyrjet e njerëzve. «Teurati», të cilin Allahu ia ofroi njerëzimit me anë të Musait (a.s.), e humbi formën e tij origjinale si pasojë e ndërhyrjeve njerëzore. Po kështu edhe «Inxhili», që iu ofrua njerëzimit me anë të Isait (a.s.), e humbi formën e tij origjinale me ndërhyrjet e njerëzimit. Më në fund mirësia hyjnore i ofroi njerëzimit ujin e «Kuranit» përmes çezmës së Muhammed Mustafait (a.s.). Allahu e paraqiti atë në një mënyrë të tillë, që ky ujë të mos humbasë kurrë gjendjen e tij natyrore; ai do të mbetet gjithmonë i pastër, i lëngshëm, i kthjellët dhe i qetë siç ka ardhur nga burimi i tij.

Por...

Nuk është e mundur të thuhet e njëjta gjë për gjërat që i ofrojmë njerëzimit duke marrë nga ky ujë. Megjithëse Islami ruan gjendjen e tij natyrore si një fe nën mbrojtjen e Allahut, uji që ne mbushim nga burimi i Islamit dhe ua shërbejmë njerëzve, jo gjithmonë mund ta ruajë natyrshmërinë me të njëjtën pastërti që ka burimi.

Le t’i hedhim një vështrim atyre që sot i shërbejmë njerëzimit si «Islam» ... Vallë, a po ofrojmë ujë duke e ruajtur atë në gjendjen e tij të pastër, të kulluar dhe të kthjellët, apo duke e modifikuar atë?

Disa prej nesh, me mendimet dhe praktikatat që paraqesim në lidhje me Islam, e kanë bërë atë të ngurtë dhe të ftohtë. Si rezultat i praktikave tona, në formën që Islami manifestohet tek ne, ai per-

ceptohet si një fe fikse, statike dhe e papajtuashme me realitetet e jetës. Për rrjedhojë, një pjesë e njerëzve e refuzuan Islam, e paraqitur në këtë formë. A i jepet akull një personi të etur? A pihet akulli?

Ndërsa disa të tjerë prej nesh, me mendimet dhe praktikatat që kanë paraqitur në lidhje me Islam, e kanë kthyer atë në një plastelinë që mund të marrë çdo formë, pa shtyllë kurriore dhe paqëndrueshmëri. Dhe, si rezultat i këtyre praktikave, Islami i shfaqur tek ne avulloi. Ky lloj Islami është kthyer në një mbështetëse që miraton çdo mendim dhe mbështet çdo praktikë si një noter. Pra, edhe Islami që ne e paraqitëm në këtë formë, nuk i kënaqi njerëz të shumtë. A i jepet avull një personi të etur? A pihet avulli?

Nga ana tjetër, disa nga ne, u përpoqën t’ia ofrojnë njerëzimit Islam, duke e përzierë me mendimet tona. Mirëpo, njerëz e refuzuan edhe këtë ujë, sepse nuk u pëlqente ngjyra, shija dhe aroma e krijuar nga gjërat që përziemë në atë ujë.

Prandaj, duhen pasur parasysh dy gjëra:

Në mënyrë që ta paraqesim Islam, ashtu siç vjen nga burimi i tij, ne duhet ta mbajmë atë në gjendjen e tij «fluide». Me fjalë të tjera, asnjëri prej nesh nuk ka të drejtë ta paraqesë Islam, as si një fe të ngurtë, të ftohtë e të fiksuar dhe as ta avullojë atë. Po ashtu nëse ato që ne i paraqesim njerëzimit në lidhje me Islam, janë mendimet tona personale dhe të medhhebit që ndjekim, ne jemi të detyruar t’i paraqesim ata jo si «Islam» por si «mendimet tona rreth Islamit». Për shembull, nëse ne bëjmë çaj me ujin që marrim nga çezma, kur ia shërbejmë njerëzve, e paraqesim atë si «çaj» jo si «ujë». Njëjtë si kjo... Edhe medhhebin tonë, prirjet dhe pikëpamjet tona, duhet t’i paraqesim si “ajo që ne e kuptojmë; që mund të jenë të drejta ose të gabuara”.

Detyra e dijetarëve është të përpiqen ta ruajnë Islam në një gjendje të pastër dhe të rrjedhshme ashtu siç ka ardhur nga burimi i tij dhe të mos u japin mundësi atyre që përpiqen ta bëjnë atë të fortë dhe të ftohtë, apo atyre që përpiqen ta avullojnë atë.

Allahu na e bëftë të mundur ta paraqesim ta kuptojmë dhe ta jetojmë siç duhet Islam, i cili është i pastër, i rrjedhshëm dhe i kthjellët! Amin!

*Le t’i hedhim një vështrim atyre që sot i shërbejmë njerëzimit si «Islam» ... Vallë, a po ofrojmë ujë duke e ruajtur atë në gjendjen e tij të pastër, të kulluar dhe të kthjellët, apo duke e modifikuar atë?*



# THIRRJA PËR VETËDIJËSIM

*“Nuk kam parë/nuk njoh vend të ngjashëm me xhehenemin, ndërkohë që fle në gjumin e shkujesjes ai që ikën prej tij. Po ashtu, nuk kam parë/nuk njoh vend të ngjashëm me xhenetin, ndërkohë që fle në gjumin e shkujesjes ai që e kërkon atë.”<sup>1</sup>*

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

## SHKUJDESJA DHE DEMBELIZMI

Gjumi në kulturën tonë konsiderohet si një shenjë e shkujesjes dhe dembelizmit. Shprehja “njeri gjumash” dhe “njeri dembel” pothuajse përdoren në kuptim të njëjtë. Edhe ata që nuk interesohen me ato që ndodhin përreth tyre sikur të jenë në gjumë edhe pse janë të zgjuar, cilësohen si njerëz që “ecin duke fjetur” apo si njerëz në “gjumin e shkujesjes”.

Ndërsa njeriu që është në gjumë apo që fle, për të cilin flitet në hadithin e mësipërm, përfaqëson një shkujesje pak edhe më të madhe, sepse njeriu që nuk e posedon zgjuarsinë që i ka hije dëshirës për të qenë larg xhehenemit edhe pse kjo dëshirë mbështetet në një nijet dhe qëllim në vetëdijshëm, prapë se prapë është cilësuar si njeri në gjumë. Kjo sigurisht se do të thotë “një gjumë shkujesjeje që zgjat për të gjithë jetën”.

Në të njëjtën mënyrë, edhe pse dëshira për të hyrë në xhenet është një dëshirë e vetëdijshme dhe e vlefshme, këmbëngulja për të mos bërë punë të dobishme e të mira që i kërkon hyrja në xhenet formon një gjendje shkujesjeje dhe mungese aktivizimi afatgjatë që është shumë e vështirë për t’u kuptuar dhe shpjeguar.

## PARALAJMËRIMI PËR VETËDIJËSIM

Është një e vërtetë që dihet se, çdo njeri që beson në botën tjetër dhe shqetësohet për llogarinë që do të japë, mbart frikën ndaj xhehenemit dhe shpresën për në xhenet. Lutjet janë të ndërtuara mbi dëshirën për të qenë larg njërit dhe për të hyrë te tjetri. Edhe kur njeriu kërkon “kënaqësinë e Allahut”, në fakt dëshiron të qëndrojë larg xhehenemit dhe të hyjë në xhenet. Sepse ai e di se Allahu Teala nuk do ta fusë në xhehenem robin prej të cilit është i kënaqur.

Edhe një e vërtetë tjetër që dihet është kjo: Qëndrimi larg xhehenemit dhe hyrja në xhenet nuk është një mirësi që formohet vetvetiu. Si çdo lumturi tjetër edhe këto dy mirësi kanë një çmim. Kështu në një ajet fisnik thuhet: **“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.”<sup>2</sup>**

*Një e vërtetë shumë e qartë është kjo se për atë që dëshiron ta realizojë dëshirën, pritshmërinë apo qëllimin e tij, nuk ka rrugëzgjdhje tjetër përveçse të rrijë larg gjumit të shkujesjes, të veprojë në mënyrë të vetëdijshme dhe të përpiket.*

Padyshim se për të bërë “vepra të mira” së pari duhet të jemi të vetëdijshëm dhe pastaj të posedojmë ndjenjën e “ihsanit”, domethënë të përpiqemi për ta adhuruar Allahun sikur e shohim Atë. Edhe pse ne nuk e shohim Atë, të paktën asnjëherë nuk duhet ta harrojmë të vërtetën absolute<sup>3</sup> se Ai na shikon ne, sepse Allahu Teala ka thënë në një ajet fisnik:

**“Atij që shmanget nga Këshilla e të Gjithëmëshirshmit (Kurani), Ne do t’ia caktojmë një djall, që do t’i bëhet shok i pandashëm. Në të vërtetë, djajtë i shmangin jobsimtarët nga rruga e drejtë, ndonëse ata mendojnë se janë të udhëzuar drejt.”<sup>4</sup>**

Ndërsa në një ajet tjetër fisnik i tregohet Pejgamberit (s.a.s.), se çfarë duhet të bëjë:

**“Përmende Zotin tënd me vete, i përlurur dhe me frikë – jo me zë të lartë, në mëngjes dhe mbrëmje, dhe mos u bëj nga ata që nuk i kushtojnë vëmendje!”<sup>5</sup>**

Prej këtyre ajeteve fisnike kuptohet qartë se gjendja e gjumit që theksohet në hadith do të thotë “shkujdesje ndaj Allahut” dhe se ai që kërkon lumturinë e ahiretit është i obliguar për të mos qenë prej të shkujdesurve në këtë kuptim.

Në një hadith fisnik tregohet kështu rrugëzgjdhja për gjumin e shkujdesjes prej të cilit duhet të qëndrojnë larg ai që ikën prej xhehenemit dhe rend drejt xhenetit:

**“Atë, të cilit i pëlqen të shpëtojë nga xhehenemi dhe të futet në xhenet, le ta gjëje vdekja me besim ndaj Allahut e ahiretit dhe kundrejt njerëzve le të sillat siç i pëlqen që ata të sillen ndaj tij.”<sup>6</sup>**

Domosdoshmërinë për ta pritur vdekjen me besim e gjejmë edhe në një hadith tjetër të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.): **“Çdo rob do të ringjallet në gjendjen që ka vdekur.”<sup>7</sup>**

Shkuarja me besim në botën e përtejme, e cila është gjëje e vetme e vlefshme atje, është kusht absolut për t’u siguruar nga shqetësimet e asaj jete dhe për të arritur ato që shpresohen. Baza e parë e kësaj është që të jetojmë në këtë botë duke qenë të vetëdijësuar e me besim dhe duke e pritur vdekjen me iman. Sepse të shfaqësh veprime që t’i kërkon dëshira dhe qëllimi është vetëdijësim. Ndërsa të mos veprosh sipas kësaj dhe të mjaftohesh vetëm me

dëshirën, do të thotë të gjendesh në një shkujdesje absolute. Kjo gjendje nuk i shkon as atij që dëshiron të qëndrojë larg xhehenemit, as atij që rend drejt xhenetit. Në të kundërt, siç paralajmërohem në hadithin fisnik, në pah del një gjendje e habitshme dhe një kontradiktë e thellë dhe e heshtur që të çudit në të cilën fle gjumë edhe ai që ikën prej xhehenemit, edhe ai që rend drejt xhenetit. Ja pra, Pejgamberi ynë i Nderuar e shtron para sysh këtë gjendje të çuditshme në hadithin fisnik që po shpjegojmë. Në këtë mënyrë, ai bën një vërtetim të përgjithshëm të situatës dhe një paralajmërim serioz.

Këtu është e dobishme që ta cekim edhe këtë pikë: Të jesh në veprim jo gjithmonë do të thotë të jesh i vetëdijshëm, sepse siç thuhet edhe në hadith, ikja dhe rendja janë veprime. Andaj këto veprime bëhen pa e kuptuar, pa vetëdije dhe në mënyrë të shkujdesur. Ose këto dy veprime bëhen duke qenë larg vetëdijesimit që kërkojnë ato. Pikërisht siç ndodh që nuk e dimë se çfarë kemi kënduar apo se sa rekatë kemi falur përgjatë namazit kur e falim në gjendje të shkujdesur. Në ajetet fisnike që radhisin cilësitë e besimtarëve që do të shpëtojnë, cilësia e dytë që vjen pas besimit është: **“Ata të cilët janë të përkushtuar, vetëdijshëm dhe respekt të madh në namaz”<sup>8</sup>** Kjo tregon qartazi se vetëdijësimi i vërtetë është që të jesh i vetëdijshëm plotësisht për punën që bën. Nëse fle gjumë ai që ikën nga xhehenemi dhe ai që rend drejt xhenetit, atëherë do të thotë se ata janë larg një vetëdijesimi të tillë.

Hadithi është një paralajmërim dhe thirrje për një vetëdijësim të plotë siç jemi munduar ta shprehim që në fillim. Një e vërtetë shumë e qartë është kjo se për atë që dëshiron ta realizojë dëshirën, pritshmërinë apo qëllimin e tij, nuk ka rrugëzgjdhje tjetër përveçse të rrijë larg gjumit të shkujdesjes, të veprojë në mënyrë të vetëdijshme dhe të përpiqet. Ajo që dëshiron të shprehë në strofën e mëposhtme poeti i ndjerë Mehmet Akif Ersoji, me shumë mundësi duhet të jetë nxjerrja në pah e një kornize të një vetëdijesimi të tillë:

**“Mbështetu te Allahu, përpiqu dhe përmbaju urtësisë,**

**Nëse ka ndonjë rrugë (të drejtë), atëherë kjo është ajo, sepse unë nuk di rrugë tjetër!”<sup>9</sup>**

■ **REFERENCAT: 1)** Tirmidhi, Sifat u xhehenem 10 (Hadithi nr. 2651) (Shik. Tuhfetu'l-Ahvazi, VII, 228.) Tirmidhiu thotë se hadithi njihet si transmetim i Jahja ibn Ubejdullahut, se Jahja është një transmetues i dobët sipas shumicës së dijetarëve të hadithit dhe se esh-Shu'be ibn Haxhxhaxhi e ka kritikuar atë. Hadithi pranohet si “hasen”. Pasi Ibn Ebi Shejbe hadithin fisnik e transmeton në Musannefin e tij si fjalë të Herim b. Hajjanit (XIII, 176, 563) dhe el-Bejhakiu pasi e transmeton nga Ebu Hurejra si merfu siç shihet më lart, pas një pyetjeje që iu drejtua shprehet se i njëjti transmetim është transmetuar edhe si merfu, edhe si mekfuf nga Abdullah ibn Mes'udi (r.a.). (Shuabu'l-Iman, I, 601.) Përveç të tjerash hadithi fisnik është transmetuar si merfu, domethënë si fjalë e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në ez-Zuhd ve'r-Rekaik të Abdullah ibnu'l-Mubarekut dhe në el-Mu'xhemu'l-Evsat të et-Taberanit. **2)** Shik. Mulk, 2. **3)** Shikoni përkufizimin e ihsanit në hadithin e Xhibrililit (ta adhurosh Allahun sikur e sheh, sepse edhe nëse ti nuk e sheh, Ai të sheh ty). **4)** Zuhruf, 36-37. **5)** A'raf, 205. **6)** Ahmed ibn Hanbel, Musned, II. 191. **7)** Muslim, xhennet, 83. **8)** Mu'minin, 2. **9)** Safahat, fq. 422. Stamboll, 2010 (Botimi i Acar Bilgi Merkezi, Publikim i Bashkisë Metropolitane të Ankarasë.)



# RRUGA E EHL-I SUNNETIT TEK IMAM RABBANI

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Ehli-Sunneti; është emri i degës kryesore që përqipet të kuptojë dhe jetojë Islamin në mënyrën që e kuptuan Profeti ynë (a.s.) dhe shokët e tij të dashur. Vendi që zë Kur > ani dhe Profeti i Allahut (a.s.), në jetën fetare Islame është i qartë. Nëse lëmë mënjanë disa rryma që kohët e fundit përjashtojnë sunnetin, këto dy burime nuk janë diskutuar kurrë. Konflikti kryesor midis grupeve fetare ka qenë në lidhje me sahabët dhe, shumica e sekteve të devijuara kanë rënë në këtë situatë për shkak se kanë përjashtuar sahabët. Kurse në botëkuptimin sunnit, të gjithë sahabët duhen dhe respektohen pa dallim midis tyre. Madje, edhe Islami jetohej në formën që ka ardhur prej tyre.

Besimi është një kusht i pranimit të veprave dhe, gabimet e bëra në çështjet e besimit, çojnë në shkatërrim. Prandaj, Imam Rabbani dëshiron

që ata të cilët do të hyjnë në rrugën e shpirtërore, pikësëpari duhet të ndjekin sistemin e besimit të Ehli Sunetit:

*«Detyra e parë farz për njerëzit me mendje të shëndoshë, është të korrigojnë sistemin e besimit e tyre sipas besimit të Ehl-Sunetit dhe xhematit, sepse këta janë grupi që ka arritur shpëtimin.»* (I, Letra e 266-të)

Sipas Imamit, çështja e dytë pas kësaj është që besimtari të përmbushë pa mangësi rregullat e Shariatit. Vetëm ai që i plotëson këto dy kushte mund të hyjë në këtë udhë dhe të përparojë në rrugën e shpirtërore:

*«Pas plotësimit së dy anëve në lidhje me besimin dhe veprat, është e nevojshme që me lejen e Allahut të Madhërishëm të hyni në rrugën shpirtërore. Qëllimi i hyrjes në këtë rrugë nuk duhet të jetë arritja e*

*diçkaje shtesë dhe të re në lidhje me besimin dhe veprimet. E në fakt, një dëshirë e tillë, do të ishte rendje pas përpjekjeve të mëdha dhe qëllimeve të tjera që shkaktojnë rrëshqitjen e këmbës nga rruga e vërtetë. Qëllimi i hyrjes në këtë rrugë, është që të fitohet bindje dhe siguri e plotë në lidhje me gjërat që besohen. Aq, sa besimi i të devotshmit të bëhet i palëkundur nga konfuzionet që shkaktojnë skeptikët...”* **“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”** (Rad, 28.) (Letra e 266-të)

Imam Rabbani nuk i pranon verbërisht të gjitha fjalët e të gjithë sufistëve që kanë rënë në fanatizëm të zymtë, siç shihet shpesh sot. Veçanërisht, idetë që dëmtojnë besimin e Ehli Sunetit i refuzon pavarësisht nga origjina e tyre. Megjithatë, ai na mëson të sillemi mirë në lidhje me ndryshimet e mendimeve midis myslimanëve. Ai nuk pranon të përjashtojë një besimtar për gabimin e tij më të vogël, siç është bëhet sot. E po ashtu, nuk pranon as ta bëjë tekfir atë. Të akuzosh pa mëshirë në emër të Ehli Sunetit dijetarët dhe njerëzit e dijes të cilët pranohen nga myslimanët, zgjedhja e disa prej mendimeve të tyre me piskatore dhe paraqitja e tyre si njerëz heretikë, sipas tij, është një krim i që vështirë mund të falet.

Gjithashtu, qëndrimin e tij të moderuar, i cili shkaktoi debate të thella mes sufive, mund ta shohim edhe në lidhje me Ibn Arabiun. Imami i konsideron në kundërshtim me Ehli Sunetin disa nga pikëpamjet e Ibn Arabiut, por i sheh ato si një gabim në ixhtihad dhe nuk flet pa kriter për këtë sufi të madh. Kjo, sepse sipas Ehli Sunetit, njerëzit e kiblës nuk bëhen tekfir. Nëse njerëzit që pasojnë rrugën e drejtë kanë mendime që janë të hapura për interpretim, ato ose interpretohen në favor të tyre ose çështja përqendrohet vetëm në atë pikë. Ata që kanë gjendje të ndryshme nga Sufistët, nëse nuk kanë ndonjë vepër që kundërshton hapur Sheriatin, gjendja e tyre i referohet Allahut. Për rrjedhojë, edhe Imami, duke vepruar sipas këtij rregulli, në lidhje me Ibn Arabiun ka thënë:

*“Një grup sufish e kritikojnë pamëshirë Ibn Arabiun dhe injorojnë të gjitha arritjet e tij. Ndërsa një grup tjetër e imiton atë verbërisht dhe duke i konsideruar korrekte të gjitha arritjet e tij, përpiqet të gjejë prova për saktësinë e tyre. Padyshim, të dyja këto grupe kanë shkuar në ekstrem. Si mund të mohohet rrënjësisht një shejh që vlerësohet nga njerëzit e devotshëm? E po ashtu, si mund të ndodhë që pikëpamjet e tij që nuk përputhen me Ehli Sunetin të pranohen thjesht për hir të imitimit të thatë?”* (Letra e 266-të)

Sipas Imamit, gjëja kryesore në çështjet e besimit është Kurani dhe suneti, jo frymëzimi dhe gjendja e veçantë e evliave. Kjo, sepse veliu mund gabojë gjatë interpretimit të gjendjeve të veçanta dhe frymëzimit të tij, por Profeti ynë është i pafajshëm dhe i mbrojtur nga të gjitha llojet e gabimeve gjatë predikimit të fesë. Lidhur me këtë, Imami citon këto fjalë të Haxhe Ubeydullah Ahrarit, një nga të mëdhenjtë e Nakshibendive:

“Nëse na jepen të gjitha llojet e gjendjeve ekstatike dhe shpirtërore, por bota jonë e brendshme nuk është në përputhje me besimin e Ehli Sunetit, atëherë unë nuk do t’i konsideroja ato gjendje si diçka tjetër, përveçse dënim dhe humbje. Nëse privohem plotësisht nga gjendjet (mistike) ndërkohë që ndjek besimin e Ehli Sunetit, kurrë nuk do të më vijë keq për të. «

Si një grup tjetër që dëmton besimin e Ehli Sunetit, Imam Rabbani sheh mendimin filozofik që nuk ka përfutur aspak nga shpallja hyjnore. Nën

ndikimin e kulturës perëndimore, disa intelektualë sot ndjekin ide të kota filozofike dhe shpalljen e vlerësojnë sipas këtij kriteri, duke injoruar ajete dhe madje edhe kapituj që nuk i përshtaten mendjes së tyre. Mirëpo, sipas Ehli Sunetit, mendja nuk është mbi gjithçka. E në fakt, siç thotë edhe Imami, shumë filozofë që i besuan mendjes së tyre nuk iu bindën profetëve dhe mbetën në devijim:

*“Filozofët hoqën nga qafat e tyre lidhjen e imitimit (të profetëve) dhe u përpoqën të sillnin argumente më vete për të provuar të vërtetën. Kështu, ata devijuan edhe veten, edhe ata që i ndoqën. Megjithëse ftesa e Isait (a.s.) arriti tek ai, Platoni, pioneri i filozofëve të periudhës, e refuzoi këtë ftesë, duke thënë: «Ne e kemi arritur udhëzimin, nuk kemi nevojë për askënd që të na udhëzojë». O Zot! Sa i mjerë ishte ky njeri që edhe pse e arriti një profet, që duke ringjallur të vdekurit, duke shëruar sëmundjet e vitiligos dhe lebrës e tejkaloi shumëfish filozofinë e tyre, ai nuk e ndoqi atë dhe i dha një përgjigje kaq të papërshtatshme.”* (Letra e 266-të)

Sipas Imamit, nuk ka pastrim shpirtëror pa institucionin e profetësisë dhe asnjë filozofi apo rrymë mistike nuk mund ta zëvendësojë këtë institucion madhështor.

Siç u tha në fillim të artikullit tonë, ndryshimi më i rëndësishëm i Ehli Sunetit nga grupet të tjera, është se ata nuk bëjnë dallim ndërmjet sahabëve dhe i pranojnë si të drejtë, si Ehli Bejtin ashtu edhe sahabët e tjerë. Kurse Shiat, në këtë aspekt kanë shkuar në ekstrem, duke pranuar vetëm transmetimet nga Ehli Bejti dhe duke përjashtuar sahabët e tjerë. Ndërkohë, Imam Rabbani e mbështet haptazi Aliun (r.a.), në mosmarrëveshjen mes tij dhe sahabëve të tjerë dhe i jep të drejtë atij:

*«Ne besojmë se Aliu (r.a.) kishte të drejtë në çështjen e hilafetit. Ndërsa gabimi ishte në anën kundërshtare (të Muavijes r.a). Sidoqoftë, ky gabim ka qenë i mbështetur në një ixhtihad të gabuar dhe nuk e bën të zotin gjynahqar. Po ashtu, nuk mund të bëhet fjalë as për ta dënuar të zotin e një gabimi të tillë. Madje, për një personin që bën një gabim të tillë ka një shpërblim (sepse ai ishte muxhtehid).»*

Pavarësisht kësaj, Imami nuk e zgjati gjuhën për sahabët e tjerë që ishin kundër Aliut (r.a.), sepse një gjë e tillë do të shkaktonte mohimin e Kuranit dhe

sunnetit që erdhi përmes sahabëve. Ata u kundërshtuan mes tyre, gjë e cila i ngjan kundërshtimit mes anëtarëve të një familjeje. Përfshirja sot me fjalët tona, në një luftë që nuk jemi përfshirë me shpatat tona, nuk ka dobi për askënd. Imami, duke iu përgjigjur pretendimeve të Shiitëve që ofendojnë disa sahabë lidhur me çështjen kalifatit gjatë kohës së Aliut, e shpreh gabimin e denigrimit të shokëve të Profetit (a.s.), me fjalët e mëposhtme:

*“Ata që na përcollën Kuranin dhe Sheriatin janë pikërisht sahabët e nderuar. Nëse denigrohen ata, duhet të denigrohen edhe Kurani e Sheriati, sepse Osmani (r.a.), mbledhi Kuranin. Nëse denigrohet ai, në emër të tij do të denigrohet edhe Kurani. Allahu na ruajt nga gjëra të tilla, të cilat përbëjnë besimin e të devijuarve.”* (Letra e 54-të)

Sidoqoftë, kjo dashuri e imamit është e vlefshme vetëm për sahabët. Kurse Jezidi i cili përndoqi Ehl-Bejtin nuk ishte sahab. Prandaj Imami e mallkon kështu mizorinë e tij kundër Ehli Bejtit: *«Sa i përket Jezidit, i cili është shumë larg lumturisë, ai nuk është nga sahabët. Askush nuk mund të thotë fjalë tjetër në lidhje me largësinë e tij nga fusha e shpëtimit, sepse atë që bëri ai, as jobesimtarët francezë nuk do ta bënin!».* (Letra e 54-të)

Sipas Imamit, kjo është rruga e mesme që duhet mbajtur pa kaluar në ekstrem. Përveç kësaj, sektet që mallkojnë disa sahabë dhe e kanë praktikë këtë bazë të besimit të tyre, janë bidatçin.

Si përfundim, Ehli Sunnet, është emri i rrugës që i jep të drejtë të drejtit, që nuk devijon nga rruga e mesme dhe që Kuranin, Sunnetin dhe Sahabët i mban në krye të gjithçkaje. Të gjitha llojet e ekstremizmave janë jashtë kësaj rruge të bukur. Në ditët e sotme, kur njerëzit janë të hutuar nga filozofia racionaliste dhe ideologjitë e çoroditura, ne kemi nevojë më shumë se kurdoherë për këtë rrugë të mesme, e cila ndiqet nga shumica dërrmuese e myslimanëve. Për më tepër, kjo rrugë ka shtuar dashurinë dhe dhembshurinë për Ehli Sunnetin dhe, dashurinë ndaj Ehli Kiblës, e ka bërë themelore tek besimtarët.

Allahu na ruajt nga të gjitha llojet e teprimeve dhe sjelljeve që nuk përputhen me Ehli Sunnetin dhe na e bëftë të mundur të duam të gjithë besimtarët dhe të jemi njerëz të shërbimit për hir të Tij! Amin!

Filozofët hoqën nga qafat e tyre lidhjen e imitimit (të profetëve) dhe u përpoqën të sillnin argumente më vete për të provuar të vërtetën. Kështu, ata devijuan edhe veten, edhe ata që i ndoqën

# BESNIKËRIA NDAJ ALLAHUT DHE RESPEKTIMI I LIGJEVE

— Idris Arpat —

Fjala “Hak” është një emër që në kuptimin leksikor do të thotë “diçka e vërtetë, e qëndrueshme, të qenët i drejtë, të qenët e nevojshme, të realizosh diçka, të pasosh diçka me bindje të plotë, diçka që ekziston në mënyrë absolute”. Fjala “Hak” - e vërtetë në përgjithësi përdoret si e kundërta e të pavërtetës.

Në kuptimin terminologjik fjala “Hak” do të thotë “dispozitë që përputhet me të vërtetën”. Ajo përdoret edhe për fjalët, besimin, fenë dhe mendimet që e mbartin këtë cilësi. Pra, ajo është e kundërta e të pavërtetës / të gabuarës / të padrejtës.

Ajo përmendet në 247 vende në Kuranin Fisnik.

Fjala “Hak” zë vend të gjerë edhe nëpër hadithe me kuptimet që është përdorur në Kuranin Famëlar-të. I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, në një lutje të gjatë të tij thotë: “O Allah! Ti je Hak, premtimi Yt është hak, takimi me Ty është hak, fjala Jote është

*hak, xheneti është hak, xhehenemi është hak...*” (Shik. Buhari, Tehexhxhud, 1.)

Nëna jonë, Aishja (r.anha), fjalën “hak” në shprehjen “Pejgamberit i erdhi haku/e vërteta”, e përdor në kuptimin “shpallja hyjnore”.

Në pyetjen që Omeri ia bëri Resulullahut (s.a.s.), “A nuk jemi ne në hak dhe armiqtë tanë në të pavërtetën?”, fjala “hak” shpreh fenë islame, kurse e pavërteta shpreh adhurimin e idhujve dhe mohim e fesë në mënyrë të përgjithshme.

Në mendimin Islam koncepti “hak” në përgjithësi përdoret në kuptimin e një “gjëje që ekziston me të vërtetë në botën e jashtme, qenie të cilës i është vërtetur ekzistenca dhe që ekziston në mënyrë të vazhdueshme, informacion në përputhje me të vërtetën, dispozitë dhe fjalë”.

Urdhri në formën: “Jepja hakun / të drejtën poseduesit të hakut / të të drejtës!”, ka sjellë për të gjithë obligueshmërinë për respektimin e të drejtave. Edhe shprehja: “Poseduesi i hakut / i të drejtës ka autoritetin për të folur.”, i njuh poseduesit të së drejtës autoritetin për ta përdorur të drejtën e vet, për ta mbrojtur dhe për ta kërkuar atë.

Për sa i përket jurisprudencës islame mund të thuhet (se kjo fjalë) ka fituar një lloj përmbajtjeje dhe është shndërruar në term në kuptimin “autoriteti dhe privilegji që njohin feja dhe sistemi ligjor”.

Fjala “hukuk” që është shumësi i fjalës “hak” do të thotë tërësia e rregullave që vendos në sistem jetën sociale dhe marrëdhëniet njerëzore nëpërmjet sanksioneve.

Përcaktimi dhe ekuilibrimi i të drejtave dhe përgjegjësi në çdo aspekt i individëve dhe shoqërive, ka përbërë njëren prej temave kryesore edhe të feve qiellore. Për këtë arsye, vihet re se koncepti “hak” është përdorur në aspekte të ndryshme në Kuranin Fisnik dhe në hadithet e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

Fjala “Hak” në mistikën islame është përdorur në kuptimin Zot. Kështu Dhunnun el-Misriu ka thënë: “Hak është Allahu.” Kur mistikët thonë: “Besimtari në pamjen e jashtme duhet të jetë me njerëz, kurse në vetmi duhet të jetë me Hakun.”, apo: “Evliaja merr nga Haku dhe u jep njerëzve.”, me fjalën “Hak” synojnë në Allahun (xh.xh.).

Mistikët myslimanë siç i thonë “Hak” Zotit, edhe



çdo gjëje që është prej Tij dhe vjen prej Tij i thonë hak. Nisur nga ky kontekst, pejgamberët janë hak, Kurani është hak dhe çdo informacion e dispozitë në Kuran është hak. Çdo gjë që bie në kundërshtim me këto është e pavërtetë.

Nganjëherë vihet re ndryshim ndërmjet “hakut” dhe “hakikatit”. “Hak” është një punë e drejtë dhe një fjalë e vërtetë. Ndërsa qëllimi i mirë dhe nijeti që duhet të gjenden pas këtyre janë “hakikat”. Në të njëjtën mënyrë, hyrja në rrugën e shariatit është “hak” dhe vazhdimësia me sinqeritet në këtë rrugë është “hakikat”. Bazuar në këto që thamë deri këtu, një “hak” i privuar nga “hakikati” nuk është gjë tjetër përveçse shtirje.

Përputhshmëria ndaj të vërtetës që përfshin emri “hak” duhet të kërkohet ndërmjet koncepteve natyrorë, Kuran dhe Allah, i Cili është larg krejt veçorive të të gjitha krijesave. Fakti që natyra, e cila përbëhet nga sisteme jashtëzakonisht shumë të ngatërruara, por në harmoni dhe rregull, përputhet me atributet e përsosura të krijesit dhe administruesit të saj dhe reflektimi i kësaj përsosmërie të krijesat, formojnë harmoninë ndërmjet Allahut dhe natyrës.

Krahas kësaj, Allahu Teala e ka prezantuar veten edhe në Kuranin Fisnik ngaqë bota fizike nuk mund ta cilësojë në formë të saktë Atë që është larg materies apo ngaqë atë të cilët studiojnë materien nuk mund ta arrijnë dot këtë rezultat sublim. Kështu, nëpërmjet koncepteve që quhen emra apo attribute e ka përputhur informacionin e njerëzve në lidhje me Zotin në mënyrë të përshtatshme ndaj hakikatit në qenien e Tij.<sup>1</sup>

Ne në këtë material dëshirojmë ta vazhdojmë temën brenda kornizës “besnikëri ndaj Allahut (xh. xh.) dhe respekt ndaj ligjeve” duke i lënë lexuesit bashkë edhe me vlerat e mrekullueshme të pjesëve të mësipërme të marra nga Enciklopedia Islame.

Kur themi “besnikëri ndaj Allahut”, synojmë rregullat e besimit dhe të jetës së punës të cilat kanë ardhur nga Allahu (xh. xh.) dhe për vërtetësinë e të cilave nuk ka dyshim. Pra, synojmë besnikërinë ndaj Kuranit Fisnik dhe Sunetit të Resulullahut (s.a.s.).

**“Dhe thuaj: (Ky mesazh që i referohet) Hakikatit absolut, është prej Zotit tuaj. Tashmë ai që dëshiron le të besojë, ai që dëshiron le të mohojë.”<sup>2</sup>**

Vlera e njeriut buron nga besnikëria ndaj Allahut (xh. xh.) dhe dalja për zot ndaj hakikatit. Të mohuarit e hakikatit është diçka si të shuash diellin. Pasi të mohohet hakikati, nuk dallohen më qartë rruga dhe shenjat. Besnikëria ndaj Allahut (xh. xh.) dhe hakikatit është garancia e rrugës që të shpie te kënaqësia hyjnore. Aty ku nuk gjendet hakikati, gjenden lotët dhe gjaku. Aty shpejtësia

dhe kënaqësia shndërrohen në qëllime dhe paraja bëhet baza e këtyre.

Të fshehësh hakikatit do të thotë t’i mbyllësh sytë ndaj mënyrës së gabuar të të jetuarit të jetës. Çdo individ i umetit të Muhamedit (s.a.s.), është i obliguar të mos i thotë gabim të vërtetës së gjithkujt dhe e vërtetë gabimit të gjithkujt.

Ibrahimi ishte vetë një umet ngaqë shfaqti besnikëri ndaj hakikatit.

Lufta e Aliut (r.a.), ishte lufta për ta kthyer përsëri në drejtimin e duhur jetën e cila kishte devijuar nga shinat e saj.

Lufta për t’i qëndruar besnik Zotit (xh. xh.) është lufta që bëhet kundrejt të padrejtës, në mënyrë që kjo e fundit të mos lejohet ta pushtojë dhe shkatërrtojë jetën. Nëse e vërteta mund të përngjasohet me diellin, atëherë e pavërteta është errësirë. Errësirë do të thotë mungesë e dritës. Pra, nëse e pavërteta e ka shkatërruar jetën, do të thotë se nuk është luftuar për të vërtetën.

Këtu duhet të theksojmë rëndësinë e principit “urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja”. Vënia në funksion e këtij parimi do të thotë që të mos i mbyllim sytë ndaj fshirjes së Islamit nga jeta. Shërbëtorët e Zotit dhe hakikatit janë flijuesit e mirësisë, dashurisë dhe ndriçimit.

Tani le ta pyesim veten: A janë besimi, ndjenjat, fjalët dhe veprat tonë në përputhje me hakikatit, me urdhrat e Zotit dhe me rregullat e tij? Nëse nuk janë, atëherë cila është vlera jonë?

Respektimi i ligjeve do të thotë që të mos i shkelim të drejtat e njerëzve, mjedisit dhe brezave të ardhshme.

Edhe Feja e Qartë e cila është zbritur me qëllimin për të mbrojtur nderin dhe dinjitetin e njeriut, mund të shpjegohet me këtë shprehje: “Besnikëri ndaj Allahut dhe zbatim i ligjeve”.

Çdo njohuri e drejtë është hak dhe e vërtetë. Për këtë arsye gjendet e përfshirë në përmbajtjen e Kuranit Fisnik.

Nëse njeriu nuk dëshiron të bëjë një jetë të papërgjegjshme, por një jetë në përputhje me natyrshmërinë e tij, atëherë duhet t’i marrë parasysh rregullat hyjnore dhe duhet të bëjë kujdes ndaj shenjave përgjatë rrugës. Kjo e bën të nevojshme njohjen e rregullave dhe të shenjave, “në mënyrë që të shkatërrohet me vetëdije ai që shkatërrohet dhe të jetojë me vetëdije ai që dëshiron të jetojë”.

Ne si myslimanë jetesën duke qenë e lidhur ndaj hakut dhe hakikatit e përdorim në të njëjtin kuptim me adhurimin ndaj Allahut (xh. xh.). Nëse Zoti i Lartësuar e ka autoritetin për t’i vendosur rregullat, atëherë zbatimi në mënyrë të vetëdijshme dhe me dëshirë i atyre rregullave sigurisht që është vetë adhurimi.

Përderisa ne të jetojmë në përputhje me rregullat, do të thotë se do të përballemi me ata që e kanë

1. Këto informacione janë marrë nga neni Hak që është shtjelluar në faqet 137-152 të vëllimit të 15-të të Enciklopedisë Islame të Fondacionit të Entit për Çështjet Fetare të Republikës së Turqisë.

2. Kehf, 29.



bërë stil jete papërgjegjshmërinë dhe që adhurojnë dëshirat e pasionet e tyre. Kjo është një situatë e pashmangshme. Ajeti i 105-të i sures Maide na qetëson ndërgjegjen në lidhje me këtë pikë:

**“O ju që keni besuar! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj! Ai që është i humbur nuk mund t’ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë. Tek Allahu do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmërojë për atë që keni punuar.”**

Shprehjen “nuk mund t’ju dëmtojë” që përdoret në ajet, duhet ta kuptojmë në formën: “Nuk mund të dëmtojë gradën tuaj te Allahu dhe shpërblimin tuaj në botën e përtejme.” Sepse në aspektin e kësaj bote është një çështje që dihet se mund të na dëmtojnë.

Atëherë, myslimani duhet t’i përkushtohet detyrës së tij, në mënyrë që ta arrijë kënaqësinë e Allahut Teala dhe nuk duhet t’u japë rëndësi thashethemeve. Ky në të njëjtën kohë është një lehtësim psikologjik dhe çlirim nga ankthi/tensioni.

Ne duhet ta shprehim se të injorosh të vërtetën për shkaqe si dashuria, urrejtja apo interesi, kurrë nuk është një qëndrim prej myslimani. Një mysliman duhet t’i qëndrojë besnik hakut dhe hakikatit kundrejt çfarëdo çmimi. Sipas myslimanit “hatri i të drejtës është mbi hatrin e mikut”. Ai kurrë nuk duhet ta mbështetë fanatizmin sektar duke u bazuar te e vërteta: “Nëse padrejtësia bëhet prej nesh, unë nuk jam prej nesh.” Ndërkohë që thotë se nuk do t’i mërzisë të dashurit e tij, nuk duhet të bie në gjendjen e shejtanit pa gjuhë. Ai më mirë duhet të zgjedhë të qëndrojë i vetëm sesa të qëndrojë në vend të gabuar. Kështu që duhet të thotë: “Nëse bëhet fjalë për besnikërinë ndaj Zotit, asgjë tjetër nuk ka rëndësi për mua.” Ata që përkrahin hakikatin pranojnë menjëherë që të rrinë vetëm.

Muslimani duhet t’i respektojë të drejtat e njerëzve të tjerë, të gjallesave të tjera dhe të mjedisit. Ai nuk do t’i nëpërkëmbë qoftë edhe të drejtat e një milingone me vetëdije. Etërit tanë kanë thënë: “Rënkimi i një njeriu e shkatërron mbretin.” Ai (myslimani) duhet ta dijë se padrejtësia herët apo vonë do ta godasë të drejtën.

Parimi i drejtësisë asnjëherë nuk duhet të neglizhohet. “Drejtësia është baza e udhëheqjes dhe besimi i shtetit.” Baza në marrëdhëniet njerëzore është drejtësia. Ajo që e mban shtetin në këmbë është drejtësia. Ndërsa ajo që e shkatërron është padrejtësia.

Njëra prej cilësive themelore të umetit të Muhamedit (s.a.s.), është qëndrimi përkrah hakut dhe mbështetja e hakikatit.

Zoti i Lartësuar e paralajmëron umetin tonë siç vijon:

**“O ju që keni besuar! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve**

**për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju.”** (Maide, 8)

“Në këtë ajet nuk pranohet qëndrimi larg të vërtetës, drejtësisë dhe hakikatit duke u kapluar nga ndjenjat e urrejtjes. Aty urdhërohet që të gjitha punët të kryhen duke ua dhënë hakun për hir të Allahut (xh.xh.), dëshmia të bëhet në mënyrë të vërtetë, e vërteta dhe e drejta të thuhën siç janë, ngjarjet të tregohen siç kanë ndodhur, historia të shkruhet në mënyrë të drejtë dhe të trajtohen me drejtësi qoftë edhe popujt e shoqëritë armike ndaj të cilave ndjehet urrejtja më e madhe.”<sup>3</sup>

Kjo është ajo që duhet të ndodhë, por në fakt çfarë po ndodh?

Qafirët le t’i lëmë menjëherë jashtë teme duke thënë: “Të presësh drejtësi prej qafirrit është naivitet.”

Edhe bota islame përgjatë historisë gjithmonë ka mbetur në klasë për sa i përket parimit të drejtësisë përveçse një-dy rasteve të veçanta. Ku është drejtësia jonë nëse do ta hetonim atë duke filluar që nga udhëheqja e Osmanit, martirizimi i tij, lufta e Xhemelit, lufta e Siffinit, Nehrevani, Qerbelaja e deri te sarajet Emevite, Abbasite, Selçuke dhe Osmane? Nëse marrëdhënia e sulltanit me popullin do të hetohet nga njerëz që janë besnikë ndaj të vërtetës dhe hakikatit, çfarë panorame do të na dalë përballë? Nëse do të hetoheshin qëndrimet e tyre ndaj fesë dhe dijes një për një dhe do të analizoheshin, ku mund të bazohen ato në Kuran dhe Sunet?

Ku janë besimtarët fisnikë të Librit Fisnik?

Të satët janë në listën e dijes dhe shkencës ithtarët e një feje që fillon me urdhrin: “Lexo!”?

Ne po kërkojmë një ndjeshmëri prej myslimani, një vetëdije që nuk neglizhon kundrejt përgjegjësisë dhe sinqeritet. Besnikërinë ndaj Allahut (xh.xh.) dhe respektimin e ligjeve (të drejtave) e konsiderojmë si një princip absolut.

Përfundimisht, siç ka thënë edhe profesor Ismail Lutfi Çakani: “Të bësh një jetë si mbështetës i të drejtës dhe palë e të drejtës pa ua vënë veshin reagimeve të drejta apo të gabuara, me vend apo pa vend, reale apo joreale, pa u dhënë rëndësi orientimeve të fuqive të jashtme që duken sikur janë në të drejtë dhe pa u mbytur në dashurinë apo urrejtjen që kemi përbrenda është xhahadi më i madh dhe më i shenjtë i ditëve të sotme.”

“Krijuesi ka emra të pafund. Më kryesori është el-Hakk,

Sa gjë e madhe është për robin që ta mbajë dhe ta lartësojë të vërtetën!”

3. Prof. Dr. Ismail Lutfi Çakan, Revista Alltënolluk, Janar – 2017.



# MODA E FUNDIT

— Fërat Erdogan —

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes se çfarë dobie ka mjeti i mësipërm (varëse prej qelibari), më së voni duhet të keni lindur në vitet 80, sepse këtij mjeti i ka kaluar moda. Dikur burrat e shtetit dhe njerëzit e arsimuar si pedagogët e universiteteve nuk e hiqnin prej krahëve të tyre këtë mjet që e shkatërronte qoftë edhe stresin. Pastaj papritur u bindëm se ai nuk e largonte më stresin. Kështu e kuptuam se ky mjet që prodhohej vetëm për tri qindarka, u bënte dobi tregtarëve që e shisnin me një çmim të shtrenjtë.

Pothuajse të gjitha produktet që prodhohen nga dora e njeriut kanë një fund absolut, u kalon moda dhe harrohen. Shëndeti është çështja për të cilën koncepti “modë”, të cilin e pranojmë krejt normal për rrobat, kolltukët, celularët apo makinat, nuk ka aspak kuptim. Nuk e di nëse ka ndonjë që e mban mend trëndafilin e egër të cilin nuk e lëshonte nga dora kryeministri i një periudhe të afërt, luleshtrydhen e artë që vinte pas tij dhe aloeverën.

Këto produkte gjithmonë mbartin vlera si ushqime, por është e kotë të besosh se janë shërim për çdo sëmundje dhe se e zgjasin jetën kur të hahen me grushte.

Të folurit për modën rreth një çështjeje mjekësore që duhet të mbështetet me informacione plotësisht objektive që përftohen nëpërmjet metodave shkencore, në fakt duhet të refuzohet ngaqë na i gris veshët para se të shkojë në mendje, por ja që nuk ndodh kështu...

Nëse pyesni ndonjë prej të afërmeve tuaj që ka fëmijë të vogël, rreth dobie që ka për shëndetin gjerdani prej qelibari, do t'ju japë informacion aq shumë sa që me të mund të shkruani një artikull. Ky produkt i rëndësishëm që mundëson daljen e dhëmbëve për ata fëmijë që janë rreth një vjeç, u bën shumë mirë edhe mungesës së koncentrimit dhe hiperaktivitetit për fëmijët që janë rreth 4-5 vjeç. Apo më e pakta, kështu pohojnë tregtarët që i shesin...

Nuk e di se sa u ka hije ky veprim i shokëve tanë tregtarë këtyre tokave në të cilën ka lindur “tradita e përkushtimit ndaj fesë”, por absolutisht nuk përputhet me moralin e përgjithshëm dhe etikën e mjekësisë fakti që njerëzit të cilët shteti u ka dhënë titullin mjek duke u bazuar në ligjin “rreth mjekësisë dhe nëndegëve të saj”, domethënë kolegët tanë, t'i shndërrojnë në interes personal shkronjat e titujve që kanë para emrave të tyre dhe respektin që populli ynë gëzon ndaj bluzës së bardhë që ata veshin.

Ditën kur fillova ta shkruaj këtë material, një gazetë që është ndër tri të parat për sa i përket tirazhit, e kishte publikuar në vendin më të dukshëm të saj: “Lista e perimeve që të mbrojnë nga kanceri.” Për shembull, kanceret që i shëron spinaqi i cili është prej perimeve më të lira dhe të vjetra të tryeza-ve tona: Leucemia, prostata, kanceri i kolonës, mitrës... Në këtë situatë, fakultetet e mjekësisë, klinikat e onkologjisë, kimioterapitë që çdo kurë u kushton shtrenjtë dhe që kanë shumë efekte anësore janë të kota. Andaj ha spinaq që të të kalojë kanceri...

Faktikisht në një periudhë kur industria e mbështet çmendurisht shkuarjen në spital për çdo gjë dhe mjekimet e apo jo të nevojshme pasi të bëhen ekzaminimet, zaten është i pamangshëm shndërrimi i ifratit në tefrit.

Kur të gjithë e kuptojnë sipas kapacitetit të tyre shprehjen që i atribuohet Hipokratit: “Ush-



qimet le të jenë ilaçi juaj dhe ilaçi juaj le të jenë ushqimet.”, në pah kanë dalë dy kampe, njëri prej të cilëve përdor kapsulën e vajit të peshkut në vend që të hajë peshkun në një vend të rrethuar nga të tria anët me ujë dhe tjetri që përpiqet për ta kaluar me portokall infeksionin e traktit të sipërm respirator.

Disa studime shkencore (edhe pse jo të një cilësie të lartë), kanë treguar se dozat e larta të vitaminës C të bëjnë ta kalosh ftohjen apo thënë më saktë, t'i kalosh problemet që shkakton ftohja. E vërtetë... Por ata kanë harruar të tregojnë se një sasi e tillë e vitaminës C gjendet në pothuajse disa arka portokalli.

Sigurisht që edhe pala kundërshtare nuk rri duarkryq. Andaj shprehen: “Ju nuk mund ta hani një sasi kaq të madhe të portokallit. Andaj ejani, sepse ne kemi bërë shurupin e vitaminës C për ju. Ne e kemi nxjerrë vitaminën C të një arke me portokall dhe e kemi vendosur në kapsulë. Prej majasë së bukës jo të huaj, por prej asaj që e njihni, kemi bërë përforcues imuniteti. Nëse nuk e merr për vete, merre për fëmijën.” Ata duke u shprehur kështu na vendosin përpara shishe të mbushura plot me produkte natyrale të dala nga fabrika!!!

Ushqimet që hamë studiohen në tri grupe në kontekstin e përgjithshëm.

#### Proteina / Yndyra / Karbohidrate

Nëse jeni të interesuar për të marrë apo për të dhënë kilogramë (për t'u shëndosur apo për t'u dobësuar), këto shprehin për ju vlerë aq sa kaloritë që ju japin.

Kur dietologu me të cilin konsultoheni ju jep listën, bën katër gjëra. Ndërkohë që çdo gram yndyrë në lëndën ushqimore jep nëntë kalori, proteinat dhe karbohidratet japin katër kalori. Nevoja e njeriut për kalori llogaritet sipas disa faktorëve të ndryshëm si gjinia, mosha, mënyra e jetesës, etj. Pastaj ju thuhet se, kaloritë që keni nevojë do t'i merrni duke ngrënë këto në mëngjes e mbrëmje. Nëse kërkesa juaj është për t'u dobësuar, atëherë prej jush do të kërkohet që ushqimet të cilat mbartin shumë kalori t'i ndërtoni me ushqime që kanë më pak kalori.

Kur të bëhet fjalë për detajet në përmbajtjen e ushqimeve, atëherë flitet për vitaminat dhe mineralet. Ndikimet e padukshme/misterioze/të ekzagjeruara të ushqimeve janë të lidhura me këto lëndë. Ne nuk kemi ndonjë kundërshtim për sugjerimet e sakta që janë pranuar në përgjithësi siç është fakti që nenexhiku – limoni i bëjnë mirë përzierjes dhe vjelljes apo siç e largojnë kollën përzierjet me mjaltë. Por kur shohim profesorë të universiteteve që flasin nga mëngjesi deri në darkë për ushqimet që e mposhtin kancerin dhe e zgjasin jetën kur të hahet një grusht prej tyre, më kujtohet ajo plaka e moshuar që i tregonte hallin e saj ujit dhe e hidhte pranë rrapit afër varrit të Ebu Ejjub el-Ensariut duke besuar se kështu do të shpëtonte nga stresi.

Kontributi i këtyre lëndëve është shumë i rëndësishëm për rritjen e zhvillimin ideal të fëmijëve dhe për një jetë të shëndetshme për të rriturit. Por siç ndodh me çdo gjë, edhe këto duhet të merren në masa të caktuara. Nëse flasim për një fëmijë afrikan i cili bën festë kur gjen një grusht miell, zinku është një substancë e mrekullueshme që forcon jashtëzakonisht sistemin imunitar, rigjeneron flokët e humbur dhe kuron diarrenë brenda disa ditëve. Nëse çdo ditë hani vetëm 100 gram fara kungulli, atëherë do të thotë se keni marrë rreth gjysmën e sasisë së zinkut që ju duhet përgjatë ditës. Zinku është i nevojshëm në qindra reaksione kimike. Një fëmijë që konsumon në sasi të pranueshme prej çdo lloj ushqimi që gjenden në tryezat e të varfërve dhe të pasurve në vendin tonë dhe që sigurohen lehtësisht, nuk ka asnjë kuptim që t'i jepni ilaç i cili përmban zink.

Asnjëra prej vitaminave të nevojshme për trupin nuk janë të kufizuara në një produkt ushqimor. Numri i lëndëve ushqimore të cilat janë aq të pasura saqë të mjaftojnë për ta plotësuar disa herë nevojën ditore të vitaminës C, jini të sigurt se është i madh.

Fjalitë në formën: “Nëse hani kaq prej këtij ushqimi, do t'ju forcohet memoria dhe do t'ju shtohet zgjuarsia.”, nuk mund t'i gjeni në asnjë libër të mjekësisë. Përgjigja që do të merrni nga poseduesit e këtyre të dhënave kur t'i pyesni për burimin është kjo:

Sipas meje... Apo, për mendimin tim...

Jemi të sigurt se për ju natyrshëm ndalon edhe uji kur bashkëbiseduesi juaj t'ju thotë se ka thënë Pejgamberi ynë i Nderuar (s.a.s.). Por ju keni të drejtë të parashtroni një pyetje:

Cili është burimi i këtij hadithi fisnik?

Nëse merrni një përgjigje bindëse dhe logjike, sigurisht që e pranoni...

Ne duhet të shfaqim të njëjtën ndjeshmëri për ta mbrojtur edhe neftin dhe brezat nga pesë substanca për të cilat jemi urdhëruar t'i mbrojmë. Kur të përballeni me një pretendim mjekësor, bëni një pyetje dhe shihni se në cilin libër shkollor gjendet ai informacion. Në artikullin e cilës revistë gjendet ky informacion? Nëse thoni se nuk keni njohuri rreth kësaj çështjeje, atëherë sipas këshillës sonë modeste, bëni kujdes se kë dëgjoni. Kështu që të mos ju mashtroni titulli para emrit, dalja e shpesh-të në televizor dhe elokuenca në të folur. Pasojat e humbjes të cilën e shkaktojnë shkujdesja dhe dembelizmi mund të mos jenë të kufizuara vetëm me këtë botë...



# FEJA ËSHTË SINQERITET!

— Hadi Ënall —

Nëse më pyesin se cila është garancia e dashurisë, besimit dhe e ndarjes së gjërave me të tjerët, do të përgjigjesha: “Sinqeriteti...” Sinqeriteti, i cili është përputhshmëri e mendimeve dhe ndjenjave me veprat tona, në të njëjtën kohë është edhe masa e vendosmërisë, besueshmërisë dhe e vazhdueshmërisë së ndjenjave dhe mendimeve tona. Sinqeriteti është pasqyra në shpirtin e njeriut që reflekton jashtë ndershmërinë, moralin dhe edukatën e tij. Sinqeriteti është çelësi i të jetuarit me plot dashuri, i të kryerit të veprave gjithë kënaqësi dhe pa interes, i shijimit të jetës së kësaj bote dhe i të jetuarit në harmoni. E kundërta e kësaj cilësie, e cila hap dyert e miqësisë, dashurisë dhe besimit ndërmjet njerëzve dhe e cila i bën të gjelbërojnë konceptet dëlirësi, pastërti dhe besueshmëri, është hipokrizia, mashtrimi, gënjeshtria, shtirja dhe dredhia. Atëherë lind pyetja:

Sa e kemi përvetësuar ne këtë cilësi, për të cilën kemi më shumë nevojë në sipërfaqen e tokës, si popull, si shoqëri dhe si individë? A jemi të sinqertë? Domethënë, a është e njëjtë bota jonë e brendshme

me aparcën tonë? Së pari, a jemi të sinqertë me Allahun, i Cili na ka krijuar? A jemi të sinqertë kundrejt peygamberëve, të cilët ishin udhërrëfyesit tanë dhe veçanërisht kundrejt të Dërguarit të Allahut, Muhamedit, alejhi’s-selam? A është i sinqertë udhëheqësi kundrejt atyre që udhëheq, ata që udhëhiqen kundrejt atij që udhëheq, pronari kundrejt punëtorit, punëtori kundrejt pronarit, studenti ndaj pedagogut, nëpunësit kundrejt shefit, burri kundrejt shtëpisë, gruaja kundrejt bashkëshortit dhe shoku kundrejt shokut? A përputhet zemra jonë me fjalët tona? Cila është shkalla e sinqeritetit tonë kur themi “mirë”, kur themi “në rregull” dhe kur bëjmë ndonjë veprim? A përputhen fjalët dhe sjelljet me zemrat tona? A i aprovon zemra, ndërgjegjja dhe largpamësia jonë ato që bëjmë apo ato që ndodhin përpara nesh? Apo ato bëjnë sikur nuk dinë gjë thjesht për interesat provizore të kësaj bote treditore? Mos vallë jemi prej atyre që gjithmonë mashtrohen apo mashtrojnë për çdo gjë, duke filluar nga vetja jonë e deri te Krijuesi i Lartësuar?

Përgjigjet e të gjitha këtyre pyetjeve janë të fshehu-

ra në pasqyrat e pafundme të kësaj toke në të cilën jetojmë. Ne ndoshta nuk i shohim, por sigurisht se ka prej atyre që i shohin dhe i vlerësojnë. Pa shikojeni, për hir të Allahut, këtë botë mbi të cilën jetojmë dhe njeriun të cilit i është dhënë titulli eshrefu'l-mahlukat / krijesa më e nderuar! Pa shikojeni civilizimin dhe humanizmin që ka formuar ai!.. Nga njëra anë gjaku, dhimbjet dhe lotët që formohen si rezultat i shtypjes, tjetërsimit, urrejtjes, zemërimit, vrasjes dhe shfarosjes... Në anën tjetër mosreagimi dhe plogështia e miliona njerëzve që e pinë alkoolin apo kafenë e tyre plot kënaqësi përpara televizorit duke i ndjekur këto... Në njërin anë ka mungesë të ndërgjegjes, mendjemadhësi dhe mburrje, ndërsa në anën tjetër viktima të pafajshme... Në njërin anë një sistem i formuar mbi padrejtësinë, mashtrimin, vjedhjen dhe plaçkitjen, ndërsa në anën tjetër varfëri, uri dhe skamje totale... Atëherë, ku është ndërgjegjja, ndjeshmëria dhe zemra jonë? Nëse thoni se kjo botë është bota e të fortëve dhe se çdo gjë është e lejuar për t'i arritur interesat, nëse thoni se kjo botë është vuajtje e shtypje për disa dhe kënaqësi e lumturi për disa të tjerë, atëherë për çfarë ju duhet "Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut" që e keni përgatitur plot përkushtim me mendjen që ua ka dhënë Allahu Teala? Përse njeriu? Përse njerëzia? Ja, në të vërtetë, kjo është ajo që duhet të pyetet dhe të shpjegohet...

Nëse pohoni se jeni njerëz, atëherë duhet të jemi të sinqertë. Sinqeritetin, i cili është garancia e dashurisë, besimit dhe e ndarjes së gjërave me të tjerët, duhet ta tregojmë në çdo lloj kushtesh dhe rrethanash. Fajësimi i të tjerëve duke i anashkaluar gabimet tona është mënyra më e lirë dhe e lehtë për t'i arritur interesat. Por ne duhet të arrijmë te

të vërtetat pa devijuar në këtë mënyrë dhe duke e marrë në llogari veten. Dëlirësia është baza e sinqeritetit. Njeriu së pari dhe në veçanti duhet të jetë i sinqertë kundrejt vetes së tij. Çfarë ka thënë Mevlana: "Ose ji siç shfaqesh, ose shfaqu siç je." Një njeri që nuk e ka njëllë të jashtmen me të brendshmen e tij është njeri i mangët. Sipas Islamit ky njeri quhet hipokrit.

Sinqeriteti duhet të jetë baza si ndërmjet individëve ashtu edhe ndërmjet shteteve. Le të themi se një sinqeritet i tillë nuk u formua dot ndërmjet popujve të kësaj bote. Atëherë, ne si vende myslimane duhet të formojmë një sinqeritet të bazuar në besueshmëri ndërmjet nesh. Ne si shtete myslimane përpiqemi të gjejmë perëndimin në themelin e çdo fatkeqësie që po na ndodh këto dyqind vitet e fundit. Perëndimi është interesaxhi, perëndimi është imperialist, perëndimi është kolonizues, perëndimi nuk është i sinqertë... Le t'i marrim për të vërteta të gjitha këto, por lind pyetja: "Sa e zbatojmë Islamit, baza e të cilit është sinqeriteti dhe dëlirësia, ne si vende myslimane?" Mos vallë ne jemi të sinqertë kundrejt njëri-tjetrit, por perëndimi na pengon në këtë çështje? Le të supozojmë se na ka ndaluar, gjë e cila është mjaft normale, atëherë, përse nuk kthehemi nga vetja jonë dhe t'i shohim mangësitë tona në vend që të fajësojmë perëndimin? Çfarë na ndalon ne për ta parë dhe për ta zbuluar mangësinë e kusurin tonë dhe për ta rregulluar atë? Çfarë përgjigjeje mund t'i japim tjetër kësaj pyetjeje përveç të vërtetës se ne nuk jemi të sinqertë kundrejt njerëzve, Islamit, Kuranit dhe Allahut? Çfarë ka thënë Pejgamberi i dërguar si mëshirë për botët, Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të: "*Feja është e gjitha sinqeritet.*" (Muslim, Iman, 95.)





# "MËSHIRA IME PËRFSHIN ÇDO GJË"

— Nuredin Jëlldëz —

Në këtë shkrim, dëshirojmë të analizojmë ndodhinë e një lutjeje/dëshire interesante që është përjetuar në prani të Profetit tonë (a.s.).

Ndodhia

Duke bashkuar transmetimet e haditheve lidhur me këtë ngjarje, mund t'i bëjmë një përmbledhje të tillë:

Sipas konsensusit të shumicës, një beduin i quajtur Dhu'l-huvejsira vjen një ditë në Medinë, hyn në Xhaminë e Profetit (a.s.), dhe me një ton zëri që të mund ta dëgjonte Profeti (a.s.), lutet: O Allah! Më mëshiro mua dhe Muhamedin, dhe mos mëshiro askënd tjetër bashkë me ne!

Profeti (a.s.), buzëqeshi dhe më pas i tërheq vërejtjen beduinit, duke i thënë:

*"E ngushtove atë që është e gjerë!"*

Më pas, i bën me dije se mëshira e Allahut përfshin çdo gjë.

Pa kaluar shumë, personi ngrihet, shkon në një qoshe të xhamisë dhe fillon të urinojë mbi rërë. Sahabët tentuan të ndërhyjnë, por i Dërguari i Allahut (a.s.), i urdhëron ta lënë të mbarojë. Më pas, urdhëron të sjellin një kovë të madhe me ujë dhe ta derdhin mbi vendin ku urinoi beduini. Pas kësaj, Profeti (a.s.), i drejtohet beduinit dhe i tërheq vërejtjen duke i thënë:

*"Kjo ndërtesë është ndërtuar për të përmendur Allahun dhe për të falur namaz. Prandaj këtu nuk mund të urinohet!"<sup>1</sup>*

Në fakt, kjo ndodhi vë në pah në mënyrë të spikatur dallimin mes beduizmit dhe qytetërimit. Mirëpo, për shkak të aspektit interesant "të urinimit në xhami", që bën edhe më tepër përshtypje në këtë ndodhi, në shpjegimet e këtij hadithi trajtohet

më tepër çështja e pastërtisë. Lidhur me këtë, janë shpjeguar gjerë e gjatë dallimet e mendimeve mes medhhebeve dhe është vlerësuar nëse është e drejtë apo jo që sahabët tentuan të ndërhyenin para Profetit (a.s.), në prezencë të tij.

Por me sa duket, pjesa e parë të kësaj ndodhie nuk është trajtuar aq sa duhet. E në fakt, të dyja pikat e kësaj ndodhie, "qëndrimi i besimtarit" dhe "të drejtat e umetit", janë po aq të vlefshme për t'u trajtuar në mënyrë thelbësore. Kjo, sepse të anashkalosh faktin se xhamia është qendër adhurimi për umetin dhe të ngushtosh lutjen në nivel personal apo grupor, do të thotë që të mos veprosh me dijen dhe vetëdijen e duhur dhe të mjaftueshme në lidhje me vendadhurimin, mëshirën dhe umetin. Ky është një veprim që mund ta bëjë vetëm një beduin që e ka kaluar gjithë jetën në shkretëtirë, larg qytetërimit. Pra, është e qartë se besimtarët e qytetëruar, që e njohin mëshirën Hyjnore, kuptimin e xhamisë dhe umetit, nuk do të vepronin në mënyrë të tillë.

Zoti ynë i Madhëruar, ka urdhëruar: *"...Mëshira Ime përfshin çdo gjë!.."*<sup>2</sup> Për rrjedhojë, edhe Profeti ynë (a.s.), duke i tërhequr vërejtjen beduinit, i thotë, *"E ngushtove atë që është e gjerë!"*. Me këtë, Profeti ynë (a.s.), në radhë të parë beduinit, e nëpërmjet tij të gjithë neve, umetit Islam, na mëson të lutemi dhe të kërkojmë prej Allahut, duke pasur parasysh gjerësinë e mëshirës së Tij hyjnore. Kjo do të thotë se, kufirin e lutjes e përcakton fakti se prej kujt dhe çfarë kërkon. Ndërsa mënyra se si e kërkon, tregon kujdesin dhe edukimin në lidhje me çështjen. Krahas këtyre, dëshirat dhe kërkesat individuale dhe grupore, të cila anashkalojnë myslimanët e tjerë apo gjithë pjesën tjetër të umetit, në një farë kuptimi, nënkuptojnë ngushtimin e mëshirës së Allahut, që përfshin çdo gjë, kufizimin e përfshirjes së saj, koprraci dhe moskuptim të gjerësisë së vërtetë të asaj mëshire.

2. A'raf, 156.

1. Për transmetime të ndryshme të këtij hadithi, shih: Buhari, Vudu 56, 57; Edeb 27; Muslim, Taharet 98, 100; Ebu Daud, Taharet 136, Salat 149; Tirmidhi, Taharet 112; Nesai, Taharet 44, Mijah 2; Ibn Maxhe, Taharet 78; Darimi, Vudu 62; Muvatta, Taharet 111; Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 239, 272.

## MYSLIMANI ËSHTË GJITHËPËRFSHIRËS

“Dëshirimi për vëllain e vet të fesë, atë që dëshiron për veten”<sup>3</sup>, është tregues i pjekurisë së besimit. Në të njëjtën kohë, ky është edhe kushti i domosdoshëm i pjekurisë së besimit. Prandaj, përkujtimi i gjithë umetit Islam në lutje, është një virtyt më vete dhe një detyrë e besimit. Kur individët e një shoqërie dëshirojnë për njëri-tjetrin atë që dëshirojnë për veten, do të thotë se ata ndajnë një mirësi dhe lutje të madhe. Në këtë mënyrë, umeti, në aspektin e dëshirave dhe lutjeve, bëhen një strukturë e unifikuar. E në fakt, kjo është ajo që duhet...

Ata që luten vetëm për veten, apo grupin që duan; e thënë ndryshe, që preferojnë vetëm të vetët, në të vërtetë ndajnë të njëjtin nivel dhe gradë me beduinin e ngjarjes së mësipërme dhe e ngushtojnë mëshirën e gjerë hyjnore, gjë të cilën nuk kanë të drejtë ta bëjnë.

Myslimanët, -edhe pse dikush mund të mos e pëlqejë- në të vërtetë janë gjithëpërfshirës. Në këtë pikë, nuk duhet harruar se, përdorimi i fjalës “të gjithë” në formë shprehie apo zakoni, ndryshon nga vetëdija e umetit në kuptimin e vërtetë të fjalës. Pra, e rëndësishme është që të lutesh me gjithë zemër për mëshirë ndaj të gjithë umetit.

## NJË KUJTIM

Rahmet pastë, një miku im mësues, në mëngjesin e një Nate të Mirë, më pyeti: “Mbrëmë u lute për mua, apo jo?” Pra, dëshironte që unë të isha lutur për të me emër, gjë që nuk ishte ndonjë problem. Mirëpo, për të bërë pak shaka, unë i thash: “Unë u luta për të gjithë myslimanët. Nëse ti je mysliman, edhe ti ke përfutur.”

Miku im, nuk e harroi përgjigjen time për një kohë shumë të gjatë dhe në bisedat që bënim herë pas here, e tregonte shpesh dialogun mes nesh, duke thënë, “a e dini si më ka thënë ky burrë?” Allahu e mëshiroftë mikun tim, të gjithë të vdekurit tanë dhe të gjithë myslimanët.

## ANALIZË

Nëse i kthehemi edhe njëherë ndodhisë sonë, shohim se Profeti ynë (a.s.), nuk e perceptoi fjalën e bedunit si të qëllimshme, por si mungesë njohurie. Prandaj ai i kujtoi se gjerësia e mëshirës hyjnore ishte e pafundme dhe e pashtershme. Në vazhdim të ngjarjes, Profeti ynë (a.s.), bëri të ditur edhe funksionin e vërtetë të xhamive. Kështu, për shkak se të dyja veprimet e bedunit buronin nga mangësia e edukimit dhe normave të edukatës, Profeti ynë

3. shih. Buhari, Iman 7 ;Muslim, Iman 71,72; Tirmidhi, Kijamet 59; Nesai, Iman 19, 33; Ibn Maxhe, Mukaddime 9; Xhenaiz 1; Darimi, Isti'zan 5; Rikak 29; Ahmed b. Hanbel, Musned, I, 89, III, 176, 206, 251, 272, 278, 289.

(a.s.), iu qas atij me tolerancë dhe pjekuri të madhe, gjë e cila ishte e vlefshme edhe për edukimin e sahabëve, por edhe për edukimin e të gjithë umetit në aspektin e informimit dhe lehtësimit të fesë. Në një transmetim në Sahihun e Buhariut<sup>4</sup>, Profeti ynë (a.s.), i urdhëron sahabët duke u thënë: “Ju keni për detyrë të jeni vetëm lehtësues, e jo vështirësues!”

Siç duket, beduini e ka barazuar Profetin (a.s.), me veten e vet dhe nuk i ka njohur të drejtën e mëshirës hyjnore askujt tjetër prej besimtarëve, përveç Profetit (a.s.) dhe vetes të tij. Kushedi, mbase kështu ka shpresuar se do të fitonte admirimin e Profetit tonë (a.s.).

Sipas bedunit, diskriminimi pozitiv i shprehur në fjalinë, “Më mëshiro mua dhe Muhamedin dhe mos mëshiro askënd tjetër bashkë me ne!”, në vend që të merrte pëlqim, për shkak se përmbante një gabim të madh, u përball me tërheqjen e vërejtjes nga ana e Profetit (a.s.), i cili i tha; “e ngushtove mëshirën e gjerë të Allahut!”.

Në këtë vërejtje të Profetit tonë (a.s.), ka një përgëzim dhe shpresë të madhe për të gjithë umetin në përgjithësi dhe për gjynahqarët e umetit në veçanti. Për rrjedhojë, duhet që ne besimtarë të strehohemi tek mëshira hyjnore që përfshin çdo gjë, pa e humbur kurrë shpresën dhe pa u penguar nga madhësia e gabimeve dhe gjynaheve tona. Ky është parimi themelor!..

Mirëpo, këtu duhet të tregojmë kujdes edhe në një pikë të veçantë:

Në suren Lukman, Allahu i Madhëruar urdhëron:

**“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj dhe frikësojuni Ditës, kur prindi nuk do të mund ta ndihmojë aspak fëmijën e vet, e as fëmija nuk do të mund ta ndihmojë sado pak prindin e vet! Premtimi i Allahut është vërtet i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote t’ju mashtrojë dhe as djallin mos e lini t’ju mashtrojë për Allahun.”** (Lukman, 33.)

Nga ky ajet, kuptohet qartë se, nuk duhet ta lejojmë shejtanin e mallkuar “të na mashtrojë për Allahun”, duke u zhytur në gjynahe dhe duke krijuar mendime të paqena në lidhje me Allahun, vetëm sepse i besojmë mëshirës së Tij. Nuk duhet harruar se, të bësh gjynahe vazhdimisht dhe të mos kërkosh asnjëherë falje, duke menduar se mëshira e Allahut është e madhe dhe Ai fal shumë, do të thotë “të mashtrohesh për Allahun”.

Shkurtimisht, ne duhet të bëjmë kujdes edhe të mos e ngushtojmë mëshirën e Allahut që përfshin çdo gjë, edhe të mos abuzojmë me faljen e Allahut, duke bërë gjynahe në mënyrë të vazhdueshme. Allahu na ndihmoftë!

4. Buhari, Vudu’ 58



“I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhamedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t’i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.”

(Isra, 1)

Sexhdja, është një shprehje e respektit dhe nderimit që prej krijimit të njeriut të parë.<sup>1</sup> Ndërsa vendet ku kryhen sexhdet dhe madhërimet, quhen mesxhide (shumësi mesaxhid). Një fjalë tjetër që përdoret për këto vende, është “faltore”, që do të thotë vend ku kryhen adhurime. Në Kuranin Fisnik janë përmendur vendadhurimet e tri feve qiellore dhe është theksuar qartë se ato duhen respektuar dhe mbrojtur: **“...Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t’u mbrojtur nga njëritjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut...”** (Haxh, 40)

Mirëpo, qoftë në Kuran, e qoftë në fjalët e Profetit tonë (a.s.), midis gjithë vendadhurimeve, tre prej tyre u është dhënë një rëndësi e veçantë. Këto janë, Mesxhidi Haram (Qabeja), Mesxhidi Aksa (Bejti-i Makdis) dhe Mesxhidi Nebeui (Xhamia e Profetit).

Dihet se Qaben e ka ndërtuar Ibrahim (a.s.) me të birin Ismailin (a.s.), Bejti Makdisin e ka ndërtuar Sulejmani (a.s.), ndërsa në Mesxhidin Nebeui, ka punuar personalisht edhe Profeti ynë (a.s.). Për rrjedhojë, që të tre këto mesxhide janë një trashëgimi profetike. Në një hadith, Profeti ynë (a.s.), ka thënë: “Udhëtimi (pelegrinazhi) bëhet vetëm në tre mesxhide. Në Mesxhidin tim, në Mesxhidin Haram dhe në Mesxhidin Aksa.” (Muslim, Kitabu’l-Haxh, 15/415, 511, 512.)

Në periudhën e injorancës, disa persona udhëtonin për të vizituar vendet që i konsideronin të shenjta, për t’i respektuar dhe nderuar, duke shpresuar begati dhe mirësi prej atyre vendeve. Në periudhën pas ardhjes së Islamit, kishte njëfarë ngatërrese në lidhje me disa vende që feja u jepte vlerë dhe kuptim simbolik. Ja pra, edhe ky hadith është thënë për ata

persona që përveç këtyre tre mesxhideve shkonin edhe në vende të tjera për t’i vizituar dhe për të falur namaz me këto ndjenja.<sup>2</sup>

Mesxhidi Aksa, është emri i xhamisë që gjendet në Kuds, e cila njihet edhe me ermin Bejti’l-Makdis dhe që është mesxhidi i dytë i ndërtuar mbi tokë.<sup>3</sup> Ky vend që sot njihet si Mesxhidi Aksa, është një kompleks i madh, brenda të cilit ndodhet tempulli i Sulejmanit, ndërtimi i të cilit u fillua prej Daudit (a.s.) dhe u përfundua nga i biri, Suljemani (a.s.). Ky mesxhid, që është përmendur edhe në Kuran, për shkak se atë kohë ishte një muaj larg prej zonës së Hixhazit, është cilësuar me emrin “Aksa”, që do të thotë “i largët”.

Mesxhidi Aksa dhe zona ku ndodhet ai përmendet në disa ajete të Kurani Fisnik. Për shembull, në një ajet ku flitet për Ibrahimin (a.s.) dhe nipin e tij Lutin (a.s.), thuhet: **“Ne e shpëtuam atë dhe Lutin (dhe i çuam) në tokën, të cilën e kemi bekuar për njerëzit.”** (Enbija, 71) Ky vend i bekuar për të cilin bëhet fjalë në Kuran, është zona e Palestinës dhe Damaskut ku ndodhet edhe Kudsi. Ndërsa në një ajet tjetër, Musai (a.s.), i drejtohet popullit duke u thënë: **“O popull im! Hyni në Tokën e shenjtë që Allahu e ka caktuar për ju dhe mos u ktheni prapa, se atëherë do të ktheheni të humbur!”**<sup>4</sup>. Toka e shenjtë, “el-arda’l-mukaddes”, që përmendet në këtë ajet, sipas shpjegimeve të komentuesve të Kuranit, është po kjo zonë midis Palestinës dhe Damaskut. Më vonë në këtë tempull, ka jetuar edhe Zekerijai (a.s.) dhe djali i tij Jahjai (a.s.). Edhe Merjemja, nëna e Isait (a.s.), këtu e ka kaluar fëmijërinë e saj. Lidhur me këtë, në Kuran thuhet: **“Zoti e pranoi atë me kënaqësi, e bëri**

2. shih. Abadi Ebu’t-Tajjib, Avnu’l-Ma’búd, Daru’l-Kutubu’l-Ilmijje, Beyrut, VI. 12; Sahih-i Buhari Texhrid-i Sarih Tercemesi ve Sherhi, Ankara, 1976, IV, 168.

3. shih. Buhari, Enbija, 40.

4. Maide, 21.

1. shih. Bekare, 34.



që të rritet mirë, duke e lënë nën kujdestarinë e Zekerijait. Sa herë që hynte Zekerijai në dhomën e saj, gjente pranë saj ushqim dhe e pyeste: **“O Merjeme! Nga të vjen ky ushqim?” Ajo përgjigjej: “Ky është nga Allahu, se Allahu e furnizon kë të dojë, pa kufi.”** (Al-i Imran, 37) Në këtë ajet përdoret fjala “mihrab”, e cila ishte një pjesë e vogël si dhomë brenda kompleksit të Mesxhidit Aksa që përdorej për adhurim ose nevoja të tjera. Nga ky ajet, kuptohet se ky ka qenë një vend ku shkonte shpesh Zekerijai (a.s.), i cili merrej me edukimin e Merjemes. Po në të njëjtin vend, Zekerija (a.s.), iu lut Allahut t’i japë një fëmijë, duke iu drejtuar me këto fjalë: **“...Zoti im! Dhuromë nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!”** (Al-i Imran, 38.) Më pas, Zekerijait i vjen përgjigja e lutjes: **“E ndërsa lutej në këmbë, në faltore, melekët e thirrën (Zekerijain): “Allahu të jep lajmin e mirë për Jahjain, i cili do të vërtetojë Fjalën e Allahut (Isain a.s.), do të jetë një fisnik, i dëlirë dhe profet, një prej të mirëve”.** (Al-i Imran, 39)

Siç kuptohet edhe nga ajetet e mësipërme, kibla e parë e besimtarëve, Mesxhidi Aksa, është përkujtuar me respekt dhe nder. Madje, Profeti ynë (a.s.), në një hadith, ka thënë se namazet e falura në këtë mesxhid, janë më të çmuar se namazet e falur në mexhide të tjerë: **“... Një namaz i falur në Mesxhidin Aksa, ka njëmijë herë më shumë shpërblime se namazet e falur në mesxhidet e tjera (përveç Mesxhidit Haram dhe Mesxhidit Nebeui)...”** (Ibn Maxhe, Ikametu’s-Salah, 196.)

Mesxhidi Aksa ka qenë vendi i shumë profetëve, ai është kibla e hebrenjve dhe të krishterëve dhe, për njëfarë periudhe ka qenë edhe kibla e myslimanëve. Pra, ai është një vend i shenjtë për pjesëtarët e tri feve. Përveç këtyre, ai është edhe vendi ku Profeti ynë (a.s.), është takuar me të gjithë profetët e tjerë në udhëtimin e Isras dhe Miraxhit.

Gjatë historisë, Kudsi ka ndërruar disa herë qeverisje. Megjithëse ka përjetuar një periudhë të gjatë kur myslimanët kujdeseshin për të, sot, ai është i privuar nga vlera e vërtetë që ka dhe nuk ndodhet nën administrimin që meriton. Madje, ai po përjeton periudhën e skllavërisë dhe robërisë. Kjo pjesë e jona e vuajtur dhe e hidhëruar, që përmban në historinë dhe rrënjët e saj gjurmë të thella për ne besimtarët, pret më shumë interesim dhe kujdes prej pjesëtarëve të fesë së fundit.

Në një hadith të Profetit (a.s.), thuhet: **“Shkoni në Bejt-i Makdis! Nëse nuk mund të shkoni e të falni namaz në të, atëherë dërgoni vaj ulliri për të ndezur kandilat e saj.”** (Ebu Daud, Kitabu’s-Salat, 14.) Ky është një mesazh shumë i rëndësishëm i cili është thënë që në kohën kur ato vende ende nuk ishin çliruar. Ky vend i shenjtë ku gjenden kujtimet e shumë profetëve që përmenden në Kuran dhe ku mendohet se gjenden të varrosur profetët e mëdhenj si Ibrahim (a.s.) me familjen e vet, Zekerija (a.s.) dhe Daudi (a.s.), pret më shumë interes dhe kujdes prej nesh.

Shkrimin tonë po e përfundojmë me transmetimin e një hadithi të Profetit tonë (a.s.), në lidhje me Mesxhidin Aksa, që i atribuohet Sulejmanit (a.s.): **“Kur Sulejmani (a.s.), e mbaroi ndërtimin e Mesxhidi Aksas, bëri një dua ku kërkoi tri gjëra prej Allahut: Aftësinë për të gjykuar në përputhje me gjykimin e Allahut. Një sundim dhe pasuri që nuk i është dhënë askujt para tij dhe nuk do t’i jepet askujt pas tij. Të gjithë ata që do të hyjnë në atë mesxhidin që ka ndërtuar, me qëllim që të kryejë adhurime, të dalin prej tij të pastruar prej gjynaheve siç kanë lindur prej nënës...”** Më pas, Profeti (a.s.), shton: **“Dy dëshirat e para të Sulejmanit (a.s.), janë plotësuar. Shpresojmë që edhe dëshira e tretë t’i jetë plotësuar.”** (Ibn Maxhe, Ikame, 196; Ahmed, Musned, II, 176.)



# URTËSI NGA MIQTË E ALLAHUT

## ABDULKADIR GEJLANI

(RAHMETULL-LLAHI ALEJHI)

Abdulkadir Gejlani (r.alejh), ka thënë:

“O bir! E gjithë përpjekja dhe mundimi yt në këtë botë le të mos përbëhen nga ngrënia e pirja, veshja, martesë, banimi në shtëpi të bukur e të rehatshme dhe mbledhja e pasurisë. Të gjitha këto janë gjëra që nefsi i kërkon me insistim.

Atëherë cila është përpjekja specifike për zemrën? Përpjekja e zemrës është të kërkuarit e Allahut. Kjo është gjëja e vetme që duhet ta bëjë ajo me këmbëngulje. Ajo për të cilën ti përpiqesh, mundohesh dhe e kërkon me insistim është gjëja më e rëndësishme për ty e cila të jep vlerë. Domethënë, Allahu Teala. Andaj gjëja që duhet ta kërkosh me insistim është Zoti yt dhe ajo që ka shpallur Ai.”

Kjo botë është vendi i sprovës në të cilin bujmë për një kohë të shkurtër para jetës së përhershme. Një han me dy dyer që nga njëra anë mbushet dhe nga tjetra zbrazet duke filluar që nga Ademi (a.s.), e deri te njeriu i fundit. Pasi edhe njeriu i fundit ta përjetojë sprovën e tij, kjo botë provizore do ta humbasë funksionin e saj dhe do të ndodhë shpërthimi i madh (kiameti). Të gjithë do t'i gjejnë në peshoren e tij ato që ka fituar dhe ato që ka humbur. Gjithashtu do t'i lexojnë edhe nga defteri i veprave të tyre.

Allahu i Lartësuar i do robërit e Tij dhe i nderon, sepse njeriun e ka krijuar nga asgjëja dhe e ka bërë krijesën më të nderuar. Atë e ka ftuar në xhenetin e Tij. Atij i ka dërguar edhe pejgamberë dhe libra, në mënyrë që ta ndihmojnë për t'u bërë meritore i kësaj ftese. Fuqia hyjnore e ka krijuar këtë univers si dëshmitar real dhe argument për madhështinë e saj.





Njeriut i ka dhënë zemrën dhe mendjen me të cilat mund t'i perceptojë këto. Të gjitha këto i ka dhënë në formën e një çelësi besimi për ata që mund të meditojnë.

Nëse zemra nuk është verbuar prej dëshirave të nefsit, atëherë çdo gjë që njeriu e shikon në këtë shkollë të universit i jep atij mësimet e “marifetull-llahut-njohjes së Allahut” që i kujtojnë ekzistencën, njësimin, fuqinë dhe madhësinë e Allahut Teala.

Nga ana tjetër, Allahu i Madhëruar i ka dhënë njeriut disa dije rreth kësaj bote të cilat janë si thërrime. Atij i ka dhënë mendjen nëpërmjet të cilës mund t'i zbulojë dhe përdorë ato (dije).

Por edhe dija, edhe mendja janë si një thikë me dy tehe. Ato mund të përdoren edhe për mirë, edhe për keq. Nëse mendja përparon nën udhërrëfimin e revelatës hyjnore, kjo dije e shpie njeriun te marifetull-llahu, i jep thellësi shpirtit nëpërmjet meditimit të rrymave të fuqisë hyjnore dhe zemrën gjithmonë e bën t'i drejtohet Allahut (xh.xh.) dhe botës së përtejme. Me atë që kanë një thellësi shpirtërore të tillë flasin edhe bimët sipas gjuhës së gjendjes së tyre siç është shembulli i bisedës së Junus Emresë me lulen e verdhë, flet dheu, flet uji, flet ajri...

Sepse siç ka thënë Sheh Sadi:

“Secila gjethe e pemëve të gjelbra është një kuvend dije në konsideratën e njerëzve të mençur që i shpie ata te marifetull-llahu. Ndërsa për të shkujdesurit të gjitha pemët nuk janë as edhe një gjethe.”

Nëse njeriu, të cilit Allahu i ka dhënë mirësi dhe vlerë të pafundme, e harron Zotin dhe e

kalon jetën duke rendur pas dëshirave vetjake, do të thotë se po shfaq një mosmirënjohje të madhe.

Allahu i Lartësuar i ka dhënë zemrën njeriut, në mënyrë që të preokupohet me dhikër, meditim e falënderim dhe të bëhet një vend ku shikon Zoti. Nëse njeriu ia specifikon Allahut Teala zemrën e tij dhe e lidh me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), nëse i bën vend në të besimit, Islamit dhe mirësisë, jeton i qetë dhe i lumtur.

Sikundër kësaj, nëse rri i shkujdesur ndaj Zotit dhe e lejon zemrën që të kaplohet nga dashuritë e përkohshme të kësaj bote, çfarëdo që të fitojë nga kjo botë, siç shprehet edhe Kurani Fisnik, do të thotë se ka punuar, por është lodhur kot.<sup>1</sup>

Siç ka thënë Ataullah el-Iskenderi (r.alejh):

“O Zot! Çfarë ka humbur ai që të ka gjetur Ty? Çfarë ka gjetur ai që të ka humbur Ty?..”

Allahu i Lartësuar e pyet njeriun duke iu referuar fazave që ky i fundit i kalon në mitrën e nënës para se të vijë në këtë botë:

**“O njeri! Ç’të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar, i Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi dhe, që të ka mbajtur në çfarëdo forme që ka dashur?!”**

(Infitar, 6-8)

Të mos harrojmë se ato që do të na bëjnë dobi në frymën e fundit, në varr, në kiamet, në llogari, në urën e Siratit dhe përfundimisht në jetën e përhershme, nuk janë dashuritë e përkohshme dhe provizore si mirazhet që shfaqen në shkretëtirë, por fakti se sa i kemi bërë adhurim Zotit në këtë botë dhe se sa jemi përpjekur në rrugën e kënaqësisë së Tij.

***Të mos harrojmë se ato që do të na bëjnë dobi në frymën e fundit, në varr, në kiamet, në llogari, në urën e Siratit dhe përfundimisht në jetën e përhershme, nuk janë dashuritë e përkohshme dhe provizore si mirazhet që shfaqen në shkretëtirë, por fakti se sa i kemi bërë adhurim Zotit në këtë botë dhe se sa jemi përpjekur në rrugën e kënaqësisë së Tij.***

Edhe ne jemi udhëtarë të botës tjetër si çdo i përkohshëm që vjen në këtë botë. Kështu që e kemi kusht që të jemi të përgatitur në çdo moment për këtë udhëtim. Andaj domosdoshmërisht duhet të përipiqemi për t'u bërë një rob i afërt ndaj Zotit (xh.xh.), duke i eliminuar një çast e më parë pasionet e nefsit dhe duke i zhvilluar aftësitë shpirtërore.

Për këtë arsye, nuk duhet të jemi të shkujdesur ndaj detyrave tona bazë duke u mbytur në shqetësimet materiale të jetës, në përpjekjet për të siguruar të ardhurat e jetesës dhe në hallet e problemet e tjera. Kështu që shpesh herë le ta rishikojmë gjendjen dhe ecurinë tonë. Le ta pyesim veten:

“Mos vallë jemi dërguar në këtë botë vetëm për të mbaruar një shkollë të mirë dhe për të marrë diplomën, për të pasur një pozitë të lartë dhe për të mbledhur pasuri? Apo kemi rënë në shkujdesjen për t'i shndërruar në qëllim këto mundësi të cilat duhet t'i përdorim si mjete përgjatë rrjedhës së jetës?!”

Sa i frikshëm që është paralajmërimi i këtij ajeti fisnik:

**“..Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”** (Teube, 24)

Pejgamberët, të parët e devotshëm dhe miqtë e Allahut që shkojnë në gjurmët e tyre, të gjitha përpjekjet e tyre i kanë fokusuar në rrugën e Allahut (xh.xh.) dhe këtë botë të përkohshme nuk e kanë parë asnjëherë me konsideratë duke u bazuar në vetëdijen: “*Jeta e vërtetë është jeta e botës së përtejme.*”<sup>2</sup> Ndërkohë që e vërteta është e tillë, atëherë, sa mashtrim i dhimbshëm është që të jetojmë sikur nuk do të vdesim asnjëherë duke thurur ëndrra në këtë botë pothuajse sikur të mos kishte ahiret dhe të banojmë në mysafirhanen e kësaj bote sikur të jemi vendas, në vend që t'i marrim për shembull ata! Sa falimentim i dhimbshëm për ahiretin është që kapitalin e jetës që jepet vetëm një herë ta çojmë dëm duke rendur pas pasioneve të ulëta!

Vlera e vërtetë e një njeriu kuptohet nëpërmjet faktit se çfarë kërkon dhe pas çfarë gjëje rend në këtë botë të përkohshme. Vlera e vërtetë e një njeriu i cili orientimin e qëllimeve dhe dëshirave të tij në këtë botë e ka vetëm për interesat e kësaj bote, është sa vlera e atyre gjërave të Allahut (xh.xh.). Siç thuhet në një hadith fisnik, vlera e kësaj bote të Allahut nuk është as sa fleta e një mushkonje.<sup>3</sup> Si rrjedhojë edhe Allahu Teala nuk i jep vlerë një njeriu që e harron botën tjetër duke i dhënë më shumë vlerë kësaj bote të cilës Zoti nuk i jep aspak vlerë.

Të mos harrojmë se lufta e prirjes ndaj kësaj bote dhe e prirjes ndaj botës tjetër brenda nesh do të vazhdojë deri në frymën e fundit. Andaj krahas kërkimit të rrëskut tonë në këtë botë, zemrën gjithmonë duhet ta orientojmë drejt botës së përtejme, në mënyrë që ambicia e kësaj

*“Nëse bota do të ishte prej floriri, por do të ishte e përkohshme dhe nëse ahireti do të ishte prej balte, por do të ishte e përhershme, njeriu i mençur zgjedh të përhershmen kundrejt të përkohshmes. Mirë, vallë çfarë duhet të bëjmë nëse situata është krejt e kundërt, domethënë, nëse kjo botë është prej balte dhe e përkohshme dhe nëse ahireti është prej floriri dhe i përhershëm?!”*

bote të mos e pushtojë zemrën tonë.

Siç thuhet në ajetet fisnike:

**“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.”** (Shems, 9-10)

Bazuar në këto që u thanë më lart, rob që posedon një dinjitet dhe nder të vërtetë të cilit Allahu i jep vlerë është ai njeri që e pastron zemrën nga ambiciet e kësaj bote, që e shpëton atë nga të qenët kasafortë e interesave materiale dhe që e shndërron atë në thesar të përshepshtshmërisë, domethënë të devotshmërisë dhe moralit të lartë.

Përfundimisht ne në këtë botë të sprovës nuk kemi ardhur për të fituar gjëra materiale, por për të fituar botën e përhershme. Për këtë arsye, kur të bëhet fjalë për ndonjë preferencë ndërmjet kësaj bote dhe botës së përtejme, shigjeta e busullës së zemrës sonë gjithmonë duhet të drejtohet nga ahireti.

Sa bukur është shprehur një i urtë:

“Nëse bota do të ishte prej floriri, por do të ishte e përkohshme dhe nëse ahireti do të ishte prej balte, por do të ishte e përhershme, njeriu i mençur zgjedh të përhershmen kundrejt të përkohshmes. Mirë, vallë çfarë duhet të bëjmë nëse situata është krejt e kundërt, domethënë, nëse kjo botë është prej balte dhe e përkohshme dhe nëse ahireti është prej floriri dhe i përhershëm?”<sup>4</sup>

Abdulkadir Gejlani thotë:

“O njerëz! Kini turp prej Allahut ashtu siç duhet dhe mos u bëni të shkujdesur. Koha po kalon dhe jeta po ju mbarohet. Ju jeni të preokupuar duke mbledhur pasuri të cilën nuk do ta konsumoni dot, pra, jeta juaj nuk do t’ju mjaftojë për ta konsumuar. Ju jeni të preokupuar duke shpresuar gjëra të cilat nuk do t’i arrini dhe nuk do t’i fitoni. Ju jeni të preokupuar duke

bërë ndërtesa në të cilat nuk do të banoni dot. Të gjitha këto të mos ju pengojnë nga audienca e Zotit!..”

Përgjatë periudhës së kalifatit të Omerit (r.a.), u çliruan shumë vende. Thesaret e mëdha të Bizantit dhe Iranit shkuan në Bejtu’l-Mal (thesari i myslimanëve). Kështu u rrit mirëqenia e popullit. Por Omeri (r.a.), mjaftohej vetëm me marrjen e një pjesë që e kishte të domosdoshme për jetesë. Andaj ai e mbante hytben me rrobë të arnuar. Të afërmit e tij të cilët nuk i rezistonin dot kësaj gjendjeje, i dërguan atij vajzën e vet, nënën tonë Hafsën dhe e sugjeruan që t’ia shtonte pak rrogën vetes dhe të bënte rehat.

Hafsa ia tregoi babait të saj këtë propozim të sahabëve. Omeri (r.a.), i cili kishte dëshmuar<sup>5</sup> shumë ditë në të cilat Pejgamberi ynë i nderuar përpëlitej prej urisë dhe nuk gjente dot diçka për të ngrënë, e pyeti bijën e tij, Hafsën:

“Bijë! Si ishte të ngrënë, të pirët dhe veshja e të Dërguarit të Allahut?” Ajo iu përgjigj:

“Vetëm aq sa i mjaftonte.” Pasi Omeri mori këtë përgjigje, e vazhdoi kështu fjalën:

“Dy miqtë e mi (Pejgamberi dhe Ebu Bekri) dhe unë u ngajmë tre udhëtarëve që ecin në të njëjtën rrugë. I pari ynë (Pejgamberi) arriti në destina-

cion. Edhe i dytë (Ebu Bekri) e arriti të parin duke ndjekur të njëjtën rrugë. Edhe unë si i treti dua t’i arrijë shokët e mi. Nëse marrë shumë barrë me vete, nuk mund t’i arrij ata! Mos vallë ti nuk dëshiron që të jem i treti i kësaj rruge?”<sup>6</sup>

Për këtë arsye, çdo besimtar duhet të punojë dhe të përpiqet për ta fituar rrëskun nga hallalli. Ndërkohë duhet të dijë që të mjaftohet me aq sa i nevojitet dhe të jetë i kënaqur me atë që posedon. Ai duhet të jetë i kënaqur me rrëskun që i ka caktuar Allahu (xh.xh.), në mënyrë që edhe Allahu të jetë i kënaqur me të.

Sikundër kësaj, nuk duhet të kaplohet nga



ambicia dhe duhet të ketë kujdes ndaj tamahut për pjesën përtej nevojës. Nëse Allahu i jep më shumë sesa ai ka nevojë, duhet të bëjë kujdes dhe të mos e harxhojë për gjëra luksi duke bërë israf apo duke e mbledhur e duke shfaqur koprraci. Pjesën e tepruar duhet ta japë, në mënyrë që të fitojë kënaqësinë e Allahut (xh.xh.).

Në ajetin fisnik thuhet:

**“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.”** (Al Imran, 92)

Çdo besimtar duhet ta testojë gradën e afritetit të tij me Allahun Teala përpara kësaj të vërtete hyjnore. Mbi të gjitha nuk duhet të harrojmë se në këtë botë është pothuajse një amanetqar, se pasuria e kësaj bote do të mbetet përsëri në këtë botë dhe se në botën e përtejme do të shkojë me llogarinë e rëndë: “Ku i ka fituar ato gjëra dhe ku i ka shpenzuar.”

Çmenduria e konsumit, prirja për shtirje dhe pasioni për të ekspozuar fuqinë që i sugjeron sot bota materialiste dhe kapitaliste, për fat të keq, i kanë shtyrë njerëzit në një vrullgati për të plasur pothuajse si kuajt e garave për të fituar dhe shpenzuar më shumë. Sepse pothuajse çdo gjëje vlera i matet në aspektin material. Kjo gjendje e helmon shpirtin dhe e shkatërron ndërgjegjen. Gjithashtu i than burimet e prehjes shpirtërore si lavdërimi i Zotit, falënderimi ndaj Zotit, pranimit i çdo gjëje që vjen prej Zotit, të mjaftuarit më atë që ka dhënë Zoti dhe modestia.

Ndërkohë prehjen shpirtërore që mund të na e japë një jetesë e thjeshtë e ngritur mbi modestinë dhe të mjaftuarit me atë që ka dhënë Zoti (xh.xh.), nuk mund të na e sigurojë asnjë pasuri materiale.

Një ditë sahabët e nderuar folën rreth mirësive të kësaj bote në prani të Pejgamberit tonë të Nderuar. Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut

(s.a.s.), u tha:

*“A nuk dëgjoni? A nuk dëgjoni? Të jetuarit e thjeshtë është prej besimit! Të jetuarit e thjeshtë është prej besimit!”* (Ebu Davud, Terexhxhul, 1/4161; Ibn Maxhe, Zuhd, 4.)

Ahmed ibn Hanbeli shprehet:

“Besimtarit i mjafton pak pasuri. Ndërsa njeriut ambicioz nuk i mjafton as pasuria e shumtë.”

Sepse besimtari ka hajër dhe begati prej pasurisë së tij ngaqë e falënderon Zotin për të dhe e jep pjesën që i tepron. Ndërsa njeriu ambicioz jeton i shqetësuar, pa prehje shpirtërore dhe në krizë për shkak të koprracisë dhe shpenzimeve të tepërta që bën, sepse sytë vazhdimisht i ka të uritur ngaqë nefsi nuk i ngopet asnjëherë.

Edhe hadithi fisnik: *“Nëse njeriu do të kishte një luginë plot me florinj, do të donte edhe një luginë tjetër. Sytë e tij nuk mund t’i ngopë asgjë tjetër përveç dheut...”*<sup>7</sup>, e përshkruan në mënyrë të mrekullueshme këtë gjendjen shpirtërore të njerëzve ambiciozë.

Nuk duhet të harrojmë se ambicia ndaj kësaj bote siç nuk e shton rrëskun, e pakëson prehjen shpirtërore, e trondit përshpirtshmërinë dhe e shkatërron begatinë e pasurisë. Sado që njeriu të jetë ambicioz, prapë se prapë do të fitojë ve-

tëm aq sa ka kësmet.

Në hadithin fisnik thuhet:

*“Atij që shqetësohet për botën e përtejme, Allahu ia vendos pasurinë në zemër, ia rregullon punët dhe dynjaja i shkon duke iu përkulur. Atij që shqetësohet për këtë botë, Allahu ia vendos varfërinë para syve të tij, i jep një jetë të çrregullt dhe prej kësaj bote i jepet vetëm aq sa i është caktuar.”* (Tirmidhi, Kijamet, 30/2465)

Abdulkadir Gejlani ka thënë:

“Të kalosh mirë me njerëzit dhe t’i shoqërosh ata me kushtin për të mos i kaluar kufijtë e fesë është diçka e mirë dhe e begatë. Por nëse





Siç dihet, ka dy faktorë që ndikojnë më së shumti te personaliteti dhe karakteri i njeriut:

1. Shkalla e hallallëkut e fitimit dhe ushqimit.

Nëse është hallall, e shtyn drejt mirësisë. Nëse është haram, e shtyn drejt ligësisë.

2. Gjendja shpirtërore e njeriut që qëndron dhe lidh miqësi me të.

Njeriu i mirë të shpie te mirësia. Kurse njeriu i lig të shpie në ligësi.

Andaj është thënë: "Ai që qëndron me atë që mbart aromë të keqe, mban aromë të keqe.

Ndërsa ai që qëndron me atë që mbart aromë të mirë, mban aromë të mirë!"

ky shoqërim dhe kalim i mirë me ta realizohet duke i kapërcyer kufijtë hyjnor dhe duke e nëpërkëmbur kënaqësinë e Allahut, atëherë nuk është diçka e mirë... Të shoqëruarit me njerëzit dhe të kaluarit mirë me ta në këmbim të nëpërkëmbjes së kufijve të fesë, nuk i jep asnjë lloj nderi njeriut!.."

Islami sugjeron jo individualizmin, por bashkëpunimin social. Të kaluarit mirë me njerëzit dhe të formuarit e miqësisë me ta është prej moralit të lartë që e sugjeron feja jonë. Por kjo ka një edukatë dhe disa rregulla. Sepse një mysliman nuk mund t'i nëpërkëmbë ligjet e Allahut të Lartësuar për hir të të kaluarit mirë me njerëzit. Besimtari e di se nuk ka bindje ndaj asnjë krijese kur bëhet fjalë për kundërshtim të Krijuesit.

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, na ka njoftuar si më poshtë sesi kanë filluar të prishen bijtë e Izraelit:

*"Në fillim kur shihnin ndonjë duke bërë një ligësi, e paralajmëronin duke i thënë:*

*"Shiko zotëri! Ki frikë prej Allahut dhe hiq dorë nga kjo që je duke bërë! Sepse kjo që po bën nuk është hallall (e lejuar) për ty!" Kur të nesërmen e shihnin atë burrë në të njëjtën gjendje, nuk e paralajmëronin më, në mënyrë që të hanin e të pinin bashkë me të dhe të uleshin e të qëndronin pranë tij. Ja pra, pikërisht atë kohë Allahu ua bëri zemrat të ngjashme me njëri-tjetrin..."* (Ebu Davud, Melahim, 17/4336.)

Domethënë se toleranca në kufijtë hyjnore me qëllimin për të fituar komplimentet, vlerësimet dhe admirimin e të përkohshmëve apo për të

shpëtuar nga dënimet dhe përjashtimi që mund të bëjnë ata, nuk përputhet me vetëdijen e besimit.

Në ajetet fisnike thuhet:

***"Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia e pushteti i takojnë Allahut..."*** (Fatir, 10)

***"...Në të vërtetë, fuqia është e Allahut, e të Dërguarit të Tij dhe e besimtarëve, por hipokritët nuk e dinë."*** (Munafikun, 8)

Afrimi ndaj armiqve të Islamit dhe mbështetja e tyre me qëllimin për të arritur famë e pushtet në këtë botë, ia shkatërron vlerën njeriut te Allahu (xh.xh.). Në hadithin fisnik thuhet:

"Mos i thoni "zotëri" hipokritit. Nëse do ta pranoni atë si zotëri, do ta tërhiqni mbi ju zemërimin e Zotit të Madhëruar." (Ebu Davud, Edeb, 83; Ahmed ibn Hanbel, V, 346.)

Domethënë se nderimi dhe vlerësimi i jobesimtarëve, hipokritëve dhe mëkatarëve për interesa të kësaj bote tërheq zemërimin e Allahut (xh.xh.). Kjo gjendje është shkujdesja shpirtërore për të hequr dorë nga ahireti për interesin e kësaj bote. Pra është budallallëku për të sakrifikuar detin për një pikë ujë.

Siç ka thënë edhe Omeri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij:

"Njeriu më injorant është ai që e shet ahiretin për dynjanë e të tjerëve. Domethënë ai që anon nga kënaqësia e njeriut në vend të kënaqësisë së Allahut."

Për këtë arsye besimtari duhet të qëndrojë larg

në mënyrë absolute nga çdo lloj mjedisi në të cilin e di se shkelen kufijtë hyjnorë. Në hadithin fisnik thuhet:

“*Vetmia është më e mirë se shoku i keq...*” (Hakim, III, 343; Bejhaki, Shuab, 256/4993.)

Mevlana e shpjegon këtë të vërtetë me këtë ngjasim:

“Betohem në Allahun se gjarpri i keq është më i mirë se miku i lig! Gjarpri i keq i merr jetën njeriut. Kurse miku i lig e hedh njeriun në zjarrin e përhershëm. Atë e djeg dhe e bën shkrumb e hi!..”

Siç dihet, ka dy faktorë që ndikojnë më së shumti te personaliteti dhe karakteri i njeriut:

1. Shkalla e hallallëkut e fitimit dhe ushqimit. Nëse është hallall, e shtyn drejt mirësisë. Nëse është haram, e shtyn drejt ligësisë.

2. Gjendja shpirtërore e njeriut që qëndron dhe lidh miqësi me të. Njeriu i mirë të shpie te mirësia. Kurse njeriu i lig të shpie në ligësi. Andaj është thënë: “Ai që qëndron me atë që mbart aromë të keqe, mban aromë të keqe. Ndërsa ai që qëndron me atë që mbart aromë të mirë, mban aromë të mirë!”

Siç ka thënë Imam Gazali: Miqësia e hapur me mëkatarët dhe të shkujdesurit me kalimin e kohës shndërron në miqësi mentale. Edhe miqësia mentale me kalimin e kohës shndërron në miqësi shpirtërore. Kjo do të thotë që njeriu po zvarritet hap pas hapi drejt shkatërrimit.

Sepse gjendja ka veçorinë e kalimit te tjetri. Siç ka në univers disa lloj rrezesh si alfa, beta, gama, ultravioletë, etj... edhe prej zemrës dalin disa rreze të padukshme. Rrezeve pozitive prej këtyre u themi “frymëzim” dhe “përshpirtshmëri”, kurse atyre negative u themi “shkujdesje” dhe “ngurtësim i zemrës”.

Prej besimtarëve të devotshëm dhe të singertë gjithmonë vjen frymëzim, përshpirtshmëri dhe energji pozitive. Për këtë arsye Allahu (xh.xh.), shprehet:

“**O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe qëndroni bashkë me të singertët!**” (Teube, 119)

Sikundër kësaj, qëndrimi me armiq të e fesë dhe mëkatarët sjell tragjedi. Nisur nga këto që thamë, përsëri në ajetin fisnik thuhet:

“**...Mos qëndro me njerëzit zullumqarë!**” (En’am, 68)

Edhe në hadithin fisnik thuhet:

“*Atë që do një popull, Allahu Teala do ta tubojë bashkë me të.*” (Hejsemi, X, 281.)

Nga ana tjetër, gjendjet negative apo pozitive ndikojnë edhe te vendet. Për këtë arsye duhet të qëndrojmë larg me përpikmëri edhe nga vendet e mëkateve e gjynaheve dhe nga mjediset në të cilat është shfaqur ndëshkimi hyjnor.

Kështu kur i Dërguari i Allahut (a.s.), po shkonte në luftën e Tebukut bashkë me sahabët, u ndalën për të bujtur në zonën Hixhr në të cilën është shkatërruar populli i Themudit. Sahabët morën ujë nga pusët që gjendeshin aty për nevojat e tyre dhe bënë brumë nga

ky ujë. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, i urdhëroi që ta derdhnin ujin që kishin marrë dhe t’ua jepnin deveve brumin që kishin bërë me të. Vetëm i lejoi që të merrnin ujë nga burimi prej të cilit pati pirë ujë deveja e Salihut (a.s.).<sup>8</sup> Pastaj Resulullahu, alejhi’s-selam, e mbuloi kokën me shallin e tij dhe eci shpejt përgjatë rrugës derisa e kaloi atë luginë.<sup>9</sup>

Sa mësimdhënëse është kjo gjendje, sepse, edhe pse kanë kaluar me qindra vite nga ajo

Gjendja ka veçorinë e kalimit te tjetri. Siç ka në univers disa lloj rrezesh si alfa, beta, gama, ultravioletë, etj... edhe prej zemrës dalin disa rreze të padukshme. Rrezeve pozitive prej këtyre u themi “frymëzim” dhe “përshpirtshmëri”, kurse atyre negative u themi “shkujdesje” dhe “ngurtësim i zemrës”.  
Prej besimtarëve të devotshëm dhe të singertë gjithmonë vjen frymëzim, përshpirtshmëri dhe energji pozitive.



ngjarje, ata që kalojnë edhe në ditët e sotme atje nuk marrin abdest prej atyre ujërave për shkak se është një vend në të cilin është shfaqur ndëshkimi hyjnor.

Nëse duhet të qëndrojmë kaq larg qoftë edhe nga vendet në të cilat janë bërë mëkate që kanë tërhequr ndëshkimin hyjnorë dhe në të cilat janë shkelur kufijtë hyjnorë, atëherë le të mendojmë se sa duhet të qëndrojmë larg miqësisë me jobesimtarët apo mëkatarët të cilët edhe në ditët e sotme vazhdojnë t'i bëjnë ato haramë apo haramë të ngjashme me to.

Veçanërisht në ditët e sotme është e domosdoshme që të shpëtojmë nga sëmundja “po bëj siç bëjnë të gjithë” në marrëdhëniet njerëzore. Asnjëherë nuk duhet ta nxjerrim nga mendja se rregulli ynë si myslimanë nuk duhet të jenë bindjet dhe zakonet e përhapura në shoqëri, por duhet të jenë urdhrat dhe ndalesat e Allahut të Madhëruar.

Allahu i Lartësuar na i paraqet sahabët e nderuar si brez shembullor. Në ajetin fisnik në të cilin thuhet: **“Ndiqini ata me mirësi!”**<sup>10</sup>, na sugjerohet që të bëhemi prej besimtarëve të devotshëm. Për këtë arsye gjendjen tonë duhet ta krahasojmë me atë të sahabëve të nderuar, jo me atë të shoqërisë sonë në të cilën jetojmë.

Sigurisht se mund ta ndjekim shoqërinë në adetet, zakonet dhe traditat e lejuara dhe të pranuar, por pasimi i shoqërisë në një çështje që bie ndesh me Islamit dhe veçanërisht pranimit i situatave ndaj të cilave Allahu nuk është i kënaqur duke thënë: “Çfarë të keqeje ka këtu? Të gjithë po e bëjnë!”, duke shfaqur kështu një shkujdesje të plotë shpirtërore, mund ta devijojnë njeriun nga rruga e drejtë, Allahu na ruajt.

Sa bukur e shpjegon kjo ngjarje këtë të vërtetë:

Sahabi Abdullah ibn Mes'udi (r.a.), një ditë u ftua në gostinë e një dasme. Ky sahab i zgjedhur u përball me një situatë që nuk përputhej me ndjeshmërinë e devotshmërisë në shtëpinë e dasmës. Kështu që nuk hyri brenda. Kur i zoti i shtëpisë i tha:

“Çfarë ndodhi? Përse nuk hyni brenda?”, Ibn Mes'udi, radijall-llahu anih, i dha këtë përgjigje:

“Unë kam dëgjuar se i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

*“Ai që ia shton numrin një populli është prej tyre. Ai që e pranon një punë që e bën një po-*

*pull është bashkëpunëtor me ata në atë punë”*” (Shik. Ibn Haxher, el-Metalibu'l- Alije, VIII, 319.)

Në ditët e sotme për fat të keq janë shtuar ambientet në të cilat nuk respektohen dispozitat shariatike për shkak të mungesës së edukimit shpirtëror. Me brengosje po dëshmojmë se edhe në dasmat e disa familjeve myslimane nuk bëhet kujdes siç duhet ndaj përzierjes së burrave me gratë, ndaj privatësisë dhe ndaj kufijve të hallallit e haramit. Sigurisht se martesat që fillojnë me toleranca të tilla nuk janë të suksesshme. Për fat të

keq, sipas statistikave të fundit vazhdimisht po shtohen divorcet në shoqëri.

Të mos harrojmë se sa më shumë që të bëhemi robër të përkushtuar ndaj Allahut Teala, aq më shumë mund të marrim ndihmë hyjnore.

Allahu i Lartësuar i dhëntë umetit të Muhamedit prehje shpirtërore, lumturi dhe unitet! Edhe popullit tonë i dhëntë gjithmonë unitet e bashkim në drejtësi e mirësi! Amin!..



■ **REFERENCAT:** 1) Shik. Gashije, 3. 2) Buhari, Rikak, 1. 3) Shik. Tirmidhi, Zuhd, 13. 4) Ebu'l-Abbas Ahmed bin Muhammed Ibn Axhibe, el-Bahru'l-Medid fi Tefsiri'l-Kur'ani'l-Mexhid, Kajro 1419, II, 112. 6) Shik. Ahmed, Zuhd, fq. 125; Shehbenderzade Ahmed Hilmi, Tarih-i islam - Historia Islame, I, 367. 7) Buhari, Rikak, 10; Muslim, Zekat, 116-119. 8) Shik. Buhari, Enbija, 17; Muslim, Zuhd, 40. 9) Shik. Buhari, Salat, 53; Enbija, 17; Tefsir, 15/2; Muslim, Zuhd, 38-39. 10) Shik. Teube, 100.



# DISA GABIME QË BËHEN NË KOMENTIMIN E KURANIT

— Dr. Murat Kaja —

Kurani Fisnik është libri i fundit që Allahu Teala e ka dërguar për të udhëzuar robërit e Tij. Për këtë arsye, ai e plotëson nevojën e të gjithë njerëzve që do të vijnë deri në kiamet. Andaj në çdo periudhë atij i bëhet tefsiri (komentimi) dhe jepen përpjekje për t'i konceptuar kuptimet që përfshin ai. Por vihet re se njerëzit bëjnë disa gabime kur e komentojnë atë. Më kryesoret prej tyre janë këto:

## **1. PARAGJYKIMI DHE FANATIZMI NDAJ MEDHHEBIT DHE FRAKSIONIT**

Gabimi që bëhet më së shumti kur komentohet Kurani është qasja ndaj çështjes me paragjykime dhe me gjykime të prera. Ky qëndrim në shumicën e rasteve sjell të vepruarit në mënyrë subjektive. Komentimet e atyre që u përkasin fraksioneve veçanërisht politike, besimore dhe ideologjike, shpesh herë dominohen nga anshmëria. Në këto lloje komentimesh që bëhen pa u mbështetur te ndonjë transmetim dhe me mendime personale, njeriu në fillim i beson një kuptimi dhe më vonë përpiqet që këtë kuptim t'ua përshtatë fjalëve të Kuranit.<sup>1</sup> Për këtë çështje ka shumë shembuj. Le të japim dy shembuj:

a. Ibn Omeri (r.a.), i konsideronte havarixhët si njerëzit më të këqij dhe shkakun për këtë e shpjegonte kështu: “Ata i praktikojnë te besimtarët ajetet që kanë zbritur për qafirët.”<sup>2</sup> Havarixhët këtë e bënin për shkak të fanatizmit ndaj medhhebit të tyre. Nuk është e drejtë që të praktikohen ndaj besimtarëve ajetet që flasin për qafirët, por besimtarët duhet të marrin mësim prej atyre ajeteve dhe sipas kësaj duhet ta rregullojnë gjendjen e tyre.

b. Orientimi i njerëzve duke përdorur dijetarët dhe shkencat islame për interesa politike dhe të mbledhurit e simpatizantëve për të arritur fuqi ka qenë njëra prej taktikave më të rrezikshme përgjatë gjithë historisë prej së cilës myslimanët janë dëmtuar.

## **2. MOSZBATIMI I KUSHTEVE TË TEFSIRIT**

Bazat dhe rregullat e një shkence janë si themeli për një ndërtesë. Ndërtesa mund të qëndrojë në këmbë vetëm mbi baza të forta.<sup>3</sup> Edhe shkencat e tefsirit ka disa rregulla dhe baza të saj. Disa njerëz që i shohin të panevojshme kushtet e caktuara për tefsirin, i kanë komentuar fjalët e Kuranit me kuptime të papërshtatshme duke bërë tefsir sipas akumulimit të dijes dhe kulturës që kanë vetë.

Këto lloje komentimesh të bëra pa i marrë në konsideratë metodën dhe rregullat e tefsirit dhe shkencat e Kuranit, por vetëm duke u bazuar në gjuhën arabe, tregojnë qartazi që nuk është marrë aspak parasysh se fjala e kujt është Kurani, se kujt i ka zbritur dhe se kujt i drejtohet.

Edhe mungesa e dijes rreth çështjes së Ulumu'l-Kur'an – Shkencave të Kuranit sjell mosrespektim të kushteve të tefsirit dhe te'vilit (komentimit). Kjo mangësi në fund sjell gabime në komentim dhe kontradikta. Ky transmetim e shpreh qartë këtë: Omeri (r.a.), një ditë ishte vetëm. Vetvetiu filloi të mendonte: “Si mund të bie në kontradiktë ky umet ndërkohë që ka një të Dërguar?” Andaj i thirri Ibn Abbasit (r.a.) dhe e pyeti:

“Si do të bie në kontradiktë ky umet ndërkohë që ka të njëjtin peygamber dhe të njëjtën kible?” Ibn Abbasi (r.a.), iu përgjigj:

“O prijësi i besimtarëve! Kurani na është zbritur neve dhe ne e kemi lexuar atë. Ne e dimë se për çfarë ka zbritur. Njerëzit pas nesh do të vijnë dhe do ta lexojnë Kuranin, por nuk do ta dinë se për çfarë ka zbritur. Për këtë arsye, do të japin mendimet e tyre në lidhje me të. Kur secili prej tyre të ketë mendimet e veta rreth Kuranit, do të bien në kontradikta. Kur të bien në kontradikta, do të grinden dhe luftojnë me njëri-tjetrin.” Omeri (r.a.), nuk e pëlqeu këtë përgjigje dhe e qortoi atë. Ndërsa Ibn Abbasi (r.a.), u largua prej aty. Pasi Omeri, radijall-llahu anh, mendoi pak rreth përgjigjes së tij, e kuptoi qartë se çfarë kishte dashur të thoshte ai. Menjëherë i thirri Ibn Abbasit dhe i tha: “Ma përsërit edhe një herë atë që më the më parë!” Edhe ai ia përsëriti atë që i kishte thënë më parë. Omeri (r.a.), e perceptoi kuptimin e fjalës së tij dhe i pëlqeu shumë ky shpjegim.<sup>4</sup>

Pika më e rëndësishme e përbashkët e njerëzve që përfshihen nga përkufizimi modernist është se ata i përqasen Kuranit në mënyrë historiciste dhe simbolike. Ata e kanë konsideruar Kuranin Fisnik si një tekst që e kanë nxjerrë në pah ndikimet ekonomike, sociale dhe politike dhe kanë pohuar se ai i përket një kohe dhe mjedisi të caktuar. Kur të studiohen librat e modernistëve dhe historicistëve, kuptohet krejt qartë se synojnë t'u zbrazin pjesën e brendshme ajeteve që përmbajnë lajme të gajbit me shpjegime mjaft relative që bazohen te lojërat e gjuhës dhe shpjegime simbolike e metaforike që mbështeten te pandehjet dhe që janë totalisht arbitrare. Ndërkohë në gjuhë si bazë merret kuptimi i vërtetë i fjalëve. Andaj nuk është e drejtë që kuptimi

i vërtetë të braktiset pa argument. Në Mexhel-le thuhet: “Baza në gjuhë është kuptimi i vërtetë.”<sup>5</sup> Kuptimi i vërtetë është bazë, ndërsa kuptimi figurativ është zëvendës i saj. Andaj nuk merret parasysh kuptimi figurativ ndërkohë që kemi kuptimin e vërtetë. Por nëse është i pamundur kuptimi i vërtetë nga fjala, atëherë shihet kuptimi figurativ, sepse të shprehurit e një kuptimi nga fjala është më mirë se të jetë pa asnjë kuptim. Muhamed Zahid el-Kevseri (v. 1952) thotë:

“Ndërmjet dijetarëve të vërtetë nuk gjendet asnjë që i komenton tekstet hyjnore përderisa të mos jetë i pamundur për t'u kuptuar kuptimi i tyre i vërtetë. Për këtë arsye, nëpër veprat e dijetarëve të vërtetë do të shohësh se kjo çështje shpjegohet në këtë formë: “Teksteve (hyjnore apo profetike) u jepet kuptimi i tyre i vërtetë. Braktisja e kuptimeve të vërteta të teksteve hyjnore dhe ngarkimi i tyre me kuptime që pretendojnë batinitë është mohim i Zotit. Refuzimi i teksteve hyjnore është kufër.”<sup>6</sup> Sepse, siç është shprehur edhe Buti (v. 2013), po të ishte e lejuar që çdo studiues dhe lexues ta nxirrte fjalën nga kuptimi i vërtetë i saj, t'i jepte kuptime të ndryshme figurative dhe të zgjidhte njërin prej tyre, gjuha do të paralizohej, fjalët do t'i humbnin kuptimet dhe njerëzit nuk do ta dinin dot çfarë të kuptonin. Si rrjedhojë, do të shastiseshin.<sup>7</sup>

### 3. PSIKOLOGJIA E MBROJTJES

Kundërshtimet dhe akuzat që orientalistët ia kanë adresuar Islamit, i ka futur disa mufesirë (komentues të Kuranit) në psikologjinë e mbrojtjes. Kjo i ka çuar ata në interpretim të gabuar të ajeteve fisnike. Për shembull, Abduh-Rizai është shprehur se të gjitha luftërat që ka bërë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), kanë qenë luftëra mbrojtjeje. Sipas atyre lufta në Islam është e kufizuar vetëm me ata që luftojnë me myslimanët dhe që u kërcënojnë lirinë fetare. Përveç këtyre askujt tjetër nuk mund t'i hapet luftë.<sup>8</sup> Ata që bëjnë tefsir në këtë mënyrë, duket se pohojnë kështu, pra pohojnë se Islami i ka dhënë leje vetëm luftës për mbrojtje, si një reagim ndaj atyre që dëshirojnë ta shfaqin Islamit si religjion armiqësor dhe barbar.

### 4. PËRPPJEKJA PËR RACIONALIZIM

Një botëkuptim që është përhapur shumë përgjatë ditëve të sotme dhe që përpiket ta shpjegojë çdo gjë në mënyrë racionale e shkencore, kohë pas kohe ka ndikuar edhe te interpretuesit e Kuranit. Kështu Abduh-Rizai edhe pse e pranon mrekullinë si parim, ka pohuar se periudha e mrekullive emocionale ka



marrë fund me largimin nga kjo botë e Pejgamberit (s.a.s.). Ai është përpjekur t'i racionalizojë shumë mrekulli që gjenden në Kuran dhe t'i shpjegojë brenda kornizës së shkaqeve të natyrshme.<sup>9</sup> Mustafa Islamogllu për xhindët<sup>10</sup> që punonin nën urdhrin e Sulejmanit (a.s.), është shprehur: “Këtu duhet të synohen njerëz “shumë të aftë si xhindë” apo “të zgjuar si xhindë” që punonin nën urdhrin e Sulejmanit (a.s.).”<sup>11</sup> Edhe kjo nuk është gjë tjetër përveçse një përpjekje për t'i racionalizuar qeniet e padukshme.

### 5. DËSHIRA PËR TË NXJERRË NË PAH NJË MENDIM ORIGJINAL

Edhe dëshira për të arritur famën duke thënë gjëra që nuk i ka thënë askush, që u duken njerëzve të ndryshme e tërheqëse dhe duke tërhequr vëmendjen e tyre në këtë mënyrë, shumë njerëz i ka bërë të gabojnë përgjatë interpretimit të Kuranit. Për shembull, Bajraktar Bajrakllë në parathënien e tefsirit të tij shprehet: “Kemi dhënë përpjekje për të bërë interpretim duke mos i përsëritur ato që janë thënë dhe duke mos i imituar ato që janë bërë deri në këtë kohë. Sepse të prodhuarit e gjërave origjinale është dashuria dhe pasioni ynë në interpretimin e Kuranit.”<sup>12</sup>

Kur të themi diçka që nuk e ka thënë askush, duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse mundësia

për të gabuar është shumë e madhe. Andaj është thënë: “Të kundërshtuarit e shumicës vjen nga gabimi i madh.” Imam Zuferi (v. 158/775) ka thënë: “Kur debatoj me dikë, debatoj jo derisa të heshtë, por derisa ta humbë mendjen dhe të acarohet.” Kur është pyetur: “Si acarohet personi me të cilin debaton?” Ai është përgjigjur: “Them diçka që nuk e ka thënë askush!”<sup>13</sup>

### 6. DËSHIRA PËR TË ZGJUAR DYSHIME RRETH KURANIT DHE ISLAMIT

Disa njerëz që dëshirojnë të zgjojnë dyshime rreth Kuranit Fisnik dhe Islamit në mendjen e njerëzve, kanë bërë interpretime të gabuara me qëllim dashakeqës. Me këtë kanë synuar t'u shërbejnë jo-muslimanëve dhe t'i ftohën njerëzit nga Islami dhe Kurani. Kështu disa persona të kësaj kohe ajetin: “*Ne shënuam në Zebur, pas Teuratit, që tokën (e Xhenetit) do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë.*”<sup>14</sup>, e kanë komentuar në formën: “Rruzullin tokësor do ta zhvillojnë vetëm njerëzit e përshtatshëm për zhvillim pavarësisht se nga cila fe vijnë apo cilit medhheb i përkasin.”<sup>15</sup> Sipas Abdullah el-Gumarit (v. 1993) qëllimi i tyre nga ky interpretim është mbështetja e kolonializmit perëndimor dhe thyerja e rezistencës kundrejt perëndimorëve duke thënë se “Kurani na lajmëron se ata do ta trashëgojnë këtë botë”.<sup>16</sup> Ndërkohë fjala “ard” që është përmendur në ajet është komentuar si “xheneti” apo si “tokat që Allahu ua ka premtuar besimtarëve” dhe që umeti i Muhamedit do t'i çlirojë nga qafirët.<sup>17</sup>

Si përfundim, interpretimi i disa ajeteve të Kuranit Fisnik sipas kohës është i pashmangshëm ngaqë Kurani Fisnik u drejtohet të gjithë njerëzve që do të vijnë derisa të ndodhë kiameti. Andaj kur të bëjmë ndonjë interpretim të ajeteve, duhet që nevojat e kohës t'i bashkojmë në një pikë me metodën dhe rregullat e shkencës së tefsirit, në mënyrë që të mos biem në gabim.

■ **REFERENCAT:** **1)** Muhammed Husejn Dhehebi, el-Itixhahatu'l-munharife fi tefsiri'l-Kur'ani'l-Kerim -Devafiuha ve def'uha- (Mektebetu Vehbe, 1406/1986), 20. **2)** Buhari, Istitabe, 6; Ibn Haxher el-Askalani, Tagliku't-taglik ala Sahihi'l-Buhari, korrektoi Said Abdurrahman Musa (Bejrut, el-Mektebetu'l-Islami, 1405), 5: 259. **3)** Mahmud Muhammed Jakub Tahir, Esbabu'l-hata' fi't-Tefsir (Daru Ibni'l-Xhevi, 1425), 85. **4)** Ebu Ubejd Kasim b. Sel-lam, Fedailu'l-Kur'an, korrektoi Mervan el-Atijje dhe të tjerë. (Damask, Daru Ibn Kethir, 1415/1995), 102-103. **5)** Mexhel-le, neni I 12-të. **6)** Muhammed Zahid el-Kevseri, Nadhratun abira fi mezaimi men junkiru nuzule Isa (a.s) kable'l-ahira (Kajro: Daru'l-Xhil, 1408/1987), 124. Krahasoi Byjyck Hajdar Efendi, Mësimet e Usul-i Fikh, përgatiti Ibrahim Subashi, 211. **7)** shik. Muhammed Said Ramadan el-Buti, Fikhu's-Sire (Damask: Daru'l-Fikr, 2007), 47. **8)** Xhelil Kiraz, Menâr Tefsirinde Özgün Yorumlar - Komentime origjinale në Tefsirin Menar (Bursa: Botimet Emin, 2017), 274-281. **9)** Për shembujt shik. Kiraz, Menâr Tefsirinde Özgün Yorumlar - Komentime origjinale në Tefsirin Menar, 148-178. **10)** Shik. Sebe' 34/12. **11)** Mustafa Islamogllu, Hayat Kitabı Kur'an -Gereqçeli Meal-Tefsir- (Stamboll: Botimet Dyshyn, 2009), 848, 11. **12)** Bajrakllë, Yeni Bir Anlayışın Işığında Kur'an Tefsiri - Tefsiri I Kuranit nën dritën e një botëkuptimi të ri, 1: 63. **13)** Kevseri, Nadhratun abira, 92. **14)** Enbija, 105. **15)** Ahmed b. Mustafa el-Meragi, Tefsiru'l-Meragi (Egjipt: Mektebetu Mustafa el-Babi, 1365/1946), 27: 76; Ibrahim ibn Ismail el-Ebjari, el-Mevsuatu'l-Kur'anije (Muessesetu Sixhil-li'l-Arab, 1405), 10: 338. **16)** Ebu'l-Fadl Abdullah ibn Muhammed ibn es-Siddik el-Gumari, Bide'u't-tefasir (ed-Daru'l-Bejda, Daru'r-Reshadi'l-Hadithe, 1406/1986), 93. **17)** Taberi, 18: 549-550.

# RËNDËSIA E RINISË DHE ÇËSHTJA E IDENTITETIT

— Dr. Kerim Bulladë —

Ardhja në këtë botë e Pejgamberit tonë të Nderuar (s.a.s.), sipas kalendarit të shpallur nga Kryesia e Dijanetit (entit të çështjeve fetare në Republikën e Turqisë), këtë vit do të festohet në muajin nëntor si “Java e Lindjes së Pejgamberit”. Tema kryesore e organizimeve që do të realizohen në nderim të kësaj jave është zgjedhur si “Pejgamberi dhe Rinia”. Edhe ne në këtë material do të përqipemi të shtjellojmë rëndësinë e rinisë dhe problemin e identitetit.

## 1- PERIUDHA E RINISË

Rinia nga aspekti psiko-social përkufizohet si një proces që fillon me pubertetin dhe që vazhdon deri në moshën 22-25 vjeçare.

Pejami Safa (v. 1961) me të vërtetë bën një portret origjinal në lidhje me rininë: “Kuptimi i rinisë në fjalorin e natyrës është freskia. Lulëzimi i një fidani të freskët në trup, shkëlqimi i një gjetheje të freskët në lëkurë, shpërthimi i fijeve të freskëta në flokë, rrjedhja e një burimi të freskët te sytë, e kuqja e frutës së freskët te buzët dhe gjallëria e freskët në ecje. Kuptimi i rinisë në fjalorin e shoqërisë është diçka shumë më e lartë se freskia. Ajo është një gjallëri që lind nga kontakti me xhevahirin e ndjenjës kombëtare. Një dritë mishërimi në zgjuars që lind nga nevoja për të kuptuar çështjet të cilat na i ka radhitur përpara shoqëria. Tingulli i telave që

e lidhin njeriun me njeriun në zemër. Përgatitja në vullnet për t’u gjuajtur nga harku e për t’u hedhur drejt synimeve më kuptimplota sesa të jetosh në mënyrë kafshërore. Një njeri i prapambetur dhe një popull i prapambetur është ai që e gjen kuptimin e rinisë vetëm në fjalorin e natyrës. Njeri i përparuar dhe popull i përparuar është ai që e shton edhe kuptimin e rinisë në fjalorin e shoqërisë. Në këtë mënyrë i riu nuk mjaftohet vetëm me të qenët një fidan i freskët dhe një qenie e gjallë, por bëhet një njeri i vetëdijshëm, i zgjuar, i kulturuar, i përgatitur, i vullnetshëm dhe këmbëngulës.<sup>1</sup>

## 2- RËNDËSIA E RINISË

Rinia është burimi i krenarisë, fuqisë, shpresës dhe dëshirës së çdo populli. Të rinjtë në çdo fushë luajnë rolin e lokomotivës në zhvillimin dhe përparimin e vendit dhe popullit të tyre. Çdo popull që u ka dhënë vlerë brezave të rinj, është lartësuar. Ndërsa ata që i kanë nënvlerësuar, kanë mbetur mbrapa. Qëndrimi në këmbë i popullit, ruajtja e fesë dhe mbrojtja e vlerave kulturore, ndodh falë energjisë dhe aksioneve të të rinjve që kanë marrë një edukim të mirëfilltë dhe sakllam që në fillim.

Rinia, siç shprehet shumë bukur në shqipen tonë, është periudha e “adoleshencës”. Pra, është periudha kur gjaku zien, zemrat rrahin fort dhe emocioni



arrin pikën kulmore. Kjo periudhë edhe një segment kohor kur përrrenjtë shndërrohen në lumenj, kur ata nuk i zë më shtrati i tyre dhe kur bëhet një jetë plot çmenduri.<sup>2</sup> Rinia është një mirësi e rëndësishme për të cilën duhet ta falënderojmë Allahun, sepse ajo i është dhënë njeriut nga Zoti (xh.xh.). Pejgamberi (a.s.), na ka njoftuar me këto fjalë të bekuara se të gjithë do të merremi në llogari dhe do të pyetemi se ku dhe si e kemi harxhuar këtë mirësi: “Njeriu ditën e kiametit nuk do t’i lëvizë dot këmbët nga vendi pa u pyetur për këto katër gjëra. E para: Ku e ka harxhuar jetën. E dyta: Në cilën rrugë e ka harxhuar rininë...”<sup>3</sup> Në këtë mënyrë njeriu do të merret në llogari për jetën në përgjithësi dhe për rininë në veçanti. Sepse rinia është periudha e fuqisë dhe aktivitetit që Allahu Teala ia ka dhënë njeriut ndërmjet dy periudha të dobësisë që janë fëmijëria dhe pleqëria.<sup>4</sup>

E ardhmja e popujve është e lidhur me rininë dhe me edukimin e rinisë. Popujt që i japin rëndësi edukimit dhe arsimimit të rinisë së tij duke marrë parasysh edhe rrethanat e kohës që përparojnë, gjithmonë janë lartësuar dhe janë bërë të zotët e fjalës në botë. E ardhmja e një vendi është e lidhur


me kulturën, moralin, arsimimin dhe edukatën që do të marrë rinia. Madhështia dhe fuqia e një populli nuk është e lidhur me numrin e shumë të banorëve, por është e lidhur drejtpërdrejt me numrin e të rinjve të mençur, largpamës, të virtytshëm, të ditur, të ndershëm, fisnikë, që i besojnë vetes, besimtarë dhe të vendosur.

Periudha e rinisë dhe adoleshencës i ngjan lumenjve që rrjedhin furishëm. Përderisa të mos kanalizohen në një orientim të saktë lëvizjet dhe energjia e të rinjve, këta të fundit e shkatërrojnë dhe e fshijnë nga faqja e dheut çdo gjë pikërisht si lumenjtë që dalin nga shtrati i tyre. Kështu që e dëmtojnë ndjeshëm jetën e shoqërisë dhe popullit. Rinia është themeli i popullit, e ardhmja e vendit, pavarësia e atdheut dhe shtylla e shoqërisë. Të rinjtë janë mirësia dhe begatia më e shtrenjtë që Allahu Teala ia ka dhënë familjes dhe popullit. Mbi të gjitha janë amaneti i Tij.

Qëllimi më i madh i një populli duhet të jetë edukimi i brezave që do ta ketë kauzë të tyre idealin e popullit dhe atdheut dhe që do t’i japin përparësi interesit të popullit e shoqërisë kundrejt interesit të tyre. Edukimi i brezave të integruar me fenë, zakonet, adetet dhe traditat e popullit është qëllimi absolut i idealit të shoqërisë. Sepse fuqia dhe parimet jetike që e mbajnë popullin në këmbë janë të fshehura dhe të goposura në jetën e atyre.

Rinia është periudha më energjike dhe aktive e jetës së njeriut. Ideat e njeriut, ndjenjat e ndryshme të tij, ëndrrat e pasura dhe emocionet e këndshme të tij fillojnë të formohen në këtë periudhë. Në këtë periudhë formohen dijet, cilësitë e bukura, zhvillohet karakteri dhe personaliteti dhe ndërtohet vullneti, durimi, qëndrueshmëria, vendosmëria dhe aftësia për t’u përpjekur të cilat do të jenë të nevojshme për njeriun përgjatë gjithë jetës. Formimi i idealeve dhe hedhja e hapave që i japin drejtim jetës së njeriut ndodhin përgjatë kësaj kohe. Fillimi i përgjegjësisë dhe i marrjes përsipër të problemeve merr start në këtë pikë.

Përgatitja për jetën, fitimi i lumturisë së përherëshme dhe arritja e shijes së nderit të të qenët rob i Zotit, formohen në këtë periudhë. Kjo fazë është njëra prej etapave më të rëndësishme të jetës së njeriut. Për këtë arsye, duhet të shfaqet përpjekja më e madhe për ta bërë këtë etapë produktive, të begatë dhe të bereqetshme. Në lidhje me këtë çështje duhet të përgatiten programe të rëndësishme dhe të planifikohen projekte të tilla.



### 3- ÇAKTIMI I IDENTITETIT

Njëra prej çështjeve të rëndësishme që influencën te rinia është edhe çështja e identitetit. Të mos dish se kush je, të mos vendosësh dot se kush do të bëhesh, të mos caktosh dot se kujt do t'i ngjash dhe kë do të marrësh për shembull, janë prej çështjeve që e vështirësojnë më së shumti rininë. Një rini që ka mbetur ndërmjet dëshirës për t'u bërë një fëmijë i perëndimit si një nip i kulturës së Lindjes, pothuajse është e pamundur të gjejë prehje shpirtërore, ta njohë veten dhe të ecë me vendosmëri drejt të ardhmes.

Tani kemi të bëjmë me një rini që rrënjët i ka nga lindja dhe dëshirat i ka nga perëndimi. Një rini që vazhdon t'i drejtohet perëndimit apo të edukohet dhe orientohet gjithmonë në këtë drejtim edhe pse feja, morali, kultura, zakoni, adeti dhe tradita e saj është nga lindja. Një rini që edhe e dënon perëndimin, edhe përpëlitet për t'u bërë perëndimore.

Çështja e identitetit ndoshta është prej problemeve më të mëdha të rinisë së sotme. Të gjithë si njerëz kemi një identitet të poshtëm siç është prejardhja, raca dhe populli. Po ashtu kemi edhe një identitet të sipërm siç është feja, gjuha dhe kombi. Kurani Fisnik asnjëherë nuk e refuzon identitetin e poshtëm. Në ajetin fisnik: ***“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdhijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.”***<sup>5</sup>, njoftohet se të gjithë njerëzit kanë ardhur nga e njëjta rrënjë dhe shpjegohet qartë se nga kjo rrënjë kryesore kanë ardhur fise të ndryshme.

Shkaku i ardhjes së njerëzve në këtë botë dhe i nënshtrimit të universit ndaj tyre që të jetojnë, është që ata të mirëkuptohen me njëri-tjetrin, të njihen dhe të formojnë miqësi. Të gjithë mund ta ruajnë identitetin e poshtëm brenda këtyre rregullave, mund ta zhvillojnë dhe mund të ndjehen krenarë me të. Mbi këto gjendet edhe identiteti i kombit. Edhe ky identitet është një identitet i lartë i rëndësishëm që i përfshin të gjitha identitetet e tjera dhe që mundëson mbrojtjen e tyre në paqe. Ndërsa mbi të gjitha këto gjendet identiteti i fesë dhe vëllazërisë.

Identiteti dhe vëllazëria e fesë është një identitet

integruar, bashkues dhe gjithëpërfshirës. Ky identitet posedon një fushë të gjerë duke u bazuar në parimin: ***“Besimtarët janë vëllazër...”***<sup>6</sup> Korniza e këtij identiteti është e gjerë. Parimi më themelor i këtij identiteti është “tevhidi”, apo thënë ndryshe, njësimi i Zotit. Mësimi i parë dhe absolut i këtij identiteti është besimi ndaj ekzistencës dhe njësimimit të Allahut (xh.xh.). Të gjithë ata që i besojnë ekzistencës dhe njësimimit të Allahut, profecisë së Muhamedit (s.a.s.), të gjithë pejgamberëve, të gjithë librave dhe ditës së gjykimit, e arrijnë vëllazërinë duke e zhvilluar identitetin e tyre të poshtëm që posedojnë brenda këtij identiteti. Kjo vëllazëri është vëllazëri e përhershme. Rruga për të arritur lumturinë edhe në këtë botë, edhe në botën e përtejme është e lidhur me këtë vëllazëri. Manifestet e tjera të rëndësishme të këtij identiteti pas tevhidit janë parimet absolute si besimi ndaj Kuranit, drejtimi ndaj kiblës, të qenët umet i Pejgamberit (s.a.s.), etj. Paqja, stabiliteti, siguria, lumturia, njësimi dhe integriteti i rinisë arrihet vetëm me këtë identitet. Kështu që nuk është e nevojshme të jesh magjistar (parashikues) për të thënë se ata që e posedojnë këtë identitet dhe njihen te ai me njëri-tjetrin, kurrë nuk do të devijojnë, nuk do ta lëndojnë njëri-tjetrin dhe nuk do të përbëjnë kërcënim për atdheun dhe popullin e tyre. Materialin tonë dëshirojmë ta përfundojmë me vlerësimin e një dijetari dhe mendimtari tonë.

Kriza e identitetit është një lëmsh i trishtuar problemesh që e shfaqin personalitetet “kaotike dhe të deformuara” të cilat dalin në pah si pasojë e përplasjeve të kulturave të ndryshme. Problemi i identitetit po rritet edhe në vendin tonë ashtu siç po ndodh në të gjithë botën. Zhvillimi i shpejtë i mjeteve të komunikimit dhe kontaktimit masiv, shtimi i marrëdhënieve ndërkombëtare, përshtetimi i urbanizimit paralel me industrializimin, gjendja e prindërve të cilët interesohen më pak me familjen dhe fëmijët e tyre për shkak se punojnë, dobësimi i dialogut ndërmjet nxënësve dhe mësuesve në shkollë, infiltrimi ndërmjet të rinjve i fuqive të fshehta, i qarqeve tradhtarë dhe i njerëzve dashakeqës, shkatërrimi i vazhdueshëm i botimeve të pakontrolluara që ekspozojnë femrën në mënyrë të papërshtatshme, përhapja e alkoolit dhe e drogës, dashje pa dashje nxjerrin në pah një krizë identiteti dhe më e keqja, e vështirësojnë adaptimin e brezave të rinj.<sup>7</sup>

■ **REFERENCAT:** 1) Pejami Safa, Seçmeler – Pjesë të zgjedhura (Yeni Mecmua, 19 Maj, 1939), Përgatitën, Faruk Timurtash - Ergyn Göze, Stamboll, 1970 (1000 Temel Eser) fq. 31. 2) Mustafa Ehxhall, Gençliğimiz ve Geleceğimiz – Rinia dhe e ardhmja jonë, Gençlik Dönemi ve Egitimi – Periudha e rinisë dhe edukimi, Stamboll, Brenda 2000 (Tartusmalı İlmî Toplantular Dizisi – Seriali i mbledhjeve shkencore me debate, 29), fq. 13. 3) Tirmidhi, Sunen, Kijamet, 1. 4) Shik. Surja Rum, 53. 5) Huxhurat, 13. 6) Huxhurat, 10. 7) Ahmet Arvasi, Kültür Emperyalizmi ve kimlik Bunalımı – Imperializmi i Kulturës dhe Kriza e Identitetit, Revista Jeshilaj, Uyusturucu Kültürü – Kultura e Narkotikës, Stamboll, 1992, fq. 60.



# DALLIMET NË LUMTURI NË MESIN E NJERËZVE

— Shah Velijullah Dehlevi —

Ti duhet ta dish se guximi dhe pjesa tjetër e viryeteve gjenden në shkallë të ndryshme tek individët njerëzorë.

Ndër ta është personi të cilit i mungon totalisht guximi, arritja e të cilit nga ana e tij është përjetësisht e pashpresë për shkak të ngulitjes së formës së kundërt në themelin e natyrës së tij. Shembuj janë personi i efeminuar apo ai me zemër të dobët sa i përket guximit.

Ndër ta është personi i cili ka mangësi në guxim, tek i cili ka shpresa (që ai të zhvillohet) mbas vepërimeve të tij ushtruese, thënieve, dhe qëndrimeve të përshtatshme për të, pasi të mësojë gjëra të tilla nga njerëzit e guximshëm, dhe të sjellë në kujtesë rrëfenjat e atyre që janë më të përsosurit në të, pra, atë çfarë u ka ndodhur atyre në kaluarën, pasi ata qëndruan të paluhatur në fatkeqësi dhe u përballën me rrethana të rrezikshme.

Ndër ta është personi që bazën e këtij virtyti e ka të krijuar në natyrën e tij, por i cili vazhdimisht bie pre e gabimeve, kështu që në qoftë se atij i jepet urdhër që ta frenojë veten prej tyre, kjo është tejet shtypëse për të dhe ai bëhet i heshtur në zemërim.

Në qoftë se atij i jepet urdhër që të bëjë diçka të pajtueshme me natyrën e tij, kjo do të ishte si sulfur të cilit i vihet flaka, sepse djegia nuk do të vononte.

Ndër ta është personi tek i cili ky virtyt është i krijuar plotësisht dhe me bollëk. Ai domosdoshmërisht do të ngutet që të realizojë kërkesat e këtij virtyti, dhe në qoftë se, për shembull, ai do të nxitet që të tregohet burracak, ai megjithatë nuk do të thyhet. Të vepruarit me akte që janë në përputhje me këtë virtyt dhe me qëndrime të përshtatshme për të do të jetë e lehtë për atë nga natyra, pa ndonjë konvencion apo shtytje. Ky person është udhëheqës në këtë virtyt dhe nuk ka nevojë për asnjë mësues, dhe ata të cilët janë inferiorë në raport me të në këtë virtyt duhet të ndjekin shembullin e tij dhe duhet t'i rrokën me vendosmëri sjelljet e tij. Ata duhet të kapen fort pas imitimit të qëndrimeve të tij dhe nuk duhet të harrojnë kurrsesi përvojat e tij në mënyrë që ata të mund të realizojnë përsosmërinë e këtij virtyti i cili është parashikuar tek ata në përputhje me atë që është dekretuar, apo shkruar, në rastin e tyre.

Në mënyrë të ngjashme, njerëzit ndryshojnë sa i



përket këtij virtyti nga i cili varet lumturia e tyre.

Ndër ta është personi i cili është krejtësisht i pri-  
vuar nga guximi, për të cilin nuk mund të shpre-  
sohet se do të bëhet punëdrejtë, njëlloj si ai të cilin  
Hidri e vrau<sup>1</sup>, dhe i cili nga natyra ishte mosbesim-  
tar. Kjo është ajo çka tregohet në thënien e Zotit,  
qoftë Ai i Lartësuar: “Të verbër, të shurdhët dhe të  
pamend, ata nuk kanë për t’u penduar.”<sup>2</sup>

Ndër ta është ai i mangëti tek i cili ky (virtyt)  
mund të parashikohet (se do të shfaqet) mbas ush-  
trimeve të mundimshme dhe veprimeve të tejzgja-  
tura të cilat ndëshkojnë nefsën (frymën) e tij më  
të ulët. Një person i tillë lyp nxitjen e thirrjes së  
pejgamberëve dhe praktikat e zakonshme që kanë  
ardhur dorë pas dore prej tyre, dhe këta janë  
shumica e njerëzve. Ardhja e pejgambe-  
rëve ka thelbësisht dhe kryesisht për  
qëllim pikërisht këta të fundit.

Ndër ta është personi tek i cili  
ky virtyt është vendosur në një  
kuptim të përgjithshëm por i  
cili person gjithashtu bën gabi-  
me. Kësodore, ai duhet të ketë  
një ekzemplar në pjesën më  
të madhe të rasteve në më-  
nyrë që të përpunojë dhe të  
eksponojë qëndrimet që janë  
të përshtatshme për këtë vir-  
tyt. Në lidhje me këto, Zoti,  
qoftë i Lartësuar, thotë: “Vaji  
i të cilëve do të flakëronte (nga  
vetvetja) ndonëse asnjë zjarr  
nuk e ka prekur atë.”<sup>3</sup> Këta njerëz  
quhen “Ata që shkëlqejnë”.<sup>4</sup>

Ndër tipet e njerëzve janë pej-  
gamberët të cilët qenë në gjendje, pa  
një ekzemplar apo nxitje të mëparshme,  
të bënin të mundur përsomërinë e këtij virtyti  
dhe të zgjidhnin qëndrimet e duhura për të si dhe  
të prodhonin mjetet për ta bërë atë që i mungonte  
ky virtyt ta përftonte atë, ta bënin atë të mos resh-

1. Kuran 18:75 e më tutje. Hidri përmendet tërthorazi në përshkrimin  
kuranor të Musait ku ai shfaqet si mësuesi i tij të mistershëm. Pjesë e  
përgatitjes së Musait nuk ishte që të vinte në diskutim veprimet e Hidrit  
që përfshijnë vrasjen e një djaloshi. Më vonë, zbulohet se njeriu ishte nga  
natyra jobesimtar i cili do të kryente akte tejet të këqija. Kjo shtjellohet  
në transmetime hadithi, shiko për shembull, Mishkat, fq. 1222. Buhariu  
Enbija; 23, Khan, përkth. IV:405.

2. Kuran 2:18.

3. Kuran 24:35.

4. El-Sabikun“ janë „ata të cilët shkëlqejnë në vepra të mira“ përmenden  
në Kuran 56:10. Në terminologjinë e Shah Vali Allah, këta janë njerëzit që  
kanë më të fortë anën ëngjëjllore. Shiko Kapitullin e 69-të.

te tek ai në të cilin ishte tanimë i pranishëm, dhe  
të përsosnin personin i cili ishte i mangët në të.  
Kështu, ndërkohë që ndiqnin kërkesat e prirjes së  
tyre natyrore, ata sistematizuan kodet e sjelljes, që  
njerëzit i bartin në mendje dhe i marrin si statut.  
Dhe përnjëmend, kur punimi i hekurit, tregtia dhe  
zanatet e tjera të ngjashme me to nuk rroken nga  
pjesa më e madhe e njerëzve përveçse nëpërmjet  
praktikave të përcuara nga paraardhësit e tyre, çfa-  
rë mund të thuhet në lidhje me këto gjurmime të  
fisme në të cilat udhëzohen vetëm ata të cilëve u  
është dhënë sukses prej Zotit? Në këtë temë, është  
e domosdoshme që të kuptohet nevoja për pejga-  
mberët, dhe nevoja për të ndjekur praktikat e tyre  
dhe për të studiuar hadithet e tyre, dhe Zoti e  
di më së miri.

Ndarjet ndërmjet njerëzve në mëny-  
rën se si ata e arrijnë këtë lumturi

Ti duhet ta dish se kjo (më e  
larta) lumturi arrihet në dy më-  
nyra.

1) Njëra prej tyre i përngjan  
flakjes tutje të natyrës kaf-  
shërore, dhe kjo bëhet duke  
i qëndruar besnik stratagje-  
mave që bëjnë të mundur  
një pezullim të ligjeve të na-  
tyrës, një shuarje të nxehtë-  
sisë së saj, një fikje të flakës  
së shkencave dhe konditave të  
saj. Kjo kryhet duke duke iu  
kthyer me një vëmendje të plotë  
asaj që shtrihet përtej Xheberutit,  
me nefsën që pranon dijen që është  
krejtësisht e ndarë nga hapësira dhe  
koha dhe kënaqësinë që është e ndry-  
shme nga kënaqësitë e njohura në çdo  
mënyrë tjetër, derisa fryma nuk mplekset më  
me njerëz të tjerë, dhe as nuk dëshiron atë që ata  
dëshirojnë, dhe as nuk i frikësohet asaj së cilës ata  
iu frikësohen, sepse njeriu e gjen veten në një vis  
të largët dhe në një vend që është në një distancë  
të madhe prej tyre.

Kjo është lumturia që gjakojnë teozofët<sup>5</sup> në gjirin  
e filozofëve dhe mexhdhubët<sup>6</sup> në gjirin e sufive.  
Shumë syresh arrijnë kreshtën më të lartë të ma-

5. Mute'al-lihun” – ata filozofë si Ishraki-të të cilët ndjekin filozofinë  
iluminacioniste të Shihabuddin Suhravardit (vd. 1191) apo Vuxhudi-të të  
cilët ndjekin doktrinën e Unitetit të Qenies të Ibn Arabiut (vd., 1240).

6. Mexhdhub-ët janë sufijnj të cilët “tërhiqen apo joshen” në mënyrë  
të pakontrollueshme nga prania Hyjnore.



jës së saj dhe pjesës tjetër nuk i ngelet vetëm se të gjakojë me zjarr për të me vështrimet e tyre të ngulitura mbi të, me shikimet e tyre që aspirojnë për të, duke u kapur fort pas imitimit formal të qëndrimeve të saj.

2) E dyta (e këtyre mënyrave për të arritur lumturinë) është në linjën e të reformuarit të anës kafshërore dhe të korrigjuarit të devijimit të saj ndër-kohë që ruhet lidhja me natyrën e saj thelbësore. Kjo kryhet kur një njeri orvatet që ta shtrëngojë kafshëroren që të imitojë veprat, qëndrimet, kujtimet, etj..., të nefsit racionale. Për shembull, teksa memeci përpiqet që njerëzve t'u përçojë ligjërim me anë të gjesteve të tij, dhe ai i cili po portretizon gjendjet psikologjike të frikës dhe turpit (imiton) duke përdorur gjeste të dukshme të bashkëlidhura me këto gjendje; dhe sikurse gruaja që ka humbur një fëmijë e shpreh brengën e saj me fjalë dhe vajtime të cilat kushdo që i dëgjon do të hidhërohet, edhe pa i dalë përpara imazhi i pikëllimit.

Duke qenë se rregullimi hyjnor në botë bazohehet mbi zgjedhjen e asaj çka është përherë më e afërt dhe më e thjeshtë, dhe shqetësimi është për përmirësimin e atyre që ndjekin të njëjtin kurs, si tërësia e individëve të llojit dhe jo ata që janë të jashtëzakonshëm dhe të veçantë, dhe interesat më të mira të të dyja botëve rregullohen si për të mos trazuar rendin e asgjëje tek to; nuri dhe rahmeti i Zotit lypte që Ai të dërgonte fillimisht pejgamberët dhe në thelb të përcaktonte qartë mënyrën e dytë; ta thërrite dhe të nxiste njerëzit për tek ajo. Mënyra e parë tregohet nëpërmjet aluzioneve dhe imitimeve të nënkuptuara dhe në asgjë tjetër, dhe "Zoti ka argumentin bindës."<sup>7</sup>

Shtjellimi i imtësishëm i kësaj është se mënyra e parë e të arriturit të lumturisë shfaqet vetëm ndër njerëzit që kanë një konflikt të fortë të dy anëve (texhadhub)<sup>8</sup> dhe këta janë të paktë; si dhe nëpërmjet kryerjes së ushtrimeve të ashpra fetare dhe nëpërmjet të pasurit të një shkëputjeje të fortë (nga dynjaja), por ama pakkush e bën këtë. Modelet e tyre janë një grup njerëzish të cilët i lënë pas dore mjetet e tyre të jetesës, dhe për të cilët bota nuk ka rëndësi. Kjo mënyrë e parë arrihet vetëm nëpërmjet përgatitjeve të avancuara të një grupi punëdrejtë nga (udha) e dytë.<sup>9</sup> Ky grup (i anëve reciprokisht konfliktuese) nuk mund të shmangë shpërfilljen e

7. Kuran 6:149.

8. Domethënë, një tërheqje në drejtimet e kundërta të anës ëngjëllore dhe asaj kafshërore.

9. Domethënë, pejgamberët pararendin asketët, apo zahidët.

njerës prej dy lumturive; ose përmirësimin e mbështetjeve të qytetrërimit në këtë botë ose reformimin e nefsit më të ulët për amëshimin. Kësisoj, në qoftë se pjesa më e madhe e njerëzve do të ndiqnin mënyrën e parë, bota do të përfundonte në rrënoja, dhe në qoftë se ajo do t'u imponohej atyre, ky do të ishte imponimi i një gjëje të pamundur, duke qenë se mbështetjet e civilizimit janë bërë një natyrë e dytë për njerëzinë.

Modelet e mënyrës së dytë janë njerëzit të cilët janë të udhëzuar (mufehhemun)<sup>10</sup> dhe ata janë reformatorët të cilët, në të njëjtën kohë, marrin përsipër punët e fesë dhe të botës. Thirrja e tyre pranohet dhe precedentët e tyre pasohen, dhe brenda tyre është përsosuria e atyre të cilët qenë të pajisur me integrim të brendshëm (el-mustalihin) prej "Atyre që Shkëlqejnë në punë të mira" (sabikun), dhe Njerëzit e Krahut të Djabatit (anës së drejtë) (as'hab el-jemin), dhe këta janë pjesa më e madhe e njerëzve.<sup>11</sup> Personi inteligjent, ai i marrë, ai i zënë me punë, apo ai që rri kot është i aftë që të ndjekë këtë mënyrë të dytë, dhe në të nuk ka asnjë mundim. Kjo mënyrë është e mjaftueshme për robin e Zotit në ndreqjen e nefsit së tij më të ulët dhe në parandalimin e daljes së saj nga udha, dhe në të mbrojturit e tij nga mundimet e frikshme të Amëshimit, duke qenë se çdo nefsi ka veprime ëngjëllore prania e të cilave e bën atë të lumtur, apo mungesa e të cilave bën që ajo të vuajë në dhimbje. Sa i përket parimit të zhveshjes (së anës kafshërore), përtëritjet e varrit dhe ringjallja do të ndodhin në frymë në mënyrë të atillë sa që personi nuk e kupton natyrën e tyre, madje edhe mbas njëfarë kohe. Poezia (e thotë qartë):

Koha do të tregojë atë për të cilën s'pate dije,

Dikush do të japë lajme, pa i dhënë kurrfarë porosie.<sup>12</sup>

Përmbledhtazi, të kuptuarit e aspekteve të së mirës, dhe të depërtuarit thellësisht në to, është në rrafshin e të pamundurës për pjesën më të madhe të njerëzve, dhe injoranca e thjeshtë nuk është e dëmshme, dhe Zoti e di më së miri.<sup>13</sup>

10. Ata udhëzohen nga Zoti dhe ëngjëjt, për hollësi të mëtejshme të këtij koncepti, referoju Kapitullit të 55-së.

11. Sipas Shah Valiullahut, ata të krahut të djathtë (a'shab el-jemin), Kuran 56:27, janë njerëz të cilët i marrin format, por jo shpirtërat e gjërave, duke qenë se si ana e tyre ëngjëllore ashtu dhe ajo kafshërore janë të dobëta. Ky tip i personave diskutohen në Kapitullin e 69-të të kësaj vepre.

12. Vargje nga poeti para-islam, Tarafah ibn el-Abdi, vd. Rreth. 564 e.s. Autor i një Mua'al-laka ku këto rreshta janë janë vargjet e fundit. Sherh Divan Tarafah ibn el-Abd (Bejrut: Dar Mektebe el-Hajat, 1983), 28.

13. <https://erasmusi.org/2021/04/14/lumturia-njerezore>.

# UNIVERSALIZMI I ISLAMIT DHE ÇËSHTJA E AKTUALIZIMIT

— Mustafa Karabaxhak —

**“Kush kërkon tjetër  
fe përveç Islamit,  
nuk do t’i pranohet  
dhe ai në botën tjetër  
do të jetë i humbur.”**

(Al Imran, 85)

Prej universalizmit të Islamit kuptohet cilësia e tij që u flet të gjithë shekujve dhe i plotëson nevojat e kohës. Me të vërtetë, a është Islami një fe që u flet të gjitha periudhave dhe që i plotëson nevojat e kohës? “Po”, këtë mund ta themi lehtësisht. Para së gjithash, poseduesi i kësaj feje është poseduesi i botëve, domethënë edhe i kësaj bote, edhe i ditës së fesë (botës tjetër). Në suren e parë të Kuranit që e këndojmë përgjatë çdo namazi, pra në suren Fatiha, Zoti (xh.xh.), shprehet: **“Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, Sunduesit të Ditës së Gjykit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Udhëzoni në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!”** (Fatiha, 1-7)

Zoti i botëve i Cili është Zoti ynë, ia ka vendosur vetë emrin fesë së fundit që ka dërguar dhe na ka njoftuar se vetëm prej saj do të jetë i kënaqur duke u shprehur: **“Feja e vërtetë te Allahu është Islami.”** (Al Imran, 19) **“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.”** (Al Imran, 85)

Universalizmi i Kuranit Fisnik i cili është libri i Islamit

Zoti i Lartësuar na njofton se Librin (Kuranin Fisnik) e ka dërguar si udhërrëfyes dhe udhëzues për të gjithë njerëzit: **“...Kurani është zbritur si udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)...”** (Bekare, 185) **“...Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët.”** (Nahl, 89)

Në librin e lartë të Islamit, Kuranin Fisnik ka tri llo-

je thirrjesh. E para është thirrja që fillon në formën: “O njerëz!” Kjo thirrje u drejtohet të gjithë njerëzve qofshin burra apo qofshin gra. Në këto ajete Allahu Teala i fton njerëzit për t’i besuar njësimi të Tij dhe atyre që ka sjellë pejgamberi i fundit. Kuptimi i disa ajeteve të këtij lloji është si më poshtë: **“O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni** (ta shpëtoni veten nga ndëshkimi i Allahut).” (Bekare, 21) **“O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kurani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.”** (Junus, 57)

Lloji i dytë është thirrja që fillon në formën: “O ju që keni besuar!” Këto lloje ajetesesh flasin rreth përgjegjësisë që duhet t’i kryejnë njerëzit që kanë besuar. Kuptimi i disa ajeteve të këtij lloji është siç vijon: **“O ju që keni besuar! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit) në të cilën nuk ka shit-blerje, as miqësi, as ndërmjetësi! Jobesimtarët janë keqbërësit e vërtetë.”** (Bekare, 254) **“O ju që keni besuar! Mos zgjidhni për miq dhe këshilltarë të afërt njerëz të tjerë jashtë gjirit tuaj; ata nuk ngurrojnë që t’ju bëjnë dëm. Ata dëshirojnë që të vuani. Urrejtja shfaqet në gjithçka që del prej gojës së tyre, kurse ajo që fshehin në zemrën e tyre, është edhe më e madhe...”** (Al Imran, 118)

Lloji i tretë është thirrja që përbëhet nga ajetet të cilat u drejtohen atyre që nuk besojnë (çifutëve, të krishterëve, politeistëve dhe hipokritëve). Kuptimi i disa ajeteve të këtij lloji është siç vijon: **“Thuaj (o i Dërguar): “O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!..”** (Al Imran, 64) **“O ithtarë të Librit! Përse i mohoni shpalljet e Allahut (Kuranin), edhe pse jeni dëshmitarë se ato janë të vërteta?”** (Al Imran, 70) Këto thirrje nuk janë për një popull të caktuar apo për një shoqëri të caktuar. Përderisa të vazhdojë jeta në këtë rruzull tokësor, është e pamundur të gjendet një grup tjetër përveç këtyre tri grupe njerëzish. Kështu që thirrja hyjnore u drejtohet njerëzve në tri mënyrë të cilat janë: Thirrja e përgjithshme, thirrja për besimtarët dhe thirrja për jobesimtarët.


Pejgamberi i Islamit është dërguar si mëshirë për botët. Profecia ka filluar me Ademin (a.s.), i cili ishte njeriu i parë dhe pejgamberi i parë. Pastaj profecia është mbyllur me Hz. Muhamedin (s.a.s.). Kurani Fisnik flet për emrat e disa popujve që u ishin dërguar pejgamberë. Kurani në përgjithësi nuk



flet nëse ishin të mëdhenj apo të vegjël popujt që iu dërguan pejgamberë. Vetëm jepet informacion në lidhje me çështjen e madhësisë së popullit ku ishte dërguar Junusi (a.s.). (Shik. Saffat, 142-147) Edhe Hz. Musai dhe Hz. Isai, të cilët ishin prej pejgamberëve të mëdhenj, ishin dërguar te një popull i caktuar, domethënë te bijtë e Izraelit. (Al Imran, 45-49; veçanërisht shik. Saf, 6; Al Imran, 50; Maide, 46.)

Hallka e fundit e pejgamberëve që ka dërguar Allahu Teala është Hz. Muhamedi (s.a.s.). Në ajetin fisnik thuhet: **“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve; Allahu është i Gjithë-dijshëm për çdo gjë.”** (Ahzab, 40) Pejgamberi i fundit, Hz. Muhamedi (s.a.s.), është dërguar për të gjithë njerëzimin: **“(O Pejgamber!) Ne të kemi dërguar ty vetëm si mëshirë për botët.”** (Enbija, 107) **“Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë.”** (Sebe, 28)

Zoti (xh.xh.), u drejtohet pejgamberëve dhe u kërkon që t’u thonë njerëzve se u janë dërguar si pejgamberë atyre: **“Thuaj (o Muhamed!): “O njerëz, unë jam për ju vetëm paralajmërues i qartë.”** (Haxh, 49) **“Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij**



***që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës..."*** (A'raf, 158) ***"O njerëz! Me të vërtetë, juve ju ka ardhur një provë bindëse (Muhamedi a.s.) nga Zoti juaj dhe ju është zbritur një Dritë e dukshme (Kurani)."*** (Nisa, 174)

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, në një hadith fisnik na njofton se ndërkohë që peygamberët e tjera kanë qenë të dërguar te një popull i caktuar, ai vetë është dërguar për të gjithë njerëzimin: "Unë jam dërguar jo te një popull i vetëm, por te i gjithë njerëzimi. Profecia është mbyllur me mua dhe unë jam peygamberi i fundit." (Muslim, Mesaxhid, 5; Tirmidhi, Sijer, 5.)

Çështja e aktualizimit

Islami është feja e fundit dhe universale. Tashmë nuk do të vijë më ndonjë fe e re për njerëzimin. Edhe parimet e Islamit janë universale. Ajetet dhe hadithet që ndryshe i quajmë nass (tekste hyjnore e profetike), nuk ndryshojnë. Por me kalimin e kohës, tekstet mund të kenë nevojë për t'u komentuar siç edhe janë komentuar kundrejt disa problemeve të reja. Në kushtetutën osmane, Mexhel-le ky rregull është shprehur kështu: "Ndryshimi i dispozitave me ndryshimin e kohës është i pamohueshëm." (Neni 39) Domethënë, kur ndryshon koha, nuk mund të mohohet se duhet të ndryshojnë edhe dispozitat. Edhe shprehja: "Dera e ixhtihadit është mbyllur.", për të cilën mendojmë se është thënë për një kohë

të caktuar, është një ixhtihad. Siç duket, kjo fjalë mund të jetë thënë me pretekstin se myslimanët nuk kanë edukuar dot njerëz të aftë për ixhtihad në një kohë të caktuar. Mbi të gjitha, myslimanët kanë nevojë për muxhtehidë të cilët mund ta mbajnë fenë në këmbë gjithmonë dhe mund ta komentojnë atë. Kjo është një domosdoshmëri fetare. Zoti (xh.xh.), thotë: ***"Nuk është mirë që besimtarët të shkojnë në luftë të gjithë njëherësh, por prej çdo bashkësie, një grup të mbetet mbrapa, që të thellohet në mësimin e fesë dhe kështu të këshillojë popullin e vet, mbasi të kthehet nga lufta, që t'i frikësohet Allahut."*** (Teube, 122)

Ne i quajmë ixhtihad interpretimet që muxhtehidi i nxjerr nga ajetet dhe hadithet. Dera e ixhtihadit gjithmonë është e hapur për njerëzit specialistë të asaj fushe. Vetëm se këto interpretime mund të ndryshojnë sipas kohës dhe nuk bëhet fjalë që ato të kenë shenjtëri. Kur e themi këtë, sigurisht se temat e besimit bazë dhe të ibadetit janë jashtë kësaj. Nëse e shohim me kujdes, do të vëmë re se Kurani nuk ka hyrë në detaje, por ka dhënë vetëm dispozita të përgjithshme në çështjet e tjera të fesë siç janë muamelatet (shitblerja) dhe ukubatet (jurisprudenca). Andaj ka shumë pak tema në detajet e të cilave ka hyrë Kurani. Njëra prej këtyre temave është çështja e martesës, divorcit dhe trashëgimisë. Nëse parashtrrohet pyetja se përse ka hyrë në detaje te këto tema, përgjigja mund të jepet e tillë: Së pari këto dy tema janë prej çështjeve që njerëzit dhe popujt i shfrytëzojnë dhe i keqpërdorin. Andaj një çështje kaq të rëndësishme Allahu Teala nuk na e ka lënë neve, por e ka shpjeguar pikërisht Vetë.

Universalizmi i Islamit është i fshehur në faktin që nuk hyn në detaje në ndonjë vend. Siç dihet, kushtetutat nuk hyjnë në detaje. Nëse një kushtetutë hyn në detaje, shpesh herë do të lindë nevoja për ta ndryshuar kur të mos u japë dot përgjigje problemeve të reja që dalin me ndryshimin e kohës. Por diçka e tillë nuk mund të bëhet fjalë për Kuranin Fisnik.

Si përfundim, Kurani i cili është libri bazë i Islamit dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), i cili është shpjegimi i tij, kanë hyrë në detaje te çështjet themelore të besimit dhe ibadetit. Në fakt te këto çështje nuk bëhet ixhtihad, sepse tekstet janë të qarta. Këto dy burime, domethënë Kurani dhe Suneti, nuk ka hyrë në detaje te çështjet si jurisprudenca, shitblerja, administrimi, etj. Kështu që muxhtehidët bëjnë interpretime sipas nevojës së kohës duke u nisur nga parimet themelore.



# MODELI I AISHES DHE UMMU SHERIK NË PREDIKIMIN E ISLAMIT

— Shefika Kaja Meriç —

Ebu Musa, (r.a.), tregon:

“Kur ne sahabëve të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), na shfaqej ndonjë problem në lidhje me ndonjë hadith, menjëherë pyesnim Aishen. Ajo patjetër na jepte të dhëna mbi atë çështje.” (Tirmidhi, Menakib, 3877.)

Një nga detyrat më të rëndësishme që Allahu i ka vënë besimtarit në ndërtimin e njeriut në Islam, është edhe predikimi. Predikimi është të shprehurit e Islamit nga besimtari me anë të gjendjes, qëndrimit, pasurisë dhe gjuhës në çdo kohë dhe në çdo vend; po ashtu është të njoftuarit e njerëzve mbi ndjeshmërinë e Islamit.

Islami kërkon nga besimtarët të jetojnë një jetë me vetëdije dhe nder. Rruga e fitimit të këtij nderi kalon nga shprehja Kuranore **“emr-i bi'l-ma'ruf, nehy-i ani'l-munker”**, pra urdhërimi për mirë dhe ndalimi nga e keqja.

Ashtu si dija që është farz për çdo mysliman qoftë burrë apo grua, edhe predikimi është farz për çdo mysliman. Të gjithë burrat dhe gratë myslimane janë përgjegjës për transmetimin e Islamit edhe te brezat e ardhshëm. Ajetet Kuranore me përmbajtje predikimin që Allahu Teala i dërgoi Pejgamberit, (a.s.), në të njëjtën kohë janë një thirrje edhe për ne.

Disa nga këto ajete fisnike janë në këtë mënyrë:

**“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.”** (Maide, 67)

**“Unë kam për detyrë veç t'ju përcjell atë që më vjen nga Allahu dhe mesazhet e Tij. Këdo që s'dëgjon Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e pret zjarri i Xhehenemit në të cilin do të mbetet përgjithmonë.”** (Xhinn, 23)

**“Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit! Kujdes! Nëse nuk ia vini veshin, ta dini se i Dër-**

**guari ka për detyrë vetëm të përçojë shpalljen e qartë.”** (Maide, 92)

Aq sa merrnin detyra burrat sahabë përreth të Dërguarit të Allahut, (a.s.), për të predikuar Islam, po aq merrnin edhe gratë sahabe. Secila prej tyre pothuajse garonte me të tjerat për të mësuar e përhapur ajetet fisnike të reja që zbrisnin nga Allahu Teala dhe hadithet e të Dërguarit të Allahut, alejhisselam.

Veçanërisht bashkëshortet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ndanin me njerëzit çdo çështje që shikonin, dëgjonin dhe mësonin nga Ai (a.s.), duke filluar nga gjendjet e veçanta të Tij e deri te dispozitat më të përgjithshme të Islamit. Aishja, (r.a.), kishte një vend shumë të veçantë ndërmjet tyre. Ajo u edukua në mënyrë të veçantë nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), ngaqë ishte më e reja prej bashkëshorteve të Tij dhe ngaqë ishte kureshtare dhe e aftë për dijen. Aishja, (r.a.), pothuajse ishte “nëna mësuese” e të gjithë umetit burra-gra kur i Dërguari i Allahut, alejhisselam, ishte gjallë, por edhe pas vdekjes së Tij.

Nëna jonë, Aishja është një nga shtatë personat që kanë transmetuar më shumë hadithe. Kjo e shpreh qartë rolin e saj në predikimin e Islamit.

Këto të dhëna, tani le t'i konkretizojmë pak më shumë me një/dy shembuj:

Në aktivitetin e predikimit të Islamit, ka dy zona sahabe që prijnë para të tjerave. Njëra është nëna jonë Aishja, (r.a.) dhe tjetra është Ummu Sherik, (r.a.). Këto dy zonja sahabe zënë vende të ndryshme si “predikuese” në jetën e veçantë të të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. Detyra që kryen ato në përhapjen e Islamit, përbën një rekord mësimdhënës për ne...

Krahas zgjuarsisë së madhe, aftësisë, intuitës dhe diturisë së nënës sonë Aishes, (r.a.), aktivitetet që realizoi për përhapjen e Islamit, janë kallauzë ndriçues në çështjen e predikimit të Islamit për myslimanët e sotëm. Bindja absolute që tregoi kundrejt ligjeve të Allahut Teala dhe ndaj

Pejgamberit, (a.s.), kur shfaqte këtë përpjekje të sinqertë në rrugën e Allahut, është një argument i qartë për bindjen që nëna jonë, Aishja, (r.a.), kishte ndaj Zotit (xh.xh.) dhe ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Edukimi që Aishja mori nga babai i saj Siddiki Ekber, Ebu Bekri, (r.a.), që në moshë të vogël dhe martesë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), u bënë shkak për zhvillimin, pjekjen dhe thellimin më të madh të saj në aspektin moral e shkencor. Nëna jonë Aishja, (r.a.), e cila u bë myslimane që në moshë shumë të vogël, në të njëjtën kohë u bë shembull për të gjithë myslimanët me modestinë, mjaftueshmërinë ndaj asaj që i kishte dhënë Zoti dhe bujarinë e saj. Për shkak të besimit të pastër dhe sinqeritetit, gjëja më e rëndësishme për të ishte veprimi në përputhje me kënaqësinë e Allahut të Madhëruar.

Pasi i Dërguari i Allahut, (a.s.), ndërroi jetë, shtëpia e nënës sonë Aishes u bë një qendër shkencore në të cilën vinin shumë njerëz të mëdhenj e të vegjël. Qoftë në çështjet që kanë të bëjnë me gratë apo qoftë me çështjet në lidhje me thellësitë juridike të haditheve dhe ajeteve fisnike, ajo u bë një burim i rëndësishëm dijeje nga e cila përfitonin edhe halifet si Umeri, (r.a.). Ngaqë ajo ishte njëra prej “nënave të besimtarëve”, të gjithë myslimanët burra/gra shkonin te ajo për të zgjidhur problemet dhe i pranonin pa asnjë hezitim mënyrat e zgjidhjeve që u ajo u jepte.

Aishja, (r.a.), që u interesua nga shumë afër me edukimin e grave duke filluar që në kohën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), me veten e saj dhe me nxënësit që edukoi, tregoi suksesin dhe rëndësinë e të preokupuarit me dije të grave në botën Islame.

Edhe Ummu Sherik, (r.a.), që e pranoi si detyrë predikimin e Islamit, ishte njëra prej grave sahabe që i udhëzoi gratë e Kurejshve duke shkuar shtëpi më shtëpi. Mushrikët (politeistët) u shqetësuan nga këto aktivitete të Ummu Sherik dhe së pari e kërcënuan.

Ata e lanë tre ditë pa ushqim dhe pa ujë në rërën e nxehtë të shkretëtirës, por edhe këto tortura, nuk ia shuan dot dashurinë për të predikuar fenë.

Ato ditë myslimanët patën filluar të shpërngulen për në Medinë fshehurazi me lejen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), sepse ishin lodhur nga torturat në Mekë. Edhe Ummu Sheriku, (r.a.), tashmë dëshironte të shpëtonte nga presionet e politeistëve Mekas dhe ta jetonte e përhapte më lehtë fenë e Allahut Teala. Ajo nuk gjeti asnjë që shkante në Medinë, për këtë arsye, u bashkua me një familje çifute. Si shpërblim i durimit dhe vendosmërisë që kishte në besim, arriti nderimin e veçantë të Allahut (xh.xh.). Ngjarja ndodhi kështu: Ummu

Sherikut, (r.a.), i mbaroi uji. Çifuti e përdori këtë rast dhe i tha se s’do t’i jepte ujë përderisa të mos kthehej nga feja e saj. Edhe gruan e tij e urdhëroi në mënyrë të prerë që të mos e bënte diçka të tillë.

Koha ishte shumë e nxehtë. Udhëtimi po kalonte me shumë vështirësi. Ummu Sherik, (r.a.), ishte këputur. Fuqia i ishte prerë për shkak të etjes. Ecte dhe fliste me vështirësi. Gjendja e dobët e saj i dha shpresë çifutit. Ai mendoi se kishte kapur çastin e duhur dhe pandehte se ajo nuk kishte zgjidhje tjetër përveçse të kthehej nga feja, por Ummu Sheriku kishte një besim shumë të fortë.

Në një gjysmë nate ku dukej sikur kishin mbaruar mundësitë materiale, arriti ndihma e veçantë e Allahut Teala. Në një moment kur të gjithë po flinin, Ummu Sherik ndjeu mbi krahë të saj sikur iu vendos ujë. Ajo piu nga ky ujë derisa u ngop. Mbi të gjithë lagu edhe kokën dhe u freskua. Pastaj u thirri shokëve të rrugës për t’i zgjuar. Nga zëri i saj i fuqishëm, kuptohej se ajo kishte gjetur ujë dhe kishte pirë.

Çifuti pandehte se ujin ia kishte dhënë gruaja e tij, për këtë arsye, iu nxeh, i bërtiti dhe i tha i zemëruar:

“Ti ia dhe ujin?”

Ummu Sherik, (r.a.), ndërhyri dhe i tha se kjo ishte një mrekulli nga Allahu Teala dhe se gruaja e tij nuk i kishte dhënë asnjë pikë ujë. Çifuti menjëherë shkoi te lëkurat e ujit. Ai u habit kur pa se ato ishin të lidhura.

Sinqeriteti dhe besimi i pastër i Ummu Sherikut, (r.a.), ndikoi shumë te ai. Fjalët e saj formuan një ngrohtësi në zemrën e tij. Zemra iu hap ndaj dritës së Islamit dhe tha:

“I besova Zotit tënd.”

Bashkë me familjen e tij u bënë myslimanë duke thënë shehadetin së bashku.

Të predikosh Islamit në kohët më të vështira dhe të paguash kundërvlerë për këtë, është një sakrificë që nuk mund ta bëjë çdo njeri. Nën at tona, Hatixhja, Fatimja, Aishja dhe gratë e tjera sahabije, zunë vend në historinë islame si heroina shpirtërore. Edhe sot, çdo grua besimtare, duhet të përpiqet për ta valëvitur flamurin e predikimit që ka marrë prej atyre. Për një njeri që në zemër ka këtë dashuri, nuk ka shumë rëndësi koha dhe vendi. Çdo vend dhe çdo kohë ku gjenden njerëz, është një mundësi për të përhapur fenë e Allahut Teala.

Allahu i Madhëruar mos na ndaftë nga shërbimi në rrugë të Tij! Zoti na tuboftë në Kiamet me robër prej të cilëve është i kënaqur dhe na bëftë prej atyre që marrin shembull prej sakrificave të Aishes dhe Ummu Sherikut! Amin!..



# KOMUNIKOJE MESAZHIN E ZOTIT

— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin fisnik: **“O profet, përcille atë që të është zbritur prej Zotit tënd dhe nëse ti nuk e bën këtë gjë, nuk e ke përcjellë amanetin e Zotit, nuk e ke çuar në vend fenë e Tij dhe dije, se Zoti të ruan ty nga e keqja e njerëzve”.**

Zoti i gjithësisë i krijoi vetë njerëzit e Tij po ashtu Ai i furnizon dhe i ruan vetë ata. Ndërsa kur erdhi puna tek çështja e besimit, Ai i kërkoi njerëzve që ta kërkojnë besimin, ta gjejnë atë e ta pranojnë sepse Zoti nuk deshë që njerëzit ta marrin besimin me imponim, por me dëshirë dhe vullnet. Për këtë mision kaq të lartë, për të arritur tek besimi në Zot, Allahu (xh.sh) zgjodhi njerëzit më të mirë. I bëri ata profetë dhe i dërgoi në tokë që të përcjellin mesazhin e Tij, ta çojnë në vend amanetin e Tij drejtuar mbarë njerëzimit. Ndaj rruga e këtyre profetëve nuk ka qenë aspak e lehtë. Dikush prej tyre u vra në këtë rrugë, dikush tjetër u hodh në zjarr, një tjetër u tentua të ekzekutohej, e një tjetër u bojkotua familjarisht, shumë të tjerë u ofenduan. Por profetët e Zotit i pranuan të gjitha këto, madje i pranoi vetë Zoti i gjithësisë. Por një gjë nuk u pranua kurrë: S`ka tolerim në mesazhin e Zotit, s`ka kompromis në kurriz të këtij mesazhi, se përndryshe këta njerëz nuk do të ishin profetë.

Shembulli më i mirë i këtyre njerëzve është profeti i fundit, Muhamedi (a.s). Kur njerëzit talleshin me të, talleshin me njeriun më të mirë që kishte krijuar

Zoti por ai nuk mërzitej nga kjo, ai thoshte: **“Vetëm më lini që t`iu flas njerëzve dhe pastaj njerëzit të vendosin çfarë të duan, ose të më ndjekin, ose të më mohojnë”.**

Kur njerëzit dashakeqë shkuan për të bërë pazare me të, duke i ofruar para e pushtet vetëm që të hiqte dorë nga besimi i tij apo kur i thanë: “Ne do ta adhurojmë Allahun një ditë, por edhe ti duhet të adhurosh zotat tanë një ditë tjetër”, Ai (a.s) ia ktheu: **“Ajo që më jepni është shumë pak. Beto hem në Zot, se sikur diellin të ma vendosin në dorën e djathtë dhe hënën në dorën e majtë, nuk do të heq dorë nga kjo fe, derisa Zoti ta çojë fenë e Tij në vend, ose unë të vdes në rrugën e kësaj feje”.**

Për këtë bindje dhe për këtë mesazh, Muhamedi (a.s) bashkë me familjen e tij dhe me të gjithë myslimanët u bojkotuan për tre vjet, duke qenë i detyruar të hajë gjetet e pemëve dhe lëkurat e kafshëve të ngordhura, por as ai dhe as shokët e tij nuk bënë pazare me fenë e Zotit.

Për këtë mesazh ai u dëbua nga Meka, iu keqtrajtoi shokët e tij. Për këtë mesazh ai luftoi dhe u plagos, madje edhe e helmuan, por para se të vdiste i mblodhi të gjithë myslimanët dhe u tha tre herë: **“O njerëz! A dëshmoni se unë ua kam përcjellë mesazhin e Zotit?”** Të gjithë myslimanët thanë njëzëri: “O profet i Zotit, dëshmojmë se ti e përcolle mesazhin e Zotit, ti e çove në vend amanetin e Tij, ti na këshillove e na le në rrugë të drejtë”.



Atëherë profeti (a.s) u kthye me kokën drejt qiellit dhe tha: **“O Zot dëshmo edhe Ti, se unë e përco-lla mesazhin Tënd”**. Prandaj ai (a.s) vdiq i pastër, faqebardhë e fisnik para Zotit.

Kjo është rruga e të gjithë profetëve. Kjo duhet të jetë rruga e të gjithë atyre që quhen dijetarë në fe, pasi Muhamedi (a.s) tha: **“Dijetarët janë trashëgimtarët e profetëve. Ata nuk kanë trashëguar as pushtet e as pasuri, por kanë trashëguar diturinë”**. Prandaj çdokush që fiton dituri dhe përcjell amanetin e Zotit, ka hise nga trashëgimia e profetëve. Kjo duhet të jetë detyra e të gjitha bashkësive islame dhe të gjithë përgjegjësve të fesë kudo qofshin në të katër anët e botës, se janë përgjegjës para Zotit dhe janë model për njerëzit e tjerë. Kjo duhet të jetë detyra e çdo myslimani, i cili pranon Allahun për Zot, Islamin për fe dhe Muhamedin (a.s) për profet. Prandaj ai duhet ta përcjellë atë dituri fetare që ka, sado e pakët qoftë ajo, pasi Muhamedi (a.s) tha: **“Transmetoni prej meje qoftë edhe një hadith”**.

Sot kur njerëzit luftojnë e punojnë natë e ditë për të bërë reklamat e kompanive të tyre, për të bërë propagandë për partitë e tyre, të ideve dhe filozofive të tyre, a nuk është turp që myslimanët, të cilët pretendojnë se janë shumicë në këtë vend, të mos punojnë për lartësimin e kësaj feje, për ta çuar në vend amanetin e Allahut (xh.sh).

Unë them me plot bindje, se të transmetosh sot mesazhin e Zotit është xhahadi më i madh që mund të bëjmë, është detyra më e shenjtë, është përgjegjësia më e madhe historike që kemi ndaj këtij populli, i cili është mbi 70% mysliman, ku shumë prej tyre nuk e dinë se çdo të thotë Zot, çdo të thotë Islam dhe çdo të thotë Muhamed. Kjo është detyra më e madhe dhe ne duhet të punojmë për këtë detyrë në të mirë e në të keq, kur na intereson dhe kur na prishen interesat personale. Ky është amaneti që na ka lënë Zoti dhe profeti (a.s).

Ky mision nuk është i lehtë. Dikush do të zemërohet, kur ti të insistosh në këtë mision, dikujt tjetër do t'i mbetet hatri, dikush tjetër mund të të quajë ekstremist dhe fundamentalist. Por ti mos u mërzit dhe mos ua bëj qejfin njerëzve duke zemëruar Zotin. Zoti ka shkruar se ai njeri që i bën qejfin njerëzve duke fituar zemërimin e Zotit, do të vijë një ditë që përveç zemërimit të Zotit do të fitojë edhe zemërimin e njerëzve. Ndërsa ai njeri që i bën qejfin Zotit edhe pse mund t'i mërzisë njerëzit, do të vijë një ditë që Zoti do të kënaqet me këtë person, por edhe njerëzit do të kënaqen me të.

Por duhet të dimë diçka të rëndësishme: transmetimi i këtij mesazhi nuk bëhet me dhunë, me forcë apo me vrazhdësi, por bëhet me butësi sepse e buta e fut fjalën në zemër, kurse dhuna nuk arrin kurrë ta fusë fenë në zemrën e njeriut.

Zoti na bëftë prej atyre që e çojnë në vend amanetin e Zotit dhe vdesin faqebardhë përpara Zotit, pastaj Zoti e di se kujt i hyn besimi në zemër dhe kush e refuzon atë.

Mos harroni se feja nuk është e jona, por është e Zotit dhe transmetimi i kësaj feje ashtu siç e ka zbritur Zoti është amanet përpara Tij. Prandaj Zoti do ta pyesë çdo njeri për këtë amanet. Kur njerëzit të merren në llogari, Zoti nuk do t'i pyesë: “Çfarë bëtë ju për fisin tuaj, çfarë bëtë ju për partinë tuaj, çfarë bëtë ju për xhematin tuaj”, por do t'u thotë: “Çfarë bëtë ju për amanetin Tim, Çfarë bëtë ju për fenë Time”? Jo vetëm hoxhallarët, jo vetëm besimtarët apo bashkësitë islame që aktivizohen në përhapjen e fesë së Zotit, por të gjithë do të pyeten për këtë amanet të Zotit.

Ditën e Kiametit, Allahu do t'i pyesë profetët: “Po ju a e çuat në vend amanetin Tim”? Në fakt Zoti e di më së miri se kush e ka çuar në vend amanetin, por kërkon t'iu tregojë të gjithëve se sa i shenjtë ka qenë amaneti i Zotit.

Ditën e Kiametit, Allahu do ta pyesë profetin Isa (a.s): “O Isa! A ti u ke thënë njerëzve, që të të adhurojnë ty dhe nënën tënde si zota përveç Meje”? Atëherë Isai (a.s) përgjigjet: “I lartësuar qofsh Ti o Zot. Ti di çka brenda zemrës sime, ndërsa unë nuk e di se çka brenda Teje. Ti e di fare mirë se çfarë u kam thënë unë atyre. Sa kam qenë gjallë, Ti më ke parë dhe më ke vëzhguar, ndërsa pasi Ti më more, Ti e di më mirë se çfarë kanë bërë njerëzit”. Pas kësaj Isai (a.s) i lutet Zotit që të ketë mëshirë për njerëzit.

Ai njeri që ka tradhtuar këtë amanet dhe këtë mesazh, le ta dijë se nuk ka qenë dijetar, por ka qenë matrapaz dhe fundi i tij do të jetë shumë i hidhur. Zoti thotë në Kuran për këtë fund të hidhur: **“Ata që kanë fshehur atë që Unë kam zbritur, e kanë ndryshuar atë, pasi ua kam sqaruar njerëzve nëpër libra, ta dinë se ata i mallkon Zoti dhe të gjithë njerëzit”**.

Ndërsa për dijetarët, Zoti thotë në Kuran: **“Ata që përcjellin mesazhet e Zotit, kanë frikë vetëm Zotin e askënd tjetër veç Tij, ata e dinë mirë, se i vetmi llogaritës është Allahu”**.

E lus Zotin me gjithë zemër, që Ai të na ndihmojë neve, dijetarët myslimanë, përgjegjësit e fesë në këtë vend dhe në gjithë botën që ta çojmë në vend amanetin e Tij. Dijeni se është më mirë të thuash: “Unë e di por nuk e bëj dot”, sesa ta fshehësh të vërtetën e të mos ua tregosh njerëzve. Zoti na ruajt nga neglizhenca dhe nga devijimi. Zoti na ruajt nga zemërimi i Tij. Zoti na ruajt nga përçarjet dhe trazirat e dukshme dhe të padukshme. Zoti na bëftë shkak, që njerëzit të udhëzohen në rrugën e drejtë. Amin!..



# PRODUKTI

## QË TË JEP ENERGJI NË MËNGJES

### *më shumë se sa kafja*

Kafeina që gjendet tek kafeja ofron një alternativë më të mirë zgjimi se fruktoza që gjendet tek molla.

Megjithatë, ekspertët thonë se secila prej këtyre alternativave ofron përfitime disi të komplikuar.

Për shembull, nëse ju kryeni aktivitet fizik që në mëngjes, molla do të ishte alterantiva e duhur sepse i jep organizmit energjinë e nevojshme.

Nëse hani mollë çdo ditë, ekspertët thonë se frymëmarrja juaj do të përmirësohet.

Nga ana tjetër, pirja e kafesë përpara aktivitetit fizik do të nxisë djegien e yndyrnave.

#### KAFEINA

Kur trupi është në gjumë, temperatura e tij bie bashkë me tensionin e gjakut dhe kjo është arsyeja përse njeriu është i plogësht kur zgjohet.

Kafeina ndihmon në eliminimin e plogështisë së mëngjesit, rrit rrahjet e zemrës, tensionin e gjakut dhe përshpejton frymëmarrjen.

Ajo të bën më të vëmendshëm dhe zmadhon ndjesinë e mirëqenies.

#### KARBOHIDRATET

Molla nga ana tjetër nuk përmban kafeinë por është e pasur me karbohidrate, të cilat japin energji për një zgjim dhe gjallërim të nevojshëm.

Një mollë ofron 116 kalori dhe gjysma e 10 gramëve sheqerna përbëhet nga glukoza dhe sukroza.

Fruktoza nga ana tjetër kërkon më shumë kohë për tu tretur dhe ky aspekt e bën mollën një burim energjie për një periudhë më të gjatë se kafeinaa.

Fibra e tretshme te molla ju mban të ngopur për më gjatë.

#### NDIKIMET AFATGJATË

Si kafeja ashtu edhe molla përmbajnë antioksidantë të cilët kur konsumohen në mënyrë afatgjatë ofrojnë shumë përfitime.

Nëse pini deri në 6 filxhanë kafe në ditë, rreziku i diabetit dhe sëmundjeve kardiovaskulare ulet ndërsa ai i kancerit të mëlçisë përgjysmohet.

Molla përmban gjithashtu shumë antioksidantë.

Nëse hani më shumë se dy mollë në javë, rreziku i azmës do të ulet.

Konsumi i mollës përmirëson funksionin e mushkërive duke ju mbrojtur nga kanceri dhe sëmundje të tjera.

Nëse hani pesë ose më shumë mollë çdo javë, kapaciteti i mbajtjes së ajrit të mushkërive do të rritet ndjeshëm.

# SI TË PËRDORNI KOSIN

## *për pastrimin rrënjësor të fytyrës*

Kosi nuk është vetëm një produkt i shijshëm dhe plot me vlera për t'u konsumuar kurdoherë.

Janë pikërisht këto vlera të cilat përmirësojnë shëndetin e lëkurës nëse e përdorni si një maskë.

Pa nevojë për t'i shtuar asnjë përbërës tjetër, kosi kthehet në maskën më ekonomike por me përfitime të mrekullueshme.

### **MINERALET DHE VITAMINAT QË GJENDEN TEK KOSI**

Ka një arsye përse kosi i jep lëkurës së fytyrës një rigjallërim dhe shkëlqim të menjëhershëm.

Janë pikërisht këta katër përbërës, të cilët ndikojnë në shëndetin e lëkurës.

Zinku, i njohur për vlerat e tij anti-inflamatore, nxit rigjenerimin e qelizave të lëkurës si dhe balancon gjëndrat yndyrore që shkaktojnë krijimin e akneve.

Të gjithë e dimë që kosi përmban kalcium, ky mineral është përgjegjës për hidratimin dhe parandalimin e përtharjes së lëkurës.

Vitaminat B nga ana tjetër, bëjnë të mundur mbrojtjen e qelizave të lëkurës nga radikalët e lirë, si dhe nxisin prodhimin e yndyrnave të shëndetshme.

Acidi laktik është një nga përbërësit kryesor të kosit, dhe gjendet në shumicën e produkteve të lëkurës.

Ai funksionon si një agjent kundër rrudhave dhe plakjes së lëkurës.

Por veprimi kryesor i këtij acidi është parandalimi i prodhimit të enzimës tirozinazë, e cila nxit prodhimin e melaninës.

Kështu lëkura juaj do të jetë më e bardhë dhe e pastër.

### **SI TË PËRDORNI KOSIN PËR LËKURËN**

Mjafton që në një filxhan kafeje të hidhni 2-3 lugë çaji me kos dhe të përzieni derisa të formohet një masë e plotë.

Më pas vendoseni në fytyrë duke treguar kujdes që të mbulonit të gjitha zonat problematike, si dhe qafën.

Ndërkohë që lyeni fytyrën dhe ta masazhoni atë me lëvizje rrethore, për të nxitur dhe qarkullimin e gjakut.

Kosi do të fillojë të ngurtësohet pas 5 minutash, duke krijuar një maskë të mirëfilltë.

Lëreni përreth 15 minuta dhe më pas mjafton të njomni pak duart me ujë dhe përsëri ta fërkoni fytyrën derisa shtresa e kosit të thërrmohet.

Kështu ju largoni qelizat e vdekura dhe papastërtitë që janë akumuluar në poret e lëkurës gjatë ditës.

Kosi përmban baktere të cilat luftojnë që të gjitha papastërtitë e mbledhura në lëkurë nga kontakti i saj me faktorët e jashtëm.

Por gjithashtu ju do të parandaloni krijimin e akneve si rezultat i infektimit të poreve nga papastërtitë.

Më pas shpëlajeni lëkurën me ujë të bollshëm dhe fshiheni lehtë me peshqir.

Nëse keni fytyrë të ndjeshme, AgroWeb.org ju sugjeron që thjesht ta shpëlani fytyrën me ujë të bollshëm.

### **SA SHPESH DUHET TA PËRDORNI KOSIN PËR LËKURËN E FYTYRËS**

Për personat me lëkurë të yndyrshme është e këshillueshme që të përdoret çdo ditë për të patur rezultat.

Ndërsa ata që kanë lëkurë të thatë, mund ta përdorin dy apo tri herë në javë.



## ZBULIMI REVOLUCIONAR I SHKENCËTARËVE, BURRIT TË VERBËR I KTHEHET PJSËRISHT SHIKIMI

Një burrë nga Franca i cili ka qenë i verbër për shkak të gjendjes së tij gjenetike “retinitis pigmentosa”, i është kthyer pjesërisht shikimi me ndihmën e proteinave të ndjeshme në ndriçim që fillimisht ishin zbuluar tek algat.

Siç raporton BBC, shkencëtarët erdhën deri te ky zbulim që do të mund t’ia lehtësonte jetën miliona njerëzve në mbarë botën – e burrit plotësisht të verbër i është kthyer pjesërisht shikimi pas iu nënshtua terapisë me proteina që fillimisht u zbuluan tek algat, transmeton Telegrafi.

Terapia biologjike e njohur si optogjenetika, është një proces i veçantë ku proteinat përdoren për t’ia kthyer organizimit kontrollin mbi qelizat në pjesën e pasme të syrit.

Duke u thirrur në revistën Nature Medicine,

burri plotësisht i verbër e kuptoi se terapia pati sukses ku pa “zebrën” me vija në vendkalimin për këmbësorë.

Tani ky burrë nga Franca, identiteti i të cilit nuk është zbuluar – mund të njeh, numëroj dhe të kap objekte të ndryshme nga tavolina.

Francezi për 40 vite vuan nga sëmundja trashëguese retinitis pigmentosa” që dëmton të pamurit dhe lodh qelizat e ndjeshme ndaj pamjeve.

E me këtë problem është duke u ballafaquar një numër i madh i njerëzve nëpër botë – ku deri më tani janë regjistruar mbi dy milionë.

Burri me sëmundjen shumë të rrallë që jeton në Bretani dhe që u operua në Paris, ka qenë plotësisht i verbër për 20 vite.

## CURIOSITY I NASA-S KAP RE TË ÇUDITSHME NË MARS

dhe pse fotot e fundit të dërguara nga Curiosity në planetin vendas të kujtojnë kartolinat nga Toka, është diçka shumë më ekzotike: retë nga Marsi.

Imazhi përfundimtar u krijua duke kombin-

uar 21 fotografi, të cilat u morën për të parë nga afër retë e pazakonta mbi zonën e Kraterit Gale.

Dy vjet më parë, shkencëtarët zbuluan se retë u formuan në Mars më herët sesa pritej,

kështu që këtë vit Curiosity iu dha detyra për t'i "vëzhguar" ato.

Retë e para u shfaqën në janar, me vija dhe të pasura me akull, ndonjëherë duke ndryshuar ngjyra ndryshe nga të afërmit e tyre në Tokë.

Retë marsiane ndryshuan kështu nga hije të kuqe në jeshile, pastaj blu dhe rozë. Këto re janë të vendosura në pjesë më të larta të atmosferës sesa ato të vëzhguara deri më tani. Ato dyshohet se përmbajnë dyoksid karboni të ngrirë ose të ashtuquajturin "akull të thatë", megjithëse shkencëtarët nuk kanë qenë ende në gjendje ta konfirmojnë. Ato janë më të bukurat menjëherë pas perëndimit të diellit, kur kristalet e akullit shkëlqen në dritën e fundit.

Shkencëtarët kërkojnë të dhëna delikate për të vendosur lartësinë e një reje, dhe do të duhen më shumë analiza për të thënë me siguri se cilat nga imazhet e fundit të Curiosity tregojnë retë me akull uji dhe cilat tregojnë ato me akull të thatë, shkruan NASA.

Shikuar menjëherë pas perëndimit të diellit, kristalet e tyre të akullit kapin dritën që venit, duke bërë që ata të duken sikur shkëlqen

kundër qiellit të errësuar.

Këto re muzgu, të njohura si "noctilucent", bëhen më të ndritshme ndërsa mbushen me kristale, pastaj errësohen pasi pozicioni i Diellit në qiell bie nën lartësinë e tyre. Kjo është vetëm një e dhënë e dobishme që përdorin shkencëtarët për të përcaktuar se sa të larta janë.

"Nëse shihni një re me një pastel me shkëlqim të ngjyrave në të, kjo është për shkak se grimcat e reve janë pothuajse identike në madhësi", tha Mark Lemmon, një shkencëtar atmosferik me Institutin e Shkencës Hapësinore në Boulder, Colorado.

"Kjo zakonisht po ndodh menjëherë pasi retë janë formuar dhe janë rritur të gjitha me të njëjtën ritëm", shtoi ai.

Curiosity Mars rover i NASA-s i pikasi këto re të ylbërta, më 5 mars 2021.

"Unë gjithmonë mrekullohem me ngjyrat që shfaqen: të kuqe dhe jeshile dhe blu dhe purpura. Është vërtet e bukur të shohësh diçka që shkëlqen me shumë ngjyra në Mars", tha Lemmon.

## PESHKAQENËT PËRDORIN FUSHËN MAGNETIKE TË TOKËS PËR T'U ORIENTUAR

Shkencëtarët kanë zbuluar se peshkaqenët përdorin fushën magnetike të Tokës, si një lloj GPS natyral, për të udhëtuar në distanca të largëta përgjatë oqeanëve të botës.

Hulumtuesit thonë se eksperimentet e tyre laboratorike detare me specie të vogla peshkaqenësh konfirmojnë spekulimet e kahershme se peshkaqenët përdorin fushat magnetike për

t'u orientuar. Kjo veti është vërejtur edhe tek kafshë të tjera si breshkat e detit. Studimi u publikua këtë muaj në revistën "Current Biology".

Studimi hedh dritë gjithashtu edhe mbi pikpyetje të tjera, se pse peshkaqenët janë në gjendje të përshkojnë detra të tëra dhe të gjejnë rrugën e kthimit, të gjejnë prenë dhe të shumohen.





Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,  
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,  
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,  
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



**CIKLI FILLOR**  
(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË  
DERI NË KLASËN E **5**-TË

“Le të gëzohen ata  
që shmangen  
nga adhurimi i idhujve  
e kthehen nga Allahu!  
Pra, jepu lajme  
të gëzueshme robërve të Mi,  
të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët  
(që u thuhën),  
ndjekin atë që është  
më e mira prej tyre.  
Këta janë ata  
që Allahu i ka udhëzuar  
në rrugë të drejtë;  
këta janë mendarët.”

*(Zumer, 17-18)*